




POZITA E GRUAS DHE ROLI I SAJ

Tiranë, 2016

Titulli: **Pozita e gruas dhe roli i saj**

Përgatiti: Shoqata e njohjeve islame

Recensent: Vullnet MERJA

E përktheu nga anglishtja: Sonila QAZIMI

E redaktoi: Liseda RAMAJ

E Korrektoi: Vjollca KARAJ

Përgatiti për shtyp: Sabrie FEZA

Kopertina: Sabrie FEZA

E botoi: Shoqata "FLLADI"

© Shoqata "Flladi"

Hyrje

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

I Lavdëruar qoftë Allahu, Zoti i të gjithë botëve! Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin dhe mbi familjen e tij!

S'ka dyshim se Islami madhështor me mësimet e tij dhe me dispozitat e tij, përmban rrugën e udhëzimit për mbarë njerëzimin, për t'i nxjerrë ata nga errësira në dritë. Këto rregulla e dispozita janë në përshtatje me njeriun, me të gjitha karakteristikat e tij, prirjet dhe veçoritë e tij. Çdo njeri, Islami e udhëzon në atë rrugë që i përshtatet më shumë atij/asaj. Ka shumë çështje, rregulla dhe koncepte që kanë lidhje me femrën. Çdo femër myslimane duhet t'i njohë dhe t'i zbatojë rregullat e Islamit. Këto rregulla dhe dispozita janë dritë për to dhe ndihmuese të tyre në jetën e përditshme, që të jenë të lumtura në këtë botë dhe me

Profetët dhe punëmirët në Botën Tjetër.

Ky libër hedh dritë në shumë çështje të rëndësishme, me të cilat, femra përballet çdo ditë në jetën e saj. E lusim Allahun e Lartësuar që femrat besimtare të përfitojnë nga ky libër. Në fillim dhe në fund, i Lavdëruar qoftë Allahu, Zoti i të gjithë botëve!

Shoqata Kulturore Islame "Al-Mearif"

Vlerësimi i femrës sipas Islamit

Kur'ani pohon fuqinë e gruas: ajo është njeri i fortë, që kërkon gjithmonë lartësimin dhe kundërshton fuqishëm dobësinë. Gruaja mund të jetë model për mashkullin, ashtu siç është për femrat. Allahu i Madhëruar na flet në Kur'an për pozitën aktive të femrës dhe qëndrimet e saj të fuqishme në mendim dhe në besim. Ai përmend Merjemen, Asien, bashkëshorten e Faraonit dhe bashkëshorten e hazreti Ibrahimit.

Islami i dha gruas fuqi, e vuri atë përkrah burrit dhe e bëri të barabartë me burrin. Natyrisht që ka dispozita të veçanta, që janë për burrin, ashtu siç ka edhe dispozita të veçanta, që janë për gruan. Gruaja dhe burri janë të lirë të shkollohen e të studiojnë. Gruaja ka të drejta në të gjitha fushat, në të cilat ka edhe burri. Sipas Islamit, grua ka të drejtën e vet për divorc qysh kur lidhet akti i martesës. Islami kërkon prej burrit e gruas që të ruajnë natyrshmërinë e tyre njerëzore. Islami ka qëllim integritetin e plotë për gruan e për burrin. Respekti e liria që i ka dhënë Islami gruas nuk ka të ngjashëm në asnjë legjislacion tjetër, sado i lartë të jetë.

Gruaja gëzon pozitë të lartë në Kur'an, sepse ai nuk ka ardhur vetëm për edukimin e udhëzimin e burrit, por për edukimin dhe udhëzimin e të gjithë njerëzve. Në shumë ajete të Kur'anit përmenden fjalët "*en nasu*" (njerëzit) dhe "*el insane*" (njeri), të cilat nuk janë vetëm për një gjini të veçantë dhe as për një grup të posaçëm njerëzish. Këto fjalë përfshijnë burrat dhe gratë (meshkujt dhe femrat).

Kur'ani pohon fuqinë e gruas: ajo është njeri i fortë, që kërkon gjithmonë lartësimin dhe kundërshton fuqishëm dobësinë. Kjo grua shembullore mund të jetë model për mashkullin, ashtu siç është për femrat.

Në historinë islame gjejmë gra, të cilat arritën lartësinë në shoqërinë e tyre për arsye të fuqisë, qëndrimeve dhe dhuntive që patën. Ato dëshmojnë dhe përforcojnë fuqinë e personalitetit të gruas për të arritur në nivele sa më të larta. Nëkohëne sotme, shohim shumë gra, të cilat shquhen në fushat e ndryshme të shkencës e të jetës.

Allahu i Madhëruar na flet në Kur'an për pozitën aktive të femrës dhe qëndrimet e saj të fuqishme në mendim dhe në besim. Ai përmend Merjemen, Asien, bashkëshorten e Faraonit, Belkiza (mbretëresha e popullit Sebe në kohën e Profetit Sulejman / *Paqja qoftë mbi të!*) dhe bashkëshorten e Hazreti Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi to!*). Po ashtu, historia islame përmend nënën e besimtarëve, hazreti Hatixhen (*Paqja qoftë mbi të!*), vajzën e Profetit

Muhamed, Hazreti Zahranë (*Paqja qoftë mbi të!*), zonjën Zejneb, bija e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi ta!*) e të tjera.

Fatkeqësisht, ka një informacion të keq për lirinë e gruas në Islam. Ky informacion ka arritur deri në atë shkallë, saqë njerëzit mendojnë se Islami ka ardhur që gruan ta mbyllë brenda mureve të shtëpisë. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Gruaja është po aq e lirë sa edhe burri. Është detyrë islame që grua të jetë e mbuluar; por nuk është kusht që ajo të veshë fereksenë, madje, ajo mund të zgjedhë çfarë rrobash i shkojnë mbulimit të saj. Islami nuk do që grua të jetë kukull në duart tona. Islami kërkon të ruhet personaliteti i gruas dhe ajo të jetë njeri me vlera të larta dhe aktive në shoqëri. Islami kurrë nuk e lejon që grua të jetë mjet në duart e burrit, që ai të ushtrojë vetëm epshet e tij. Islami e ka bërë haram (të ndaluar) abortin. Sipas Islamit, grua ka të drejtën e vet për divorc qysh kur lidhet akti i martesës. Respekti e liria që i ka dhënë Islami gruas nuk ka të ngjashëm në asnjë legjislacion tjetër, sado i lartë të jetë.

Islami e kundërshton rreptësisht shthurjen në shoqëri, qoftë të meshkujve, qoftë të femrave, por nuk kundërshton qytetërimin.

Islami e mori gruan për dore dhe e vuri atë përkrah burrit qysh kur erdhi i Dërguari i Islamit. Para ardhjes së Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gratë nuk llogariteshin se luanin rol në mesin e shoqërisë. Jo vetëm kjo, para Islamit, kur ndonjërit i lindte vajzë, ai nxihej në fytyrë dhe fshihej nga

turpi. Këtë e thotë Kur'ani i Shenjtë: **“Dhe, kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s’di - a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhë. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!”** (Sure “Nahl”, ajetet 58-59)

Islami i dha gruas fuqi, e vuri atë përkrah burrit dhe e bëri të barabartë me burrin. Natyrisht që ka dispozita të veçanta, që janë në përshtatje për burrin, ashtu siçka edhe dispozita të veçanta, që janë në përshtatje për gruan. Por kjo nuk do të thotë që Islami bën dallime në mes gruas e burrit.

Gruaja dhe burri janë të lirë të shkollohen e të studiojnë. Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Kërkimi i diturisë është detyrë për çdo mysliman dhe myslimane.”*

Gruaja ka të drejta në të gjitha fushat, në të cilat ka edhe burri. Islami kërkon prej burrit e gruas që të ruajnë natyrshmërinë e tyre njerëzore. Islami ka qëllim integrimin e plotë për gruan e për burrin. Islami e shpëtoi gruan nga zakonet shkatërruese të kohës para Islamit. Kushdo që e studion legjislacionin islam, do të shohë se Islami i ka dhënë gruas edhe të drejta që nuk i’a ka dhënë burrit. Të gjitha ligjet e Islamit kanë ardhur për të mirën e gruas e të burrit. Prandaj, gruaja, brenda mundësive themelore, ka detyrë të japë ndihmesën e saj për shoqërinë ku ajo jeton. Islami do që gruaja të arrijë në pozitën më të lartë të humanizmit. Prandaj, është detyrë që gruaja të ushtrojë

rolin e saj për përcaktimin e së ardhmes së vet. Përmirësimi ose shkatërrimi i shoqërisë nis nga përmirësimi ose shthurja e gruas.

Gruaja është qenia e vetme shoqërore, nga prehri i së cilës rriten dhe edukohen njerëz, që do të vënë në rrugë të drejtë shoqërinë, madje të gjitha shoqëritë.

Gratë kanë meritë të madhe në integrimin e shoqërisë. Madje, mund të thuhet se gratë janë ato që e shtyjnë përpara integrimin nëpërmjet edukimit të drejtë të brezave. Allahu mos e lejoftë, që prej prehrit të nënave të dalin fëmijë që nuk janë edukuar me edukatën njerëzore islame, sepse ata mund ta çojnë shoqërinë kah shkatërimi. Ata që kundërshtojnë mëmësinë, rritjen e fëmijëve dhe edukimin e tyre nga nëna, duke e konsideruar këtë punë të dorës së dytë, kanë qëllime shkatërruese. Njerëz të tillë dëshirojnë largimin e fëmijëve nga prehri i nënave, ku edukohen fëmijët në mënyrën më të mirë. Prehri i nënës e ndërton njeriun.

Prehri i nënës është shkolla më e madhe e edukimit të fëmijës. Ajo që dëgjon fëmija prej nënës ,dallon nga ato që dëgjon prej mësuesit. Në prehrin e nënës fëmija edukohet më mirë se pranë babait. Fëmija edukohet në prehrin e nënës së tij më mirë se prej babait e prej mësuesit, sepse marrëdhëniet e fëmijës me nënën e tij nuk i qaset asnjë lloj marrëdhënieje. Fëmija pranon prej nënës më shumë nga sa pranon prej babait. Ato që dëgjon fëmija prej nënës

së tij në vogëli, skaliten në zemrën e tij dhe mbeten në të deri në fund.

Moralet e nënës lënë gjurmë në fëmijën e saj të vogël dhe ajo në saje të moraleve të veta ndikon në fëmijën më shumë se të tjerët.

Prehri i nënës është shkolla e parë për fëmijën. Por është nëna e mirë që edukon një fëmijë të mirë. Nëse nëna është e devijuar (*Allahu mos e lejoftë!*), prej prehrit të saj fëmija do të dalë i devijuar. Përse? Sepse fëmija lidhet me nënën në një mënyrë të veçantë e nuk mund të gjendet shembull për këtë lidhje. Sepse fëmija mendon se ëma mishëron të gjitha të mirat e tij e prandaj fjala e nënës, morali i saj e puna e saj kanë ndikim të madh në fëmijën. Në këtë kuptim, prehri i nënës është klasa e parë për fëmijën. Nëse prehri është i pastër e i kulturuar, me siguri, fëmija do të rritet qysh në fillim me të njëjtat morale të bukura dhe me të njëjtat veprime e vepratëmira. Kur fëmija është në prehrin e së ëmës dhe shikon moralin e saj të bukur, punën e saj të rregullt dhe fjalën e saj të mirë, patjetër, do të rritet duke imituar nënën e vet në punë e në fjalë. Dhe, ky imitim është më i thellë se çdo imitim tjetër. Udhëzimi i nënës ka frytshmëri më të madhe se çdo udhëzim tjetër.

Motra të dashura! Është detyra jonë që të kujdesemi për fëmijët tanë të vegjël. Ne duhet t'i edukojmë fëmijët tanë me edukatën e pastër islame. Ne duhet t'i edukojmë fëmijët tanë në atë mënyrë që ata të dallojnë të mirën nga e

keqja dhe të pasojnë të mirën e të largohen nga e keqja. Nëse do të rrisim fëmijë me edukatë të mirë, me siguri, kjo puna jonë do të sjellë lumturinë e të gjithë shoqërisë. Por, nëse në prehrin tonë fëmija rritet me edukatë të keqe (*Allahu mos e lejoftë!*), patjetër, do të sjellim prishjen e shoqërisë. Nënata janë baza e të mirave, por (*Allahu mos e lejoftë!*), nënat mund të jenë edhe baza e së keqes, kur i rrisin fëmijët e tyre me edukatë të keqe.

Ndikimi i familjes, veçanërisht i nënës te fëmijët dhe i babës te adoleshentët është shumë i madh. Nëse fëmijët do të edukohen siç duhet e do të marrin mësim të shëndoshë në prehrin e nënave dhe nën mbrojtjen e baballarëve, që respektojnë fenë, kur ata të çohen në shkollë, patjetër që puna e mësuesëve do të jetë e lehtë. Fëmija me edukatë të mirë e shpëton nënën e vet. Fëmija me edukatë të keqe bëhet shkak për shkatërrimin e nënës së vet.

Sot është detyrë e prindërve që të interesohen për sjelljen e për rrugën që marrin fëmijët e tyre. Është detyrë e tyre t'i këshillojnë fëmijët kur shikojnë tek ata ndonjë sjellje jonormale, që të mos mashtrohen nga të pamoralshmit dhe nga të devijuarit e të jenë të humbur në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Ajo që s'ka dyshim është se feja e pastër dhe e drejtë islame ka udhëzimin për mbarë njerëzimin. Qëllimi i saj është nxjerrja e njerëzve nga errësirat në dritë. Të gjitha rregullat dhe urdhrat e fesë islame janë në përputhje të plotë me natyrën e njeriut - mashkull apo femër qoftë.

Në Islam, krahas rregullave të përgjithshme ka edhe rregulla të posaçme që kanë të bëjnë me femrën. Këto rregulla i sigurojnë asaj një jetë të mirë, të qetë dhe të lumtur si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër.

Ka shumë mendime dhe teori në mesin e njerëzve, të cilat e nënvleftësojnë femrën. Madje, disa nga këto mendime dhe teori i vishen Sheriatit të shenjtë. Për këtë asnjë mysliman nuk guxon të përballet me këto mendime dhe teori. Ndër këto mendime dhe teori është: femra është përgjegjëse për gjynahun e parë të kryer nga njeriu.

Në Kur'an thuhet: **“O Adem! Banoni ti dhe bashkëshortja jote në Xhenet dhe hani ç’të dëshironi, por mos iu afroni kësaj peme, se bëheni keqbërës!”** Djalli u pëshpëriti, për t’ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: **‘Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni melekë ose të pavdekshëm.’** Dhe iu betua atyre (duke thënë): **‘Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!’** Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjeteth e Xhenetit dhe Zoti i tyre u thirri: **‘A nuk jua pata ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është, vërtet armiku juaj i hapët?’** Ata thanë: **‘O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne, vërtet që do të jemi nga të humburit’**”. (Sure “A’raf”, ajetet 19-23) Ky ajet nuk bën dallim mes Havasë dhe Ademit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Djalli i mallkuar i mashtroi të dy.

Islami e nderon femrën, ashtu siç nderon mashkullin. Për këtë Kur'ani thotë: **“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: Ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar.”** (Sure “Isra”, ajeti 70). Ky nderim, që për mend ajeti përfshin edhe mashkullin, edhe femrën. Femra nuk është krijesë tjetër, - edhe ajo është njeri dhe në këtë kontekst, është e barabartë me mashkullin. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin...”** (Sure “Huxhurat”, ajeti 13) Ashtu siç janë fiset dhe kombet të barabartë në qenien e tyre njerëz, po ashtu, edhe mashkulli edhe femra janë të barabartë në këtë kontekst.

Femra është gjysma e shoqërisë. Shpërfillja e aftësive të saj në shoqëri do të thotë që shoqëria të jetojë e çalë. Neglizhenca ndaj aftësive të saj do të thotë mohim i dhuntive të shumta e madhështore të femrës e dobësim i energjive të saj të shumta, me të cilat e ka begatuar Krijuesi i saj.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), durimtarët dhe durimtare, të përlulurit dhe të përlulur, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, kujtuesit e**

kujtueset e Allahut vazhdimisht, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.” (Sure “Ahzab”, ajeti 35) Ajeti sqaron shumë mirë se nuk ka dallim mes femrës dhe mashkullit në shpërblim. Ajeti na mëson, gjithashtu se femra qëndron në anë të mashkullit në rrugën drejt përsosurisë.

Sipas Islamit, edhe femra është përgjegjëse për çdo gjë që ndodh në shoqërinë ku jeton. Është detyrë e saj të kontribuojë në udhëzimin e shoqërisë në rrugën e mirësisë e të drejtësisë. Ajo duhet të përballojë çdo devijim, me të cilin goditet shoqëria.

Femra nuk është krijesë vetëm për t’i shërbyer mashkullit dhe vetëm për ta kënaqur atë. Ajo nuk është krijuar për të reklamuar makiazhet dhe modën. Ajo është krijuar për të kryer përgjegjësinë e saj që i takon në këtë jetë. Në fund do të përmend edhe disa ajete në lidhje me këtë çështje nga Kur’ani ku thuhet: **“Nuk i takon asnjë besimtari a besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, me siguri ka humbur.** (Sure “Ahzab”, ajeti 36) Dhe: **“...Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, qofshin meshkuj apo femra, do të hyjnë në Xhenet. Aty do të begatohen pa kufizim.”** (Sure Zumer”, ajeti 40)

Dhe: **“Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në**

Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi. (Sure "Nisa", ajeti 124)

"Cilindo mashkull a cilado femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar/besimtare, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë." (Sure "Nahl", ajeti 97)

Shoqata Flladi

Mësimi i parë

VLERA E GRUAS

Gruaja në sytë e shoqërisë

Në ditët e sotme ndeshemi me shumë ide dhe teori të cilat janë të përhapura midis njerëzve. Ato e rendisin gruan në një nivel më të ulët, sesa mashkullin. Të tilla ide e teori i atribuohen edhe Sheriatit (legjislacionit) islam. Për këtë, një person mysliman nuk guxon të përballet me këto ide e teori dhe t'i kundërshtojë ato, sepse mendon se po kundërshton Sheriatin, ndërkohë që e vërteta është ndryshe. Prej këtyre ideve dhe teorive janë:

1- A është femra një krijesë dytësore?

Në mesin e disa myslimanëve është e njohur dhe e përhapur që Havaja (*Paqja qoftë mbi të!*) është krijuar nga një brinjë e Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për këtë teori përmendin disa transmetime si dëshmi. Kjo pikëpamje në krijim mund ta bëjë njeriun që të mendojë se Havaja, apo femra, është një krijesë dytësore, e cila është krijuar nga brinja e burrit. Disa kanë thënë se ajo është brinja e shkurtër dhe e majtë. Kjo nuk është pikëpamje e drejtë.

Ne nuk do të diskutojmë çështjen se Havaja është krijuar nga brinja e Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*), sepse pikëpamja dhe mendimi ynë është se Havaja është krijuar nga e njëjta baltë, nga e cila u krijua edhe Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nuk është krijuar nga brinja e tij. Në një transmetim nga Ibn Ebi El Mikdad, thuhet se babai i tij ka thënë: “E pyeta Ebu Xhaferrin (Imam El Bakir) (*Paqja qoftë mbi të!*): ‘Nga se e ka krijuar Allahu Havanë?’ Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) u kthye e më pyeti mua: ‘Çfarë thonë njerëzit?’ Unë iu përgjigja: ‘Ata thonë që Allahu e krijoi atë nga një brinjë e Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*).’ Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: ‘Ata janë të pavërtetët. A nuk mundej Ai që ta krijonte atë (Havanë) nga diçka tjetër, përveç brinjës së Ademit?!’ E pyeta atë: ‘O bir i Profetit të Allahut, u bëfsha kurban për ju! Nga se e ka krijuar Allahu atë (Havanë)?’ Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) u përgjigj: ‘Babai im më ka treguar mua nga një transmetim i etërve të tij (*Paqja qoftë mbi ta!*) se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: ‘Allahu i Lartësuar dhe i Madhëruar mori një dorë baltë, e përziu me të Djathtën e Tij dhe me të krijoi Ademin dhe nga balta e mbetur, Allahu i Madhëruar krijoi Havanë.’”¹

Fraza “baltë e mbetur” nuk ka për qëllim nënvlerësimin e kësaj balte, sepse Allahu është i Urtë dhe të mbeturat nuk ia shtojnë Atij madhësitë. Por kjo frazë tregon për dy çështje:

¹ “Biharul Anuar”, vëll. 22, f. 116.

E para: Tregon renditjen kohore, ku në fillim, Allahu krijoi Ademin me një pjesë të baltës dhe më pas krijoi Havanë (*Paqja qoftë mbi të!*) me pjesën tjetër të mbetur nga balta që krijoi Ademin.

E dyta: Tregon se edhe ajo është krijuar po nga e njëjta baltë me të cilën u krijua Ademi, ku askush të mos mendojë se gjendej baltë tjetër për femrat, e cila ndryshon nga ajo e mashkullit. Në përputhje me këtë, është edhe një ajet në Kur'anin e ndritur, i cili thotë: **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”**²

2- Gjynahu i parë

Te fetë e tjera, ndoshta edhe te disa myslimanë, është e njohur se femra është përgjegjëse për fajn e parë të bërë nga njeriu dhe ajo ishte shkaktarja që Ademi (*Paqja qoftë mbi të!*) gaboi, sepse ajo ia zbukuroi atij ngrënien nga pema, nga e cila Allahu i Lartësuar ia ndaloi të hanin.

Transmetohet nga Ibn Abbasi se ka thënë: *“Kur Ademi hëngri nga pema, e cila ishte e ndaluar për të ngrënë, Allahu i Madhëruar e pyeti atë: ‘Çfarë të bëri ty që të mos më bindesh mua?’ Ademi iu përgjigj: ‘O Zoti im! Havaja ma zbukuroi mua.’ Më pas, Allahu tha: ‘Unë do ta ndëshkoj atë që të mbetet*

² Surja “Rrum”, ajeti 21.



shtatzanë me dhimbje dhe të lindë me dhimbje dhe e bëra atë që të ketë perioda dy herë në muaj.’ Kur Havaja e dëgjoji këtë, ajo qau me zë të lartë. Allahu i tha asaj: ‘E qara është e destinuar për ty dhe për vajzat e tua.’”³

Ky transmetim nuk është i saktë tek ne (shi’itët). Ai është në kundërshtim me tekstin e Kur’anit. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ndërsa Ademiti i tha: ‘O Adem! Bano ti dhe bashkëshortja jote në Xhenet dhe hani ç’të dëshironi, por mos iu afroni kësaj peme, se bëheni keqbërës!’ Djalli u pëshpëriti, për t’ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: ‘Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm.’ Dhe iu betua atyre (duke thënë): ‘Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!’ Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit dhe Zoti i tyre i thirri: ‘A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?’ Ata thanë: ‘O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.’”⁴**

Ky ajet nuk bën dallim mes Ademiti dhe Havasë në këtë çështje. Ai u drejtohet të dyve së bashku dhe cytjet e shejtanit ishin për të dy së bashku.

³ “*Al Mustedrek*” i El Hakim El Nijaburi, vëll. 2, f. 381.

⁴ Surja “*Araf*”, ajetet 19-23.

Gruaja në pikëpamjen e Islamit

Gruaja është një prej dy llojeve të qenieve njerëzore. Në mënyrë që të njihemi me pikëpamjen e Islamit për femrën, duhet ta hedhim vështrimin për të parë pikëpamjen e Islamit për njeriun, e më pas të shohim pikëpamjen e tij për femrën.

1- Nderimi i gruas si qenie njerëzore

Allahu i Madhëruar thotë: **“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar.”**⁵ Ky nderim është i barabartë si për femrën, ashtu si edhe për mashkullin. Gruaja nuk është një krijesë tjetër që ka formën e njeriut, por është njeri i vërtetë dhe e barabartë me mashkullin në këtë drejtim. Allahu i Madhëruar, në Kur'anin e Shenjtë, thotë: **“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëditur dhe për Të asgjë nuk është e fshehtë.”**⁶ Ashtu siç janë kombet dhe fiset të barabarta mes tyre për

⁵ Surja “Isra”, ajeti 70.

⁶ Surja “Huxhurat”, ajeti 13.



nga kriteri i të qënirë njerëz, po ashtu edhe meshkujt dhe femrat janë të barabartë në këtë kriter.

Pikat e dobëta të përbashkëta

Mashkulli dhe femra kanë shumë pika të dobëta, të cilat tregohen në ajetet kur'anore. Përmendja e këtyre pikave të dobëta nuk synon nënvlerësimin e njeriut dhe uljen e pozitës së tij, por sinjalizimin e tij për mangësitë. Qëllimi i Kur'anit të Shenjtë është udhëzimi: **“Ky është Libri, në të cilin nuk ka dyshime. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.”**⁷

Çdo tekst i Sheriatit përmend një pikë të dobët, që në të vërtetë, është një prej llojeve të udhëzimit për të arritur përsosurinë dhe nuk është shpatë kërcënuese e ngritur mbi kokën e mashkullit apo të femrës (*Allahu na ruajtë!*). Pra, njeriu është i dobët. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë: **“...njeriu është krijuar si një qenie e pafuqishme”**.⁸ Njeriu është i nxituar, siç thotë Kur'ani: **“vërtet që njeriu është i nxituar”**.⁹

Njeriu është i paqëndrueshëm dhe frikacak nga e keqja dhe nga koprracia. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm: kur atë e godet e**

⁷ Surja “Bekare”, ajeti 2

⁸ Surja “Nisa”, ajeti 28.

⁹ Surja “Isra”, ajeti 11.

keqja, ai ligështohet fort, por, kur i bie e mira, ai bëhet koprac.”¹⁰

Të gjitha këto që u përmendën nuk kanë si qëllim nënvlerësimin e njeriut, por kanë si qëllim që ta marrin për dore, që të mos bjerë pre e këtyre gjërave. E njëjta gjë është edhe për femrën. Çdo tekst islam që përmend pikat e dobëta të femrës, ka për qëllim udhëzimin e saj dhe jo nënvlerësimin e saj.

Nuk ka ndryshim mes gjinive

Në Kur'anin Fisnik gruaja është një qenie e nderuar. Vallë, a është femra në një shkallë më të ulët dhe mashkulli në shkallë më të lartë? Kur'ani Fisnik i përgjigjet kësaj pyetjeje duke thënë: “O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu, është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëditur dhe për Të asgjë nuk është e fshehtë.”¹¹

Allahu i Lartësuar nuk e ka vendosur kriterin e nderimit të njeriut në të qëniet e tij femër apo mashkull. I vetmi kriter është devotshmëria, në të cilën nuk ka asnjë dallim mes mashkullit dhe femrës. Njeriu më i devotshëm, qoftë mashkull ose femër, është më i nderuari tek Allahu i Lartësuar.

Në transmetimin e ardhur nga Imam Ebu Abdilah,

¹⁰ Surja “Mearixh”, ajetet 19-21.

¹¹ Surja “Huxhurat”, ajeti 13.

Xhaferr Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: “Një grua punëmirë është më e mirë sesa një mijë burra punëkëqinj.”¹²

Pyetja ngrihet për thënien e Allahut të Lartësuar: **“...burrat janë në një shkallë mbi ato...”**¹³ Çfarë kuptimi ka ky ajet fisnik? Cila është ajo shkallë ku burrat janë më lart se gratë? Kjo pjesë e ajetit fisnik ka ardhur edhe në mesin e ajeteve: **“E, nëse vendosin të ndahen, vërtet, Allahu dëgjon dhe di çdo gjë. Gratë e ndara duhet të presin tri cikle mujore dhe nuk është e lejueshme ta fshehin atë që ka krijuar Allahu në mitrën e tyre, nëse besojnë Allahun dhe Ditën e Kiametit. Burrat e tyre, nëse dëshirojnë mirësi dhe qetësi, kanë të drejtë t’i kthejnë gjatë këtij afati. Gratë kanë aq të drejta sa kanë edhe detyra, sipas arsyes së shëndoshë, ndonëse burrat kanë një shkallë (më shumë përgjegjësie) mbi ato. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”**¹⁴

Ajeti fisnik flet për lidhjet bashkëshortore, për detyrat dhe të drejtat që kanë si bashkëshorti, ashtu edhe bashkëshortja. Ai nuk flet për pozitën shpirtërore apo për qënien e një gjinie më e mirë se gjinia tjetër. Përkundrazi, ai tregon një çështje praktike që është e lidhur me të drejtat dhe detyrat e bashkëshortit dhe të bashkëshortes. S’ka dyshim se ka dallime në detajet praktike mes mashkullit dhe femrës në Sheriat dhe një nga këto detaje është edhe divorci. Divorcin e përmend ky ajet fisnik. Në mësimet e

¹² “*Vesailu Shi’ah*”, vëll. 14, f. 123.

¹³ Surja “Bekare”, ajeti 228.

¹⁴ Surja “Bekare”, ajetet 127-128.

tjera, me lejen dhe me ndihmën e Allahut, do të flasim mbi dallimet, të cilat lidhen me aspektet praktike.

Pikëpamja e Kur'anit për femrën

Kur'ani Fisnik dallohet për nga pikëpamja e balancuar për femrën. Kur'ani nuk e paraqet femrën si perëndeshë, siç e paraqesin atë disa shoqëri. Ai as nuk e ka bërë atë që të varroset e gjallë, siç vepronin disa që e varrosnin të gjallë atë. Kur'ani e paraqet femrën si njeri që e kalon jetën përmes sprovave dhe shqetësimeve, ku ai të udhëzohet në rrugën e drejtë ose mund të jetë i humbur, njësoj si mashkulli.

Kur'ani përmend disa gra, të cilat dështuan në testin e kësaj bote. Allahu i Lartësuar sjell si shembuj gratë jobesimtare, ku thotë: **"Allahu ka dhënë si shembull për ata që nuk besojnë, gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin të martuara me dy nga robtë Tanë të ndershëm dhe i tradhtuan ata. Prandaj, ata nuk mund t'i mbrojnë aspak nga Allahu (Ditën e Gjykimit) e atyre të dyjave do t'u thuhet: 'Hyni në zjarr, me ata që po hyjnë!'"**¹⁵ *Nga ana tjetër, Kur'ani Fisnik sjell si shembull një grua që kishte pasuri dhe pushtet. Kur e njohu të vërtetën, ajo besoi në Allahun e Lartësuar dhe iu dorëzua Vullnetit të Tij. Allahu i Madhëruar thotë: "Ajo tha: 'O paria ime, më këshilloni se ç'duhet të bëj në këtë çështje! Unë nuk do të vendos asgjë pa ju!' Ata thanë: 'Ne jemi shumë të fortë dhe luftëtarë të*

¹⁵ Surja "Tahrim", ajeti 10.



guximshëm, por urdhri të takon ty, prandaj mendo mirë se ç'do të urdhërosh!' Ajo tha: 'Njëmend, kur mbretërit pushtojnë ndonjë vendbanim, e rrënojnë atë dhe e poshtërojnë parinë e tij. Kështu veprojnë ata. Tani do t'u dërgoj atyre një dhuratë dhe do të shoh me se do të kthehen të deleguarit.' Kur erdhën (të deleguarit), Sulejmani tha: 'A mos doni të më ndihmoni me pasuri?! Ajo që më ka dhënë Allahu, është më e mirë nga ajo që ju ka dhënë juve. Por ju gëzoheni me dhuratën tuaj. Kthehuni tek ata! Ne do të sjellim ushtri, të cilën nuk do të mund ta përballojnë ata dhe, me siguri, do t'i dëbojmë ata prej Shebës të poshtëruar dhe të përulur.' Pastaj ai tha: 'O parësi, kush prej jush do të më sjellë fronin e saj, para se ata të vijnë të dorëzuar?' Njëri nga xhindet - Ifriti, tha: 'Unë do të ta sjell ty para se të ngrihesh prej vendit; unë për këtë jam i fuqishëm dhe i sigurt.' Po ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: 'Unë do të ta sjell ty sa çel e mbyll sytë.' Kur (Sulejmani) e pa të vendosur para tij, tha: 'Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues. Ndryshojeni edhe fronin e saj! Do të shohim se a do ta vërë re këtë apo jo.' Kur erdhi ajo, i thanë: 'I tillë është froni yt?' Ajo u përgjigj: 'Duket sikur të ishte ai.' Sulejmani tha: 'Para saj na është dhënë dituria dhe para saj i jemi nënshtruar Allahut.' Atë (Belkisën) e kishte penguar (nga Islami) ajo që adhuronte në vend të Allahut, sepse ajo ishte nga populli mohues.

Asaj i thanë të hynte në pallat. Kur e pa atë, ajo kujtoi se ishte ujë i thellë dhe përvoli fustanin te këmbët. Sulejmani i tha: 'Ky pallat është i shtruar me xhama.' Ajo tha: 'O Zoti im, me të vërtetë unë e paskam dëmtuar veten dhe tani, bashkë me Sulejmanin i dorëzohem Allahut - Zotit të botëve!'"¹⁶

Fokusimi në një model të ndritshëm

Është vërejtur se Kur'an-i Fisnik, shpeshherë, i referohet një modeli të ndritur nga femrat. Ai, gjithashtu, hedh shumë dritë mbi gratë punëmira në shumë prej ajeteve fisnike dhe fokusohet në shumë pika të ndritshme nga jeta e tyre. Ai paraqet shumë gra si modele, jo vetëm për gratë, por për të gjithë njerëzimin, duke përfshirë edhe burrat edhe gratë. Prej femrave që përmenden në Kur'an, janë:

1- Gruaja e Faraonit

Allahu i Madhëruar, në Kur'anin e Shenjtë, thotë: "Allahu ka dhënë si shembull për besimtarët gruan e Faraonit, kur ajo tha: 'O Zoti im! Ndërtomë një banesë tek Ti, në Xhenet; më shpëto nga Faraoni dhe nga veprat e tij dhe më shpëto nga populli keqbërës!'"¹⁷

Ajo që vihet re në ajet është se Allahu nuk e jep si shembull gruan e Faraonit vetëm për gratë, por për të

¹⁶ Surja "Neml", ajetet 32-44.

¹⁷ Surja "Tahrim", ajeti 11.

gjithë besimtarët. Ai thotë: **“...si shembull për besimtarët...”**

Ky shembull i ndritur, edhe pse jetonte në luksin e kësaj jete dhe kishte gjithçka materiale, iu drejtua Allahut të Lartësuar, duke thënë: **“...O Zoti im! Ndërtomë një banesë tek Ti, në Xhenet...”**¹⁸

2- Hazreti Merjemja, e bija e Imranit

Kjo grua e madhe është përmendur në shumë ajete të Kur'anit. Historia e saj përmendet në më shumë se në dy sure të Kur'anit Fisnik. Në ato ajete përmenden disa periudha në jetën e saj fisnike dhe të bekuar.

Disa nga këto ajete janë: **“Zoti e pranoi atë (Merjemen) me ëndje, e bëri që të rritet mirë dhe e la nën kujdestarinë e Zekerias. Sa herë që hynte Zekeria në dhomën e saj, gjente pranë saj ushqim dhe e pyeste: ‘O Merjeme! Nga të vjen ky ushqim?’ Ajo përgjigjej: ‘Ky është nga Allahu, se Allahu e furnizon kë të dojë, pa kufi.’”**¹⁹

“(Kujto) kur melekët thanë: ‘O Merjeme! Allahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës. O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun)!”²⁰

¹⁸ Surja “Tahrim”, ajeti 11.

¹⁹ Surja “Ali Imran”, ajeti 37.

²⁰ Surja “Ali Imran”, ajeti 42-43.

Përmbledhja e mësimit

Ka shumë ide dhe pikëpamje që e paraqesin femrën në një nivel më të ulët sesa mashkulli. Pikëpamja e krijimit e Havasë (*Paqja qoftë mbi të*) nga brinja e Ademit (*Paqja qoftë mbi të*) nuk është në përshtatje me shumë transmetime, të cilat flasin se ajo është krijuar nga e njëjta baltë, nga e cila është krijuar edhe Ademi.

Allahu i Madhëruar e bëri gruan të njëjtë me burrin në shoqëri dhe i ka caktuar gjithsecilit prej tyre detyra të veçanta, të cilat janë në përshtatje me secilin, qoftë mashkulli apo femra.

Allahu i Madhëruar, në Kur'an nuk bën dallime midis femrave dhe meshkujve. Ai i bëri ata me në njëtin nivel nderimi.

Kur'ani Fisnik, shpeshherë, paraqet modele të ndritura nga femrat. Ai, gjithashtu, hedh shumë dritë mbi të drejtat e gruas në shumë ajete fisnike dhe fokusohet në shumë pika të ndritshme nga historia e femrës. Ai paraqet shumë femra si shembuj, jo vetëm për gratë, por për të gjithë njerëzimin, duke përfshirë burrat dhe gratë.

Pyetje rreth mësimit

- 1- A është gruaja një krijesë dytësore?
- 2- Cili është këndvështrimi kur'anor në lidhje me gratë?
- 3- Si do t'i përgjigjeshit pyetjes se gruaja e parë, Havaja, ishte e para që bëri një gjynah?
- 4- Kush janë gratë, të cilat Allahu i Lartësuar i ka dhënë si shembuj në Kur'anin Fisnik?
- 5- A është kuptimi i thënies së Allahut të Lartësuar: **"Meshkujt janë në një shkallë më lartë..."** se mashkulli është më i mirë se femra?

Tregim

Fatimeja, vajza e Esedit

Ajo është Fatimeja, vajza e Esedit, gruaja e Ebu Talibit. Ajo është e ëma e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të*), e Talibit, e Akilit dhe e Xhaferrit. Ajo u interesua për të Dërguarin e Allahut, Muhamed ibn Abdullahun (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pasi gjyshi i tij Abdul Mutalibi ndërroi jetë, duke e trajtuar atë njësoj si katër fëmijët e saj, me të njëjtën butësi, amësi, dashamirësi dhe dashuri fisnike.

Sa të mrekullueshme janë thëniet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur ai e përshkruan atë (Fatimenë) me thënien e tij: *"Ajo ishte midis të gjitha krijesave të Allahut, më e dashura për mua. Ajo ishte*

nëna ime pas mamasë që më solli në jetë. Abu Talibi punonte. Ai kishte një tryezë, në të cilën na grumbullonte në ushqimin e tij. Kjo grua ruante një pjesë të ushqimit të saj, në mënyrë që unë mund të ushqehesha nga ai.”²¹

Një tjetër e dhënë është se historianët kanë përmendur se si u soll Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur ajo vdiq. Historia përmend se ai (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e qefinosi atë me këmishën e tij të bekuar. Ai e shtroi atë në varrin e saj. Në namazin e xhenazes së saj thirri shtatëdhjetë herë “Allahu është i Madh”, një akt, të cilin nuk e bëri për askënd tjetër. Pas kësaj, Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Melekët kanë mbushur horizontin. Një derë e Xhenetit u hap për të. Shtretërit e Xhenetit janë përgatitur për të. Një aromë nga Xheneti është dërguar për të. Ajo është në një qetësi në Xhenetin e bekuar. Varri i saj është një oborr nga Xheneti.”²²

Një nga sahabët e Profetit u habit nga kjo dhe pyeti atë për arsyen. Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu përgjigj: “Askush, pas Ebu Talibit, nuk ishte më i dashur për mua sesa ajo.” Pikat kryesore për këtë grua model janë:

1- Ajo ishte gruaja e parë pas Hatixhes (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*), e cila e pranoi Islamin.

2- Ajo ishte gruaja e parë që migroi nga Medina në këmbë dhe këmbëzbathur.

²¹ “Biharul Anuar”, vëll. 35, f. 175.

²² “Biharu Anuar”, vëll. 35, f. 179.

3- Ajo ishte gruaja e parë që besatoi me besnikëri Profetin e Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në ditën e besatimit (el bej'atu).

Ibn Abbasi ka thënë: Për atë (Fatimenë, të bijën e Esedit) ka zbritur ajeti i begatë: **“O Profet, nëse vijnë tek ty besimtarët e të betohen se nuk do t’i shoqërojnë Allahut asgjë (në adhurim), nuk do të vjedhin, nuk do të kurvërojnë, nuk do t’i vrasin fëmijët e tyre, nuk do të sjellin ndonjë shpifje të sajuar nga ato vetë dhe se nuk do të kundërshtojnë në çfarë është e drejtë dhe e arsyeshme, atëherë ti pranoje betimin e tyre dhe lutju Allahut t’i falë! Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**²³

Ajo ishte mamaja e Prijësit të besimtarëve, Imam Ali El Murteda (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo e lindi atë në Qaben e Shenjtë, që është një nderim i Allahut për të, që nuk i është dhënë askujt, përveç saj. Allahu, në shenjë nderimi për të, çau muret e Qabesë, duke i dhënë asaj lejen që të sjellë në jetë fëmijën e saj të bekuar.

²³ Surja “Mumteherine”, ajeti 21.

Mësimi i dytë

TË DREJTAT E GRUAS

Dallimi mes burrit dhe gruas

Kur folëm për pozitën e gruas në Islam, përmendëm se njeriu është mëkëmbësi i Allahut dhe ndjek fazat e përsosurisë, qoftë mashkull apo femër. Por, kjo nuk do të thotë që nuk ka ndryshim midis mashkullit dhe femrës. Përkundrazi, ata janë të ndryshëm për nga aftësitë fizologjike dhe psikologjike. Ky ndryshim nuk ka lidhje me mangësinë apo përkryerjen. Por, ai është drejtësi dhe përshtatshmëri. Në Sheriatin islam, burri dhe gruaja janë të destinuar të jetojnë një jetë të përbashkët. Beqaria është devijim nga ligji i krijimit. Ky koncept do të jetë më i qartë më vonë, kur të trajtohen dhe të zgjidhen format e ndryshimit.

Format e ndryshimit

Kërkimi rreth ndryshimit mes burrit dhe gruas nuk është një çështje e re. Në fakt, atë e gjejmë në thellësi të historisë.

Në kohën që Platoni refuzon praninë e ndryshimit kualitativ midis burrit dhe gruas, studenti i tij, Aristoteli, përforcon praninë e ndryshimeve në thënien e tij: "*Cilësia e*

aftësive të gruas ndryshon nga ajo e burrit, ashtu siç ndryshojnë detyrat dhe përgjegjësitë, të cilat i ka vendosur ligji i krijimit për secilin prej tyre. Të drejtat e secilit ndryshojnë në disa çështje." Dijetarët dhe fizikologët që erdhën pas tij, parapëlqyen pikëpamjen e Aristotelit ndaj asaj të Platonit.²⁴

Ndërsa sot, nën hijen e zhvillimit shkencor, ndryshimet mes burrit dhe gruas janë përcaktuar dhe janë sqaruar si rezultat i mbështetjes në vëzhgim, eksperimentim, statistikë dhe në fushat e studimit.

Më poshtë do të përmendim disa nga ndryshimet që kanë rënë në duart tona, të cilat i kanë përmedur kërkuesit. Ato janë:

Aspekti fiziologjik (trupor)

- 1- Meshkujt, në përgjithësi, karakterizohen nga një strukturë trupore më e madhe, kurse femra nuk është e tillë.
- 2- Mashkulli është i ashpër, ndërsa femra është e butë. Zëri i mashkullit është më i rëndë dhe më i trashë, ndërsa i femrës është më i butë dhe më i hollë.
- 3- Femra rritet më shpejt sesa mashkulli, por rritja muskulore vjen më shpejt te meshkujt sesa tek femra.
- 4- Femra e arrin maturimin seksual më shpejt sesa mashkulli.

²⁴ Shih librin "Nidham Hukuk El Mer'ti fil Islam" (Sistemi i të drejtave të gruas në Islam) i martirit Murteda Mutahari, faqe 159 dhe faqet në vijim.

- 5- Vajzat fillojnë të flasin më shpejt sesa djemtë.
- 6- Truri i mashkullit është më i madh sesa ai i femrës, duke marrë në konsideratë trurin në proporcion me të gjithë trupin.
- 7- Mushkëritë e meshkujve kanë një kapacitet më të madh për ajër sesa mushkëritë e femrave.
- 8- Rrahjet e zemrës së femrës janë më të shpejta sesa ato të zemrës së mashkullit.

Aspekti psikologjik

- 1- Mashkulli është i prirur të merret me sport dhe gjueti më shumë sesa femra.
- 2- Ndjenjat e mashkullit janë kundërshtare dhe luftarake, kurse ndjenjat e femrës janë paqësore. Femra qëndron larg dhunës ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes; si rezultat, përbindja e vetëvrasjes së femrave është në ulje. Vetëvrasja e meshkujve është më e shëmtuar, sepse ata përdorin metoda të ashpra si goditja e vetes me armë dhe hedhja nga vende të larta. Nga ana tjetër, femrat e kryejnë vetëvrasjen duke marrë kokrra gjumi ose lëndë narkotike.
- 3- Femra është më pasive, kështu, ajo përfshihet nga influencat e ndjenjave të saj më shumë sesa mashkulli.
- 4- Femra, në ndryshim nga mashkulli, është më e interesuar për të bukurën, zbukurimin dhe stilet e ndryshme të modës.
- 5- Femra është më e kujdesshme, më e frikësuar dhe më elokuyente sesa është mashkulli.
- 6- Emocionet e femrave janë prej nëne dhe kjo shfaqet që

në fëmijëri. Gjithashtu, femra është më e lidhur me shumë me familjen dhe në mënyrë të pavetëdijshme, e kupton vlerën e ambientit familjar më shpejt sesa mashkulli.

7- Në përgjithësi, një femër nuk e arrin dot nivelin që një mashkull mund të arrijë në lidhje me shkencat dëshmuuese dhe me çështjet racionale. Sidoqoftë, ajo është e barabartë me të në fushën e literaturës, të artit dhe të të gjitha çështjeve, që janë të lidhura me shijen dhe me dashurinë.

8- Në të shumtën e rasteve, mashkulli ka më shumë fuqi të mbajë një sekret dhe fjalët shqetësuese në brendinë e tij.

Aspekti i ndryshimit emocional

Dëshira e mashkullit është që ta shoqërojë femrën kudo dhe ta vendosë atë nën komandë e tij. Kurse qëllimi i femrës është që ta fitojë zemrën e mashkullit dhe të dominojë tek ai përmes zemrës. Ai, dëshiron ta kontrollojë atë nga lart, ndërsa ajo dëshiron të depërtojë brenda zemrës së tij. Femra kërkon nga mashkulli burrëri dhe trimëri, e nga ana tjetër, mashkulli kërkon nga femra bukuri dhe dashuri.

Si t'i studiojmë të drejtat?

Këtu janë dy pika, të cilat duhet të merren në konsideratë, kur duam të studiojmë të drejtat e gruas.

Ato janë:

1- Përshtatshmëri e jo barazi

Në bazë të ndryshimeve që u përmendën midis mashkullit dhe femrës, sqarohet se ajo që i përshtatet një femre, nuk mund t'i përshtatet një mashkulli dhe anasjellas. Nga këtu nuk është e duhur që realitetin e femrës ta praktikojmë te mashkulli dhe atë të mashkullit ta praktikojmë te femra, por duhet që secilit t'i japim atë që i përshtatet me fiziologjinë përkatëse, me karakteristikat e tyre dhe me psikologjinë e tyre. Pra, kërkohet përshtatshmëri mes tyre dhe jo barazi.

2- Pikëpamja e përgjithshme ndaj dispozitave

Pikëpamja e pjesshme mund të jetë një shkak bazë për moskuptimin e legjislacionit islam, sepse Islami përmban legjislacion gjithëpërfshirës. Nëse ne duam të diskutojmë një çështje të caktuar, ne duhet ta diskutojmë brenda gjithë sistemit të legjislacionit dhe jo ta diskutojmë atë duke mos marrë parasysh gjërat që lidhen me të. Prandaj, kur ne i lexojmë këto të drejta, ndaj të cilave vendosen pikëpyetje, ne duhet t'i vendosim brenda kornizave të legjislacionit islam (shariatit). Bazuar në këtë, do të përmendim disa që kanë lidhje me të drejtat e femrës.

Poligamia

S'ka dyshim se poligamia është çështje e lejueshme në Islam. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse keni frikë se nuk bëni drejtësi ndaj jetimeve, atëherë, martohuni me ato gra që ju pëlqejnë: me dy, me tri apo me katër; e, nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua ose me atë që e keni në pushtetin tuaj. Në këtë mënyrë do t'i ruheni padrejtësisë më lehtë.”**²⁵

Shumë njerëz në historinë islame e kanë praktikuar poligaminë pa u kudërshtuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe as nga Imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*). Madje, Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamët (*Paqja qoftë mbi ta!*), në disa raste e rrethana, mjaftoheshin me një bashkëshorte dhe në rrethana të tjera, martoheshin me më shumë se një grua. Si pasojë, akuza e Islamit rreth poligamisë është e paarsyetueshme dhe nuk ka asnjë argument mbështetëse për të.

Pyetja në këtë çështje nuk përmban mendimin e Islamit për poligaminë, sepse ai është i qartë, siç u tha më lart, por pyetja është rreth urtësisë së poligamisë, se përse Islami e lejon këtë gjë.

Vazhdimësia e poligamisë brenda çështjeve të lejueshme

²⁵ Surja “Nisa”, ajeti 3.

është e domosdoshme, por duhet të zbatohet drejtësia mes grave, nga njëra anë, dhe të zgjidhen problemet sociale që mund të bëhen serioze, nga ana tjetër, sepse ka një problem, i cili përbëhet nga dy anë:

1- Shtimi i numrit të femrave në raport me numrin e meshkujve. Kjo për shkak se vdekshmëria te meshkujt është më lartë sesa te femrat, veçanërisht gjatë rinisë, si rezultat i luftërave dhe i punëve të largëta, si dhe për shkak të rreziqeve të ndryshme, me të cilat ata përballen më shumë sesa femrat.

2- E drejta e çdo femre që të krijojë një familje bazuar në besim e në legjislacion. Femra ka të drejtë të ndërtojë familje. Përderisa numri i femrave është shumë më i madh sesa i meshkujve, atëherë mbyllja e portës së poligamisë do të thotë që t'i mbyllësh portën shumë femrave për të krijuar familje. Si pasojë, thirrja për ndalimin e poligamisë është pjesë e natyrës egoiste dhe individuale.

Sheriati islam, me pikëpamjen e tij të balancuar dhe që kërkon zbatimin e drejtësisë në çështjen e poligamisë, e ka lënë të hapur këtë derë.

Autoriteti i meshkujve mbi femrat

Allahu i Madhëruar, në Librin e Tij, thotë: **“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre...”**²⁶

²⁶ Surja “Nisa”, ajeti 34.

Duhet patjetër të sqarohet kjo fjali duke marrë në konsideratë se familja është një shoqëri e vogël e bashkuar. Ajo është si shoqëria e madhe, e cila ka nevojë për lider dhe udhëheqës në çështjet e saj.

Autoriteti i meshkujve mbi femrat është i bazuar në dy pika mbështetëse:

1- **“...meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to...”** Kjo përparësi nuk është një prej vlerave shpirtërore, por ka kuptimin e dallimit praktik me të cilën dallohet mashkulli dhe kjo e bën atë të meritueshëm për autoritet. Kjo është e lidhur me veçoritë, nga të cilat një mashkull dhe një femër janë karakterizuar. Femra, në ndryshim nga mashkulli, në të shumtën e rasteve është më reaguese për shkak të emocioneve të pakontrolluara që ajo ka, gjë që nuk ndodhet te meshkujt.

2- **“...meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre...”**. Shpenzimi për shtëpinë është detyrë e burrit dhe jo e gruas. Është mëse normale se ai që mban përgjegjësinë për shpenzimet në çdo projekt, ai e meriton më shumë që të jetë autoritar në drejtimin e atij projekti.

Trashëgimia

Allahu i Madhëruar, në Librin e Tij, thotë: **“Meshkujve u takon pjesë nga ajo që ua kanë lënë prindërit dhe të afërmit, por, edhe femrave u takon pjesë nga ajo që ua kanë lënë prindërit dhe të afërmit, qoftë ajo pak apo**

shumë, si pjesë e caktuar dhe e detyruar.”²⁷ Islami ia ka legjitimuar femrës trashëgiminë, ashtu siç ia ka legjitimuar mashkullit dhe secilit i ka caktuar pjesën e vet. Por këtu ka një dallim në trashëgiminë e fëmijëve, sepse ata nuk trashëgojnë njësoj ku mashkulli trashëgon dyfishin e asaj që trashëgon një femër. Allahu i Madhëruar thotë: **“Allahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj: mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave...”**²⁸

Po përse ekziston një diferencë e tillë lidhur me trashëgiminë?

Arsyeja e kësaj difference duket duke vështruar dy çështje:

1- Burri është i ngarkuar për shpenzimet e familjes dhe për furnizimin me nevojat materiale, ndërsa gruaja nuk është e ngarkuar për këtë gjë. Madje edhe plotësimi i nevojave të saj materiale individuale, është përgjegjësi e burrit, qoftë baba ose bashkëshort. Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka.”**²⁹ Meqenëse mashkulli është përgjegjës për shpenzimet e familjes, kjo është mëse normale që ai të ketë parasysh shpërndarjen e trashëgimisë, me qëllim që shpërndarja e saj të jetë në përputhje me përgjegjësitë e secilit prej tyre (mashkullit dhe femrës). Nga këtu, nuk është e çuditshme që mashkulli të trashëgojë dyfishin e femrës.

²⁷ Surja “Nisa”, ajeti 7.

²⁸ Surja “Nisa”, ajeti 11.

²⁹ Surja “Bekare”, ajeti 286.

2- Mashkulli është ai që pagan prikën e gruas në kontratën martesore. Kjo, gjithashtu, përforcon dallimin në shpërndarjen e financave, në mënyrë që shpërndarja e pasurisë të jetë në përputhje me përgjegjësitë. Një përqindje e madhe e trashëgimisë së meshkujve do të shkojë për gruan, qoftë ajo vajza apo bashkëshortja, për të cilat ai duhet të shpenzojë. Nga ana tjetër pasuria e gruas mbetet e gjitha për të dhe asnjë nuk ka të drejtë ta prekë atë.

Kështu që, kur ne e studiojmë trashëgiminë si burim prej burimeve financiare, duhet ta studiojmë atë brenda sistemit finciar islam, me qëllim që të sigurohet barazia midis tyre.

Përmbledhje e mësimit

Ndërmjet meshkujve dhe femrave ekzistojnë disa ndryshime lidhur me aspektin e aftësive fiziologjike dhe psikologjike. Këto ndryshime nuk kanë lidhje me mangësinë dhe përsosurinë, por ky ndryshim është drejtësi dhe përshtatshmëri. Gjithsesi, kjo është ekuivalente dhe adekuate. Ligji i krijimit, nga kjo diferencë, dëshiron një përshtatshmëri midis mashkullit dhe femrës, që janë të destinuar të jetojnë së bashku.

Kërkimi rreth ndryshimeve midis femrave dhe meshkujve nuk është diçka e re. Atë e gjejmë në thellësi të historisë.

Pikëpamja e pjesshme mund të jetë një shkak bazë për moskuptimin e legjislacionit Islam, sepse Islami përmban legjislacion gjithëpërfshirës. Nëse ne duam të diskutojmë një çështje të caktuar, ne duhet ta diskutojmë brenda gjithë sistemit të legjislacionit dhe jo ta diskutojmë atë duke mos marrë parasysh gjërat që lidhen me të.

Përparësia e mashkullit në thënien: “...meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to...” nuk është përparësi në vlerat shpirtërore, por ka kuptimin e dallimit praktik me të cilën dallohet mashkulli dhe kjo e bën atë të meritueshëm për autoritet. Kjo është e lidhur me veçoritë, nga të cilat, një mashkull dhe një femër janë karakterizuar dhe nuk është meritë shpirtërore, Kjo është e lidhur me disa tipare, me të cilat mashkulli dhe femra janë karakterizuar.

Ka ndryshim edhe në trashëgiminë midis fëmijëve. Mashkulli merr dyfishin e asaj që merr femra. Ky ndryshim ka shumë shkaqe, prej tyre është se: Mashkulli është përgjegjës për shpenzimet e familjes dhe për sigurimin e nevojave materiale, ndërkaq femra nuk është përgjegjëse për këtë. Një përqindje e madhe e trashëgimisë së meshkujve do të shkojë për femrën, qoftë vajza apo bashkëshortja, për të cilat ai duhet të shpenzojë. Nga ana tjetër, pasuria e gruas mbetet e gjitha për të dhe asnjë nuk ka të drejtë ta prekë atë.

Pyetjet e mësimit

- 1- Përmend disa nga dallimet fiziologjike midis mashkullit dhe femrës.
- 2- Përmend disa nga dallimet psikologjike midis femrës dhe mashkullit.
- 3- Cila është urtësia legislative në lejueshmërinë e poligamisë?
- 4- Përse trashëgimia e mashkullit është sa dyfishi i trashëgimisë së femrës?
- 5- Cili është kuptimi i këtij ajeti fisnik “...meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to...”?

Tregim

Ummu Kulthum

Zonja Ummu Kulthum është vajza e Ali ibn Ebi Talib (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe vajza e Fatime Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo është gruaja e cila luftoi për hir të Allahut me anë të fjalëve dhe veprave. Ajo vjen pas Sejide Zejnebes (*Paqja qoftë mbi të!*) në moshë dhe në përparësi. Ajo ishte partnerja e saj (Zejnebes) në mbajtjen e barrës pas martirizmit të Imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) në Qerbela.

Zonja Ummu Kulthum shkoi në Kufe në kohën e udhëheqjes së babait të saj, Prijësit të Besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*), pasi e kishte bërë Kufen kryeqytet të shtetit të

tij. Ajo jetoi në shtëpinë e tij modeste dhe mësoi prej tij moralet fisnike. Mirëpo, kur ajo hyri në Kufe për herë të dytë, hyri si robinë me robinat e Qerbelasë.

Ajo hyri në Kufe me kokën e vëllait të saj, Imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të të gjithë martirëve të Qerbelasë të vendosura mbi shtiza. Ajo ishte shumë e trishtuar nga ajo që pa nga mëshira e njerëzve për ata, të cilët ofronin bukë dhe hurma për fëmijët. Ajo ua merrte lëmoshën fëmijëve nga gojat dhe duart dhe thoshte: “O njerëz të Kufes, lëmosha është haram për ne.”

Ajo mbajti në mesin e tyre një fjalim, ku tha: “O njerëz të Kufes! Turp t’ju vijë. Çfarë po ndodh me ju? Ju e zhgënjyet Hysejnin dhe e vratë atë. Ju vodhët paratë dhe trashëgiminë e tij, morët si robina gratë e tij dhe e hidhëruat atë. Mjerim për ju dhe larg nga ju! A e dini ju se në çfarë djalli jeni shndërruar?...”

Fjalimi i saj, përgjatë rrugës së robërve, zbuloi politikat e poshtra, të cilat thurnin intriga e komplete kundër Islamit dhe kundër simboleve të tij. Veç kësaj, ajo shpërndau mes njerëzve një poezi, e cila ngjalli emocione. Kështu njerëzit do të zgjoheshin nga gjumi për të kundërshtuar padrejtësinë emevite.

Poezia ishte:

*Ne jemi të humbur dhe pa roje
dhe ne jemi duke vajtuar për vëllezërit tanë
Po kalërojmë nëpër male
duke mbajtur devetë*

Dhe ne jemi të gjithë vajzat e Jasinit dhe Ta'ha-së³⁰
Dhe ne jemi duke derdhur lot mbi baballarët tanë
Oh gjyshërit tanë! Ata vranë Hysejnin
Oh gjyshërit tanë! Armiqtë e realizuan
Dëshirën e tyre dhe e morën gjakun nga ne.*

Kjo është Ummu Kulthum, gruaja që na mëson se si të luftojmë për hir të Allahut, me anë të fjalëve dhe veprave.

³⁰ Emra të tjerë të të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe falmiljen e tij!)

Mësimi tretë

TË MËSUARIT E FEMRËS

Rëndësia e dijes

Në asnjë fe, në asnjë ideologji dhe në asnjë medh'heb nuk mund të gjejmë atë përkujdesje e shenjtëri ndaj dijes, siç e gjejmë në Islam. Ajeti i parë që i zbriti Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte: **"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte."**³¹

Allahu i Madhëruar e ka shoqëruar leximin me përmendjen e Tij, në mënyrë që të dëshmojë lidhjen midis dijes dhe besimit në Allahun e Madhëruar. Më pas, Ai e bëri dijen një nga kriteret e parapëlqimit midis njerëzve ku thotë: **"...Thuaj: 'A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm të zotët e mendjes i pranojnë këshillat!'..."**³² Më pas, Ai i lavdëron dijetarët: **"...Allahu do t'i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija. Allahu di çdo gjë që**

³¹ Surja "Alak", ajetet 1-5.

³² Surja "Zumer", ajeti 9.

punoni.”³³

Humbja e një dietari shkakton një boshllëk, të cilin nuk mund ta mbyllë asgjë.

Transmetohet se Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Besimtari i ditur ka më shumë shpërblim se sa agjëruesi, namazfalësi dhe luftuesi në rrugën e Allahut. Kur ai (dietari) vdes, në Islam ndodh një boshllëk që është mjaft e vështirë të mbyllet deri në Ditën e Gjykimit.”³⁴

Vallë, përse Allahu i Lartësuar i jep rëndësi dijes? Pse gjendet gjithë ky dimension shpirtëror, kjo pozitë dhe kjo përparësi për dietarin nga ana e Allahut?

Domosdoshmëria e dijes për njeriun

Ky interesim për dijen nuk ka ardhur nga asgjëja. Ky interesim ka argumentet e tij të posaçëm, për të cilin tregojnë transmetimet. Dija ka lidhje të fortë me fenë e drejtë të ardhur nga Allahu. Këtë lidhje e përmend edhe Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahu qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) në thënien e tij: “Dija është jeta e Islamit dhe shytylla e fesë.”³⁵

Allahu i Madhëruar është i Vërteti Absolut. Sa më shumë ta shtojë njeriu dijen, aq më shumë afrohet tek Allahu i Madhëruar. Allahu i Lartësuar thotë: “**Ata, të cilëve u është dhënë dituria, e shohin se ajo, që të është**

³³ Surja “Muaxhedele”, ajeti 11.

³⁴ “Biharul Anuar”, vëll. 2, f. 17.

³⁵ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 1, f. 463.

zbritur ty nga Zoti yt, është e vërteta, e cila të udhëzon në rrugën e të Plotfuqishmit dhe të Denjit për çdo lavd.”³⁶

Gjithashtu, Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe që ata, të cilëve u është dhënë dituria, ta kuptojnë se ai (Kur’ani) është e Vërteta nga Zoti yt, ta besojnë atë dhe zemrat e tyre të binden e të qetësohen me të. Nuk ka dyshim se Allahu i udhëzon në rrugën e drejtë ata që besojnë.”**³⁷

Dija nuk është e kufizuar me disa tema të specifikuar ose me një periudhë. Ajo është e gjitha mirësi, kudo që të jetë. Në një transmetim të ardhur nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: *“Dija është burimi i të gjitha të mirave, ndërsa padituria e injoranca është burim i çdo të keqeje”*.³⁸

Këtu do të përmendim disa çështje në lidhje me dijen.

1- Nxënia (përftimi) i njohjes

Njohja është e domosdoshme në vetevete dhe nuk ka nevojë për asgjë tjetër për ta justifikuar, veçanërisht kur i përket dijeve themelore, të cilat lidhen me Krijimin dhe me Ringjalljen. Për këtë, Kur’ani i Shenjtë na mëson që kurrë të mos na shuhet dëshira për dije, por gjithmonë të studiojmë sa më shumë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe thuaj: ‘Zoti im! Më shto mua dijen.’”**³⁹

³⁶ Surja “Sebe”, ajeti 6.

³⁷ Surja “Haxhxh”, ajeti 54.

³⁸ “Mizanul Hikme”, vëll. 3, hadithi 2064.

³⁹ Surja “Ta’ha”, ajeti 114.



2- Kushti paraprak për punë

Çdo vepër, qoftë e madhe ose e vogël, ka nevojë për premisa shkencore. Sa më shumë t'i njohë njeriu ato premisa dhe të veprojë sipas udhëzimeve të tyre, aq më e mirë dhe më e qëndrueshme do të jetë puna e tij. Në një transmetim nga Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Allahut i pëlqen ai njeri, i cili kur e bën një punë, e perfeksionon atë.”⁴⁰

3- Udhëzimi i shoqërisë

Nëse injoranca do të jetë specifike e shoqërisë, pa dyshim se rregullat në të do të ishin si në ligjin e xhunglës. Një person injorant, në natyrën e tij, nuk trembet nga arsyja, por trembet kur ndien një fuqi më të madhe se fuqia e tij. Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Injoranti nuk trembet, veçse nga mprehtësia e shpatës.”⁴¹

4- Zgjidhja e çdo problemi

Kudo që depërton injoranca, aty depërton shkatërrimi. Për këtë, shumica e problemeve shoqërore e kanë burimin te injoranca dhe mungesa e dijes. Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Injoranca është shkatërrim i çdo çështjeje.”⁴²

⁴⁰ “Amali” i Sheikh Tussi, f. 428.

⁴¹ “Mizanul Hikme”, vëll. 1, f. 462.

⁴² “Mizanul Hikme”, vëll. 1, f. 462.

Dija nuk është e veçantë vetëm për meshkujt

Pasi u njohëm me lidhjen e dijes me fenë dhe me njohjen e Allahut, me lidhjen e saj me perfeksionimin e punëve, me lidhjen e saj me udhëzimin e shoqërisë dhe se pasi kuptuam se injoranca është burimi i shkatërrimit, pas gjithë kësaj, a mund të thuhet se dija është e posaçme vetëm për meshkujt, duke ia hequr të drejtën femrës?

Për këtë, në një transmetim të Profetit fisnik (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Kërkimi i dijes është një detyrë për çdo mysliman dhe myslimane. Vërtet, Allahu i do ata që e kërkojnë diturinë.”⁴³

Pra, dija nuk është vetëm për meshkujt. Mësimi për femrat, jo vetëm që nuk është i ndaluar, por është i nevojshëm dhe i pëlqyeshëm. Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: “Kush ka një vajzë, të cilën e edukon mirë, e mëson mirë dhe jep nga mirësitë e Allahut, ai do të jetë i mbrojtur ndaj Zjarrit.”⁴⁴

Mjediset e të mësuarit

Shkollat, fakultetet, universitetet dhe të gjithë fushat e nxënies së dijes duhet të jenë të shëndetshme, të pastra dhe ndihmuese në përmbushjen e dëshirave të të mësuarit. Dija

⁴³ “El Kafi”, vëll. 1, f. 30.

⁴⁴ “Mizanul Hikme”, vëll.1, f. 65.

duhet të jetë lartësuese për njeriun dhe për vlerat njerëzore. Me fjalë të tjera, ajo duhet të jetë shtylla e fesë dhe ftuese në njohjen e Krijuesit dhe në zbatimin e moraleve të larta njerëzore.

Prioritetet e të mësuarit

Cilat janë prioritetet e të mësuarit në lidhje me gruan? Ka shumë çështje themelore dhe të domosdoshme, prej të cilave, përmendim:

1- Njohuritë themelore (besimi, jurisprudenca dhe morali)

Transmetohet se Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mësimi është tre llojesh: argument i fortë, detyrim i drejtë ose një traditë e vazhdueshme. Çdo gjë tjetër përveç këtyre është si tepricë.”⁴⁵

Këto dije janë të domosdoshme për çdo grua, në çdolloj pozicioni qoftë ajo, pasi ajo është e urdhëruar, përpara çdolloj gjëje, ta ndreqë veten e saj në nivel njohjeje, besimi, spiritualiteti, morali, sjelljeje dhe jurisprudence. Të gjitha këto janë të domosdoshme për femrën, në çdolloj vendi që të jetë.

2- Metodat e të vepruarit në familje

Roli i parë, me të cilën përballet një grua, është ai në familje, si vajzë, motër, grua dhe nënë. Të gjitha këto role

⁴⁵ “El Kafi”, vëll. 1, f. 32.

kanë një specifikë të veçantë dhe një ndikim vendimtar në familje, veçanërisht roli i nënës, e cila nxjerr në shoqëri fëmijë punëmirë, si: dijetarë, luftëtarë për hir të Allahut, martirë e të devotshëm.

Nga këtu, një nënë duhet të mësojë mjetet e edukimit dhe duhet të njohë karakteristikat dhe ndryshimet e fëmijëve, sipas moshës dhe natyrës së tyre. E gjitha kjo e ndihmon shumë atë në misionin e saj si nënë dhe si bashkëshorte. Shumica e problemeve dhe boshllëqeve vijnë si pasojë e injorancës. Sa më mirë të njihen rolet, aq më i mirë jetohej jeta.

3- Shërbimet që ndihmojnë në realizimin e klimës së vërtetë islame

Vërtet, femra përbën gjysmën e shoqërisë. Ajo ka nevojë për shërbime sociale, psikologjike dhe mjekësore. Nëse në shoqëri nuk gjenden femra të specializuara në këto fusha, që të përmbushin nevojat e tyre, atëherë ajo do të jetë e detyruar të këshillohet me mashkullin. Kjo është një çështje e pahijshme, nëse nuk është domosdoshmëri. Si rezultat, femra duhet të specializohet në ato fusha ku ka nevojë.

4- Nevojat e shoqërisë

Çdo shoqëri ka nevojat e saj, të cilat ndryshojnë nga një vend, në një tjetër, në varësi të rrethanave dhe kërkesave. Interesimi për këto nevoja dhe specialitete, është i nevojshëm.



Përmbledhja e mësimit

Në asnjë fe, në asnjë idelogji dhe në asnjë medh'heb nuk mund ta gjejmë atë përkujdesje e shenjtëri ndaj dijes, siç e gjejmë në Islam.

Rolet e të mësuarit janë:

- 1- Përvetësim i dijeve
- 2- Premisa për punësim
- 3- Arsyetimi i shoqërisë
- 4- Një zgjidhje për të gjitha problemet

Nëse dija do të ishte diçka e veçantë vetëm për meshkujt, kjo do të nënkuptonte se feja, njohja e Allahut të Lartësuar, perfeksionimi i veprave dhe udhëzimi i shoqërisë do të ishin detyra vetëm për meshkujt. Një ide të tillë nuk e pranon askush.

Shkollat, fakultetet, universitetet dhe të gjitha fushat e nxënies së dijes duhet të jenë të shëndetshme, të pastra dhe ndihmuese në përmbushjen e dëshirave të të mësuarit. Dija duhet të jetë lartësuese për njeriun dhe për vlerat njerëzore. Me fjalë të tjera, ajo duhet të jetë shtylla e fesë dhe ftuese në njohjen e Krijuesit dhe në zbatimin e moraleve të larta njerëzore.

Kjo realizohet nëpërmjet dy çështjeve:

- 1- Femra nuk duhet të jetë e pavëmendshme kundrejt synimit për të mësuar, që është përsosuria e njeriut, si individ dhe si shoqëri, përndryshe, pavëmendshmëria është shkak i humbjes.
- 2- Të jetë e ndershme, e dëlirë, zbatuese e rregullave të

Sheriatit dhe ndjekëse e Islamit. Fatime Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*) është shembulli më i mirë për gratë e të gjitha botëve. Një prej epiteteve të saj ishte “e ditura”. Çdo grua dijetare ose mësuese duhet ta ketë gjithmonë zonjën Fatima Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*) përpara syve të saj dhe të përpiqet ta ndjekë atë në çdo lëvizje e në çdo qëndrim të saj.

Disa nga çështjet themelore që një femër duhet të dijë janë:

- 1- Dijet themelore (besimi, jurisprudenca, morali)
- 2- Metodat e sjelljes në familje
- 3- Shërbimet që ndihmojnë në realizimin e klimës së vërtetë islame
- 4- Nevojat e shoqërisë

Pyetje plotësuese

1. Cili është roli me ndikim më të madh, për të cilin, Islami synon realizimin e tij me anë të të mësuarit?
2. Cili është qëndrimi i Islamit në lidhje me të mësuarit e femrës?
3. Cilat janë çështjet të cilat ndihmojnë në realizimin e qëllimeve të të mësuarit?
4. Cilat janë çështjet më të rëndësishme, të cilat gruaja duhet t'i mësojë?
5. Çfarë nënkuptohet me nevojën që gruaja duhet të mësojnë nevojat e veçanta të shoqërisë?

Tregim

Martirja Emine Sadr (Bintul Huda)

Emine Sadr lindi në qytetin Kadhimijeh, më 1973 (kalendari gregorian) ose 1357 hixhri.

Ajo ishte vajza e Sejid Hajdar Sadr, një prej studiuesve dhe prej kërkuesve më të shquar. Ishte motra e martirit Muhamed Bakr Sadr (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*). Në shtëpinë e saj, e cila njëkohësisht ishte edhe shtëpia e dijes, martirja Bintul Huda studioi: gjuhë letërsi, logjikë, jurispundencë, parimet e jurisprudencës. Ajo studioi edhe dijet e shkencat e tjera, në shkollën shtetërore. Të shumtë

janë dëshmitarët prej dijetarëve që dëshmojnë për diturinë dhe pozitën e saj të lartë.

Në 1967, ajo iu drejtua mësimdhënies dhe u bë përgjegjëse e shkollës “Al Zahra”. Ajo kishte prani të fuqishme në mesin e femrave dhe në fushën e letërsisë e të retorikës. Shkrimet e saj karakterizohen nga një sharm i veçantë. Megjithëse shumica e shkrimeve të saj kanë kontekst tregimesh, në faqet e tyre gjithmonë ka mesazhe për të rinj. Poema që i drejtohet femrave myslimane është:

*Nëse të është thënë që ti je jashtë mode,
mos u shqetëso dhe e palëkundur vazhdo të jesh
Thuaj: unë jam vajza e mesazhit,
druajtja ime nuk më ka privuar mua nga lartësia
Ajo nuk më ka vënë pranga tek duart. Jo!
Mbulesa nuk më pengon mua nga dëshirat e mia!
O motër, e nesërmja është e jona!
Vazhdo rrugën dhe ngjitu lart!*

O motër, e vërteta ngrihet mbi dinakëritë e agresorit!

Disa nga shkrimet e saj janë:

*Al Fadil’letu Tantasir (Moral i mirë është triumfues),
Kelimetun ue da’uetun (Thënie dhe thirrje), El mer’atu mea
Nebij (Gruaja me Profetin), Imr’etani ue rexlulun (Dy femra
dhe një mashkull), Dhikraja ala tilalil Meketi (Kujtime në
kodrinat e Mekës), El Bahithetu anil hakikati (Kërkuesja e së
vërtetës), El Khaletu Ed Daiatu (Tezja e humbur), Butulatul
mer’atil myslimeh (Heroizmat e femrës muslimane)...*

Martirja Bintul Huda nuk u mjaftua vetëm me veprimtaritë kulturore e sociale. Ajo arriti edhe në fushën politike. Ajo luajti një rol të madh në përhapjen e ideve të Shehid Sejid Sadr në mesin e femrave në përputhje me qëndrimet politike në atë kohë. Përveç kësaj, ajo punoi në mobilizimin e femrës në mënyrë që t'i rezistonte ideve dhe planeve të sistemit diktatorial e të padrejtë, si dhe, mori pjesë në krijimin e një shpirti luftarak kundër armiqve të Islamit.

Në 1977 Martiri Sejid Sadri u arrestua. Martirja Bintul Huda vazhdoi rrugën e saj duke u frymëzuar nga hapat e Sejide Zeineb (*Paqja qoftë mbi të!*), pa patur frikë nga asgjë. Ajo shkoi në xhaminë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), duke u bërë thirrje njerëzve dhe duke i nxitur ata për revolucion me zë të lartë: *"O gjyshi im, o Prijësi i besimtarëve! Unë u ankova tek Allahu dhe tek ty për brengat, padrejtësitë dhe keqtrajtimet që po na bëhen neve."* Dhe pas kësaj, ajo iu drejtua njerëzve me thënien: *"O ju fisnikë! A do të heshtni, ndërkohë që udhëheqësi juaj është arrestuar? A do të heshtni, ndërkohë që Imami juaj është burgosur dhe torturohet? Çfarë do t'i thoni gjyshit tim, Prijësit të besimtarëve, kur t'ju pyesë për tradhtinë tuaj? Shkoni jashtë! Protestoni!"*

Kur tirani e diktatori Saddam Huseini e kuptoi se Martirja Bintul Huda dhe vëllai i saj përbënin rrezik për regjimin diktatorial e tiran, urdhëroi arrestimin e tyre. I torturoi shumë rëndë. Kjo çoi në martizimin e Sejid Sadr dhe motrës së tij të pastër Bintul Huda (*Allahu qoftë i kënaqur me ata!*).

Mësimi i katërt

MBULIMI

Hyrje

Mbulimi është një nga çështjet më të rëndësishme të diskutuara në shoqëritë në nivel të përgjithshëm social për shkak se ka një ndikim mjaft të madh në përcaktimin e identitetit të shoqërisë dhe luan rol themelor dhe vendimtar përsa i përket sjelljes së shoqërisë, burra e gra.

Si rezultat, mbulimi ka qenë dhe është gjithmonë i ekspozuar ndaj shtrembërimeve, polemikave dhe dyshimeve. Ai ndodh edhe të luftohet nëpërmjet ligjeve kufizues dhe ndalues me anë të përpjekjes për t'i mënjeluar femrat e mbulura, përmes akuzave të prapambetjes, pikëpamjeve të ngushta dhe fanatizmit.

Kjo tregon rëndësinë e madhe të mbulimit (hixhab) në rolin e tij vendimtar në konfliktin midis së vërtetës dhe të së pavërtetës, farsës. Mbulimi është një fortesë e lartë, e cila mbron të vërtetën. Si pasojë, nëse ai zhduket, Allahu mos e dhëntë, rezultati do të jetë shkatërrim i menjëhershëm i shumë koncepteve dhe i sjelljeve. Braktisja e mbulimit nuk është largim i një fruti prej frutave të Islamit, por është i

ngjashëm me lëkundjen e tryezës së të vërtetës nga çdo aspekt sjelljeje. Në këtë mënyrë, të gjithë frutat do të bien poshtë dhe do të zëvendësohen nga zek'kumi (një pemë e Xhehenemit me fruta të hidhura) dhe nga lëndët e gënjeshtërs.

Mbulimi në rrugëtimin njerëzor

Mbulimi nuk ka qenë i kufizuar me një periudhë kohe të caktuar të rrugëtimit njerëzor. Kur studiojmë historinë, zbulojmë se mbulimi është shumë i hershëm në historinë e njerëzimit, po aq sa e vërteta dhe gënjeshtër. Kur erdhi Islami dhe zbriti Kur'ani i Shenjtë, njerëzimi u ndihmua të lëvizte drejt nivelit të civilizimit. Kjo është e njohur nga armiqët, përpara së të njihej nga miqtë.

Femrës iu kërkua që ta vendoste hixhabin në kohën kur disa njerëz bënë Tauaf lakuriq rreth Qabes. Në shoqërinë xhahilite (injorante) gjendeshin shtëpi ku ishte ngritur flamuri i kuq (shtëpitë ku kryheshin kurvllëku). Kur ne lexojmë historinë e Profetëve (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), hasim në këto dy linja: linja e udhëzimit dhe linja e devijimit. Por kur flasim për të ardhmen dhe për atë që njerëzia do të arrijë në fund të kësaj jete, do të gjejmë se mbulimi do të jetë e ardhmja, të cilën do ta zbatojë shoqëria njerëzore.

Eksperiencia njerëzore na ka treguar se zbulimi është shkak i prapambetjes në shoqëri, në shumë aspekte sociale dhe shkak i shumë problemeve të rrezikshme, nga të cilat

shoqëria perëndimore po vuan në ditët e sotme. Mjafton një krahasim i vogël mes sigurisë së një gruaje të pambuluar në perëndim dhe sigurisë së një gruaje që mban mbulesën në shoqërinë islame, pavarësisht zbehjes së zbatimit të kësaj detyre në këto ditë.

Mbulimi është përsosuri, perfeksion, zhvillim dhe siguri, të cilat përfaqësojnë të vërtetën. Nga ana tjetër, zbulimi është mangësi, prapambetje, konfuzion dhe pasiguri, të cilat përfaqësojnë gënjeshtren. Mbulimi është një detyrë nga Allahu i Madhëruar dhe i Lartësuar. Për këtë, ai është perfeksion, zhvillim dhe siguri për ata që besojnë në Allah dhe në atributet e Tij. Ai nuk është as mangësi e as prapambetje. Do të vijë dita e premtuar, në të cilën do të gjendet vetëm flamuri i së vërtetës. Kjo do të ndodhë kur të vijë Imami i Pritur, Al Huxhetul ibul Hasa, Imam Mehdiu (*Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!*): **“Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.”**⁴⁶

Cili është kuptimi i mbulimit?

Në librat e gjuhësisë, thuhet se fjala *hixhab* do të thotë: “Çdo gjë që pengon diçka nga diçka tjetër, atëherë ai e mbulon atë. Hixhabi është ai që mban diçka larg një diçkaje tjetër.”⁴⁷

Kur flasim për mbulimin e gruas, ne synojmë ndalimin e

⁴⁶ Surja “Enbija”, ajeti 105.

⁴⁷ “Kitabul Ajn”, vëll. 3, f. 86.

burrave të panjohur nga të shikuarit e trupit të femrave. Mbulimi shërben si pengesë ndaj të shikuarit, pa marrë parasysh natyrën e ndaluesit.

Çfarë kërkohet nga mbulimi?

Kemi dy çështje lidhur me pjesët e zbuluara të trupit. Ato janë: ngjyra e lëkurës dhe forma trupore. A duhet mbuluar njëra prej tyre? Apo të dyja? Sa i përket lëkurës, pa dyshim që duhet mbuluar. Sa për formën, ajo nuk duhet të mbulohet totalisht, vetëm pjesët që shkaktojnë joshje.

Argumenetet e mbulimit

Në lidhje me mbulimin, janë tri çështje që duhet të njihen:

1- Ndaj kujt duhet të mbulohet një femër?

Femra duhet të mbulohet përpara burrave të panjohur dhe para çdo mashkulli tjetër përveç atyre që Allahu i përjashton në Librin e Tij. Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaju besimtareve që t’i ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t’i mbulojnë krahatorët me mbulesat e tyre (të kokës) dhe t’ua shfaqin stolitë e tyre, vetëm bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre, ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të**

vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim (si skllave), ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave. Dhe të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!”⁴⁸

2- Çfarë duhet të mbulojë gruaja?

Femra duhet t’i pengojë shikimet e meshkujve të panjohur në çdo pjesë të trupit të saj, përveç fytyrës dhe duarve. Për këtë, ka disa argumente nga ajetet kur’anore dhe nga hadithet e të pagabueshmëve (*Paqja qoftë mbi ta!*).

a- Thënia e Allahut të Madhëruar: **“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme...”**⁴⁹

Ky ajet fisnik paraqet disa pika:

1- Besimtarët meshkuj e femra duhet t’i ulin shikimet e tyre dhe të mos e shikojnë njeri-tjetrin me vështrim të ngulitur dhe të tepërt.

2- Meshkujt dhe femrat besimtare duhet t’i mbrojnë pjesët e tyre të turpshme. Si pasojë, kjo kërkon një punë të

⁴⁸ Surja “Nur”, ajeti 31.

⁴⁹ Surja “Nur”, ajeti 31.

vështirë, në mënyrë që të ruajnë nderin dhe pastërtinë.

3- Stolitë duhen mbuluar. Ekzistojnë dy lloje stolish: të fshehta dhe të dukshme. Stolitë e fshehta janë ato që janë të fshehura poshtë rrobave nga shikimet e shikuesve, si: varset, vathët, ngjyra e flokëve etj. Stolitë e dukshme janë: fytyra dhe duart.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): Çfarë stolish të shfaqë femra? Ai është përgjigjur: “Fytyrën dhe dy duart.”⁵⁰ Kjo do të thotë se ajo duhet të mbulojë të gjithë trupin e saj, përveç fytyrës dhe duarve.

Më pas Allahu i Madhëruar thotë: **“Le t’i mbulojnë kraharonët me mbulesat e tyre (të kokës)...”**

Percja është një rrobë me të cilën femrat mbulojnë kokën dhe qafën. Xhejib është pjesa e hapur në bluzë, e cila hapet nga qafa për në kraharon. Thuhet se gratë në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vishnin rroba të hapura nga qafa deri te kraharoni dhe i hidhnin shamitë e tyre pas koke duke shfaqur veshët, vathët, qafat dhe diçka prej gushës së tyre për shikuesit.

Si rezultat, ajeti i urdhëron ato që ta lëshojnë mbulesën e kokës në atë mënyrë që të mbulojnë veshët, vathët dhe kraharonin e tyre.

b- Thënia e Allahut të Lartësuar: **“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo**

⁵⁰ “*Uesailu Shia*”, vëll. 4, f. 146.

është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”⁵¹.

Ky ajet përban një urdhër të qartë për lëshimin poshtë të mantelit. Por çfarë do të thotë mantel? Dhe si ta lëshojmë atë poshtë?

Manteli është një rrobë që femra e vesh për të mbuluar të gjithë trupin e saj.

Edhe perçja është e njohur si mantel. Duket që manteli këtu është përdorur në kuptimin e perçes; dhe se duhet ta hedhim poshtë në mënyrë që të mbulojmë pjesën e qafës dhe të kraharorit me të. Ky ajet manifeston atë që është përmendur më parë, por këtu i është shtuar: “...Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen...”

Dy mendime mbi mbulimin e femrës

Ka dy lloj konceptesh rreth mbulimit të femrës.

1- Koncepti negativ i mbulimit. Sipas tij, femra e mbuluar nuk do të ketë mundësi të jetë aktive në jetën shoqërore. Atëherë, jeta e saj do të jetë vetëm shtëpia dhe nuk do të ketë asnjë lidhje me shoqërinë. Ky mendim rrjedh nga baza jofetare. Ky koncept nuk është në përputhje me Kur'anin. Allahu i Lartësuar thotë: **“Besimtarët dhe besimtaret janë miq për njëri-tjetrin. Ata**

⁵¹ Surja "Ahzab", ajeti 59.



urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat..."⁵²

Gjithashtu, kjo është në kontradiktë me historinë islame. Zonja Fatime Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një themel prej themeleve kryesore në shoqërinë islame. E tillë ishte edhe Zonja Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) me rolin e saj, sidomos me rolin e njohur pas Qerbelasë me mbajtjen e mesazhit të përjetshëm. Madje edhe para ndodhisë së Qerbelasë, ajo kishte një rol shumë të madh në shoqëri, veçanërisht në shoqërinë e femrave.

2- Koncepti pozitiv i mbulimit. Sipas tij, femra e mbuluar është e mbrojtur në shoqëri. Mbulesa i siguron asaj një atmosferë të duhur, që e ndihmon në punë dhe në aktivitete. Në realitet, ky mbulim është shtytës drejt punës, aktivitetit dhe influencës, siç ishte Zonja e grave Fatime Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*), nëna e saj, Hatixheja (*Paqja qoftë mbi të!*) para saj, Zonja Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) pas saj dhe femrat e mesazhit në përgjithësi.

Imam Khomeini ka thënë: "Islami e përgatit femrën, që edhe ajo të ketë një rol në të gjithë çështjet, ashtu si mashkulli. Ashtu sikurse mashkulli luan rol në të gjitha çështjet, po ashtu, edhe femra e ka këtë këtë rol.

⁵² Surja "Teube", ajeti 71.

Përmbledhje

Mbulimi nuk ka qenë i kufizuar me një periudhë kohe të caktuar të rrugëtimit njerëzor. Kur studiojmë historinë, zbulojmë se mbulimi është shumë i hershëm në historinë e njerëzimit, po aq sa e vërteta dhe gënjeshtra.

Eksperienca njerëzore na ka treguar se zbulimi është shkak i prapambetjes në shoqëri, në shumë aspekte sociale dhe shkak i shumë problemeve të rrezikshme, nga të cilat shoqëria perëndimore po vuan në ditët e sotme.

Mbulimi është përsosuri, zhvillim dhe siguri, që përfaqëson të vërtetën. Nga ana tjetër, zbulimi është mangësi, prapambetje, konfuzion dhe pasiguri, që përfaqëson gënjeshtren. Ai nuk është as mangësi e as prapambetje.

Kur flasim për mbulimin e gruas, ne synojmë ndalimin e burrave të panjohur nga të shikuarit e trupit të femrave. Mbulimi, shërben si barrierë e pengesë ndaj të shikuarit, pa marrë parasysh natyrën e ndaluesit.

Dy mendime mbi mbulimin e femrës

Ka dy lloj konceptesh rreth mbulimit të femrës.

1- Koncepti negativ i mbulimit. Sipas tij, femra e mbuluar nuk do të ketë mundësi të jetë aktive në jetën shoqërore. Atëherë, jeta e saj do të jetë vetëm shtëpia dhe nuk do të ketë asnjë lidhje me shoqërinë. Ky mendim

rrjedh nga baza jofetare. Ky koncept nuk është në përputhje me Kur'anin. Allahu i Lartësuar thotë: **"Besimtarët dhe besimtare të jenë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat..."**⁵³

Gjithashtu, kjo është në kontradiktë me historinë islame. Zonja Fatime Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një themel prej themeleve kryesore në shoqërinë islame. E tillë ishte edhe Zonja Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) me rolin e saj, sidomos me rolin e njohur pas Qerbelasë me mbajtjen e mesazhit të përjetshëm. Madje edhe para ndodhisë së Qerbelasë, ajo kishte një rol shumë të madh në shoqëri, veçanërisht në shoqërinë e femrave.

2- Koncepti pozitiv i mbulimit. Sipas tij, femra e mbuluar është e mbrojtur në shoqëri. Mbulesa i siguron asaj një atmosferë të duhur, që e ndihmon në punë dhe në aktivitete.

⁵³ Surja "Teube", ajeti 71.

Pyetje rreth mësimit

- 1 - A është vetëm Islami që thekson rëndësinë e mbulimit?
- 2 - A ka mbulimi ndonjë ndikim në anëtarët e shoqërisë?
Cili është ky ndikim?
- 3 - Ka dy mendime rreth mbulimit. Cilat janë ato?
- 4 - Çfarë nënkuptohet me mbulim negativ?
- 5 - Çfarë nënkuptohet me mbulim pozitiv?

Tregim

Imam Khomeini dhe mbulimi

Ka shumë thënie të Imam Khomeinit rreth mbulimit dhe qëndrimit bashkë të meshkujve me femrat, të cilat i ka përcjellë familja e tij. Ato thënie, pa dyshim, që janë mësime dhe këshillë për ne. Këtu do të përmendim disa prej tyre.

1- Sejide Fatime Tabatabai ka thënë: *“Imami lëndohej shumë kur dikush e kundërshtonte qartazi Sheriatin. Ai na fliste gjithmonë që të interesoheshim për mbulimin. Madje ai na thoshte që të kishim kujdes që gjatë ngrënies të mos dukeshin më shumë se sa ato pjesë të lejuara me Sheriat.”*⁵⁴

2- Sejide Atifetu El Ishrakij ka thënë: *“Një nga çështjet që Imami interesohet shumë ishte qëndrimi i përbashkët i meshkujve me femrat (el ikhtilat) të cilët nuk janë mahrem⁵⁵ me njëri-*

⁵⁴ Shtojca e gazetës Ittila'at, 14 mars, 1369.

⁵⁵ Një person me të cilin është e ndaluar të martohemi; për shembull, vëllai, motra, nëna, babai, etj..

tjetrin. Kujtoj se një herë, unë nuk isha më shumë se 10 vjeçe dhe po luaja syllambyllsi me vëllezërit e mi, me djalin e tezes time dhe kushirinjtë ndërkohë isha e mbuluar. Imami më thirri dhe më tha: Nuk ka asnjë ndryshim midis teje dhe motrës tënde të madhe. Si ka mundësi që ti po luan me djemtë, kurse ajo nuk luan me ata?⁵⁶

3- Sejide Fatime Tabatabai ka thënë: “Imami nuk e shihte të domosdoshme bisedën me burrat e jo mahem⁵⁷, kështu që ne nuk u uleshim në një dhomë me nipërit e tij kur ishim në shtëpinë e Imamit, nëse ai e kishte arritur moshën e kryerjes së detyrave fetare. Një nga gjërat më të çuditshme, ndërkohë që ne ishim të ulur në shtëpinë e Imamit, ishte se nëse një nga nipërit e tij hynte në dhomë, ai pyeste atë që të dilte jashtë. Gjithashtu, nëse unë ulesha me Imamin dhe një nga nipat e tij që kishte arritur moshën e përgjegjësisë islame dëshironte të hynte, Imami e ndalonte atë të hynte, për shkak të pranisë time aty, edhe pse nipi i tij ishte në të njëjtën moshë me djalin tim.”⁵⁸

4- Sejide Zahra El Mustafai ka thënë: “Imami ishte shumë strikt në lidhje me të qëndruarit e meshkujve dhe femrave jo mahrem në një vend të përbashkët. Për shembull, mosha e fëmijëve të mi dhe e vëllait tim, Sejid Ahmedit ishin të përafërta (pesëmbëdhjetë – gjashtëmbëdhjetë vjeç). Nëse një ditë ne ftoheshim nga Imami për drekë, nuk i merrnim fëmijët me vete. Nëse i merrnim me vete, djemtë shkonin në shtëpinë e Sejid Ahmedit, ku meshkujt do hanin drekë. Përsa i përket vajzave, ata

⁵⁶ Revista “Zen Rose”, botimi 1267.

⁵⁷ Një person me të cilin është e lejuar martesë.

⁵⁸ Shtojca e Gazeta “Ittila'at”, 14 mars, 1369, për të huaj.

*duhet të hanin në të njëjtin vend me nënat e tyre, në mënyrë që burrat jomahrem, edhe nëse janë farefis, nuk do të ulen në të njëjtën tavolinë.*⁵⁹

5- Sejide Zahra El Mustafai ka thënë: *“Isha pesëmbëdhjetë vjeçe kur Shejkh Ishrakij u martua me motrën time. Një ditë ai na ftoi në një gosti që ishte organizuar në shtëpinë e tij. Shejkh Ishrakij doli jashtë në kopshtin e shtëpisë së tij dhe na uroi mirëseardhjen. Unë pyeta babain tim: ‘A duhet ta përshëndes?’ Ai u përgjigj: ‘Përshëndetja nuk është detyrim.’ Në këtë mënyrë, u detyrova të kaloja në anë të kopshtit për ta evituar përshëndetjen me të.”*

⁵⁹ Revista “Sha’hed Banun”, edicioni 149.

Mësimi i pestë

QËNDRIMI I MESHKUJVE DHE I FEMRAVE NË TË NJËJTIN VEND (El Ikhtilat)

Hyrje

Qëndrimi i meshkujve dhe i femrave së bashku dhe në të njëjtin vend, në përgjithësi, është një tokë pjellorie për rënien në shumë devijime morale dhe psikologjike. Kjo mund ta përshkallëzojë njeriun deri në atë në atë pikë në të cilën ka humbur të gjitha mbrojtjet psikologjike ndaj pëshpëritjes së djallit dhe ngacmimeve të tij duke rënë viktimë nën sundimin e djallit të mallkuar dhe larg mëshirës së Allahut.

Një ambient i tillë, në të cilin qëndrojnë së bashku dy gjinitë, meshkujt dhe femrat, synohet lehtë nga djalli dhe ushtarët e tij. Në këto ambiente, djalli përdor të gjitha armët dhe mjetet e joshjes dhe të zbukurimit dhe arrin ta mposhtë njeriun dhe realizon qëllimin e tij.

Në Kur'anin e Shenjtë lexojmë: **“Iblisi tha: ‘Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t’jua zbukuroj atyre**

(njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë.”⁶⁰

Nga këtu, qëndrimi i meshkujve dhe i femrave në një vend të përbashkët ka një rrezik të veçantë, i cili e bën të nevojshme njohjen e kufijve fetarë, të cilat e ndalojnë njeriun të bjerë në kurthin e djallit dhe të ushtarëve të tij. Njohja e rregullave dhe e kufijve të fesë i ofron njeriu mbrojtje dhe pacenueshmëri, në mënyrë që të mbetet i nderuar dhe krenar në jetën e tij dhe të fitojë shpëtimin në Botën Tjetër.

Cili është kuptimi i qëndrimit të meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend (el ikhtilat)?

Qëndrimi i meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend do të thotë tubim i tyre në të njëjtin vend, kudoqoftë, shtëpi, market, rrugë etj. Më pas çdo takim midis dy gjinive është konsideruar lloj prej llojeve të qëndrimit bashkarisht.

Qëndrimi së bashku i meshkujve me femrat (ikhtilati) mund të zbatohet mes një apo dy personash, por është i vështirë në të gjithë shoqërinë sepse njeriu jeton në shoqëri të përzier, meshkuj dhe femra, ku individët e shoqërisë kanë nevoja reciproke dhe është e vështirë izolimi apo shmangia e plotë midis meshkujve dhe femrave.

Përkundrazi, qëndrimin sëbashku e hasim deri edhe në çështjet e fesë siç është haxhi apo çështje të tjera siç

⁶⁰ Surja “Hixhr”, ajetet 39-40.

tregohet në jetën e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahu qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) ku gratë merrni pjesë në luftë për të mjekuar të plagosurit, apo për t'u dhënë ujë luftëtarëve etj.

Pakësimi i qëndrimit të meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend

Të qëndruarit e meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend, është i domosdoshëm në disa çështje, por kjo nuk do të thotë dorëzim ndaj tij dhe pranim të tij në çdo situatë, sepse të domosdoshmet janë të limituara. Pradaj, nevojitet që qëndrimi i meshkujve dhe i femrave në të njëjtin vend duhet reduktuar sa më shumë të jetë e mundur, siç na udhëzon Kur'ani i Shenjtë për këtë në historinë e folësit me Allahun, Profetit Musa (*Paqja e Allahu qoftë mbi të!*) me dy vajzat e Profetit Shuajib (*Paqja e Allahu qoftë mbi të!*). Allahu i Madhëruar thotë: **"Kur arriti tek pusi i Medjenit, ndeshi rreth tij shumë njerëz që u jepnin ujë kafshëve. Përveç tyre, ai vuri re dy vasha që po mbanin kafshët e veta. Ai tha: 'Si e keni hallin ju?' Ato thanë: 'Ne nuk u japim ujë, pa u larguar barinjtë. Babai ynë është shumë plak.'"**⁶¹

⁶¹ Surja "Kasas", ajeti 23.



Vetmia e ndaluar

Sheriati i shenjtë e ndalon një lloj qëndrimi të meshkujve dhe të femrave në të njëjtin vend. Ai është qëndrimi që shkon deri në vetmi i një mashkulli me një femër që nuk e njohin njëri-tjetrin. Imam Kohmeini (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Kur një mashkull dhe një femër takohen në një vend privat, ku nuk është asnjë njeri tjetër prezent dhe askush nuk munde të hyjë aty, nëse ata frikësohen se mos bëjnë diçka të ndaluar, ata duhet të largohen dhe ta lënë atë vend.”⁶²

Është e mjaftueshme që harami të jetë sa shikimi i ndaluar (me epsh). Të tilla gjëra në vende private janë të ndaluara. Në një hadith të Prijësit të Besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: “Mashkulli mos të qëndrojë në një vend të veçuar me një femër, sepse në qoftë se ata qëndrojnë vetëm në privatësi, shejtani është i treti i tyre.”⁶³

Transmetohet nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ka urdhëruar femrat të mos vajtojnë me zë të lartë, të mos gërvoishtin veten e tyre dhe të mos ulen vetëm me burrat.”⁶⁴

⁶² “Teudihul Mesail Imam Khomeini” (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*), pyetja 2445.

⁶³ “Mustedrekul Uesail”, vëll. 14, f. 265.

⁶⁴ “Mustedrekul Uesail”, vëll. 2, f. 449.



Standardet e lejueshmërisë së qëndrimit të femrave dhe meshkujve në të njëjtin vend

Nëse nuk ka vend privatësia, qëndrimi i meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend nuk është i ndaluar në vetvete. Por, kjo nuk do të thotë se nuk ekzistojnë limite fetare. Ekzistojnë disa limite, të cilat duhen marrë në konsideratë dhe që duhen shmangur kur meshkujt qëndrojnë në të njëjtin vend me femrat. Këtu po përmendim disa prej tyre:

1- Zbukurimi: Zbukurimet janë nga gjërat, të cilat një femër i ka të ndaluara t'i ekspozojë përpara meshkujve të panjohur. Në një hadith të ardhur nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili e ndalon zbukurimin, thuhet: *"Ai (Allahu) e ka ndaluar që ajo (femra) të zbukurohet për burrat e tjerë, përveç bashkëshortit të saj. Nëse ajo e bën, është e drejta e Allahut që ta djegë atë në zjarr."*⁶⁵

2- Parfumimi: Parfumat janë të ngjashme me zbukurimin, me dallimin se zbukurimi shihet me shqisën e syrit, ndërsa parfumin e ndijen me anë të shqisës së nuhatjes. Për këtë, me praninë e së keqes (mefedetun), është i ndaluar parfumimi dhe qëndrimi në një vend me

⁶⁵ "Amali Saduk", f. 509.

meshkujt. Transmetohet nga Xhabir ibn Jezid se ka thënë: “Dëgjova Ebu Xhaferrin, Muhamed ibn Ali El Bakir (*Paqja qoftë mbi ta!*) të thotë: “Ajo nuk e ka të lejuar të parfumoset kur del nga shtëpia.”⁶⁶

Dalja jashtë është veç një shembull kur bëhet fjalë për të shkuar në një vend që ka meshkuj të panjohur. Pra, ndalimi nuk është ekskluzive për daljen nga shtëpia por përfshin çdo lloj qëndrimi bashkarisht, edhe sikur të jetë brenda shtëpisë.

3- Prekja dhe dhënia e dorës: Prekja dhe dhënia e dorës janë prej të këqijave (mefasid) që lidhen me ndjenjën e prekjes, kështu që është e ndaluar të prekësh lëkurën e njerëzve të panjohur. Transmetohet nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: “Ai që i jep dorën një femre, ndërkohë që është e ndaluar, në Ditën e Gjykimit do të vijë me pranga dhe do të urdhërohet ta hedhin në Zjarr.”⁶⁷ Transmetohet nga Imam Muhamed El Bakir (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Një grua nuk duhet t’i japë dorën një burri ixhnebij, vetëm kur duart janë të mbuluara me mbulesë.”⁶⁸

Ndalesa është për të dy, meshkujt dhe femrat. Mashkulli e ka të ndaluar t’i japë dorën një femre të panjohur (exhnebij), gjithashtu, edhe femra e ka të ndaluar t’i japë dorën një burri të panjohur (exhnebij)

⁶⁶ “Uesailu Shia”, vëll. 20, f. 770.

⁶⁷ “Teuthik Uesailu Shia”, vëll. 20, f. 197.

⁶⁸ “Uesailu Shia”, vëll. 20, f. 770.

4- Të folurit në mënyrë joshëse: Lidhet më së shumti më të folurit në mënyrë lozonjare. Allahu e ka ndaluar këtë në thënien e Tij në Kur'anin e Shenjtë: **“O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!”**⁶⁹

Ky ajet nga tregon për seriozitetin dhe rolin e grave të Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe tregon se ato janë më parësore se gratë e tjera për zbatimin e detyrave të Sheriatit. Prej këtyre detyrave përfshihet edhe të folurit në mënyrë lozonjare. Një grua myslimane, si pasojë duhet të flasë në mënyrë të ndershme dhe duhet t'i qëndrojë larg të folurit që josh meshkujt, veçanërisht ata që kanë sëmundje në zemër.

5- Përqëndrimi në shikim: Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për atë që bëjnë ata. Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të**

⁶⁹ Surja “Ahazab”, ajeti 32.

dukshme. Le t'i mbulojnë kraharorët me mbulesat e tyre..."⁷⁰

Duhet që besimtarët dhe besimtares të ulin shikimet. Kuptimi i fjalës "gadul basar", ulje e shikimit, është që shikimi të mos jetë me ngulitje e me përqëndrim. Transmetohet nga Profeti fisnik (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: "Allahu zemërohet kur një grua e martuar e rrit (mbush) shikimin e saj kur shikon meshkuj të tjerë, nëse nuk është bashkëshorti i saj. Nëse e bën këtë gjë, Allahu i Madhëruar do t'ja quajë të pavlera të gjitha punët që ajo bën."⁷¹

Transmetohet nga Imam Ebu Abdilah Es Sadik (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: "Shikimi është shigjetë prej shigjetave të helmuara të shejtanit. Sa e sa shikime trashëgojnë një brengë të gjatë!"⁷² Gjithashtu, transmetohet nga ai (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: "Një shikim pas një shikimi ngulit në zemër epshin. Ai është provë për shikuesin."⁷³ Nëse edhe shikimi i parë bëhet me epsh, ai është i ndaluar.

6- Shakaja dhe e qeshura e shumtë: Femra duhet të ruajë nderin e saj kur është e pranishme në një vend me meshkujt e panjohur. Ajo nuk duhet ta japë veten e saj që të duket se është mendjelehtë dhe anon lehtësisht kah e huaja. Shakatë dhe e qeshura e shumtë janë nga çështjet që tregojnë për mendjelehtësinë e një femre dhe jo seriozitet

⁷⁰ Surja "Nur", ajeti 30-31.

⁷¹ "Mizanul Hikme", vëll. 2, f. 116.

⁷² "El Kafi", pjesa e pestë, f. 559.

⁷³ "Uesailu Shia", vëll. 14, f. 144.



në një shoqëri kur meshkujt dhe femrat janë prezentë. Në një transmetim të Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Kush bën shaka me një femër që nuk është grua e tij, Allahu do ta burgosë atë njëmijë vjet për çdo fjalë.”⁷⁴

Shakaja largon pengesat psikologjike dhe hap rrugën për çdo rrëshqitje të mundshme.

Ebu Basiri ka thënë: “Po i mësoja Kur’anin një gruaje dhe bëra shaka me të për diçka. Kur shkova tek Ebu Xhaferri (Imam el Bakir) (*Paqja qoftë mbi të!*) më pyeti mua: “Çfarë i the gruas? Unë mbulova fytyrën time. Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) më tha mua: “Mos e bëj më.”⁷⁵

Këto janë disa nga standardet që duhen marrë në konsideratë kur meshkujt dhe femrat janë në të njëjtin vend.

Përmbledhja e mësimit

Qëndrimi i meshkujve dhe i femrave së bashku dhe në të njëjtin vend, në përgjithësi, është një tokë pjellorie për rënien në shumë devijime morale dhe psikologjike.

Nga këtu, qëndrimi i meshkujve dhe femrave në një vend të përbashkët ka një rrezik të veçantë, i cili e bën të nevojshme njohjen e kufijve fetarë, të cilat e parandalojnë njeriun të bjerë në kurthin e djallit dhe të ushtarëve të tij.

⁷⁴ “Uesailu Shia”, vëll. 12, f. 198.

⁷⁵ “Uesailu Shia”, vëll. 14, f. 144.

Njohja e rregullave dhe e kufijve të fesë i ofron njeriut mbrojtje dhe pacenueshmëri në mënyrë që të mbetet i nderuar dhe krenar në jetën e tij dhe të fitojë shpëtimin në Botën Tjetër.

Qëndrimi i meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend do të thotë tubim i tyre në të njëjtin vend, kudoqoftë, shtëpi, market, rrugë etj. Më pas çdo takim midis dy gjinive është konsideruar lloj prej llojeve të qëndrimit bashkarisht.

Qëndrimi së bashku i meshkujve me femrat (ikhtilati) mund të zbatohet mes një apo dy personash, por është i vështirë në të gjithë shoqërinë sepse njeriu jeton në shoqëri të përzier, meshkuj dhe femra, ku individët e shoqërisë kanë nevoja reciproke dhe është e vështirë izolimi apo shmangia e plotë midis meshkujve dhe femrave.

Sheriati i shenjtë e ndalon një lloj qëndrimi të meshkujve dhe të femrave në të njëjtin vend.

Ka dy çështje kryesore që lidhen me ndalimin e qëndrimit në privatësi:

1- Femra dhe mashkulli të jenë vetëm në një vend ku askush nuk mund të hyjë.

2- Duke mos patur siguri nga e keqja, edhe pse e keqja është e lidhur me limitet e shikimeve të ndaluara.

Ekzistojnë disa limite, të cilat duhen marrë në konsideratë dhe që duhen shmangur kur meshkujt qëndrojnë në të njëjtin vend me femrat. Këtu po përmendim disa prej tyre:

1- Zbukurimi.

2- Parfumimi.

- 3- Prekja dhe dhënia e dorës.
- 4- Të folurit në mënyrë joshëse.
- 5- Përqëndrimi në shikim.
- 6- Shkaja dhe e qeshura e shumtë.

Pyetje rreth mësimit

- 1- Cilat janë pasojat sociale të qëndrimit të meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend?
- 2- Çfarë nënkuptohet me qëndrimin e meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend?
- 3- Cila është diferenca midis qëndrimit të meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend dhe privatësisë së ndaluar?
- 4- Cilat janë dy kushtet që përmbushin privatësinë e ndaluar?
- 5- Çfarë nuk duhet të bëjë një grua në tubimet me meshkujt kur janë në një vend së bashku?

Tregim

Përpjekjet e Hatixhesë (Paqja qoftë mbi të!) për ruajtjen e Mesazhit

Në kohën kur Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i lënduar e përballë me vështërsitë, gjendej një person që ia lehtësonte dhimbjet, ia largonte mërzinë dhe hidhërimin. Ky preson ishte një grua madhështore, Hatixheja, e bija e Khuvejlid (*Paqja qoftë mbi të!*).

Prania e Hatixhesë (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte një faktor shumë i rëndësishëm në jetën Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në jetën e Islamit, i cili ishte në fillimet e tij. Nëse prania e saj nuk do të ishte e rëndësishme, nuk do të kishte qenë shumë e vështirë për Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) humbja e saj dhe vdekja e saj nuk do të kishte qenë e dhimbshme për të. Ai (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e quajti vitin kur ajo ndërroi jetë, “Viti i hidhërimit”, dhe vazhdoi ta kujtonte atë dhe mirësitë e saj për gjatë gjithë jetës.

Kur Zonja Hatixhe (*Paqja qoftë mbi të!*) u martua me të Dërguarin e Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ajo nuk kurseu asgjë, materilaisht dhe shpirtërisht, në rrugën e përhapjes së Islamit. Ajo ia dorëzoi pasurinë e saj Profetit në rrugën e triumfit të tij.

Ajo ishte që i tha djalit të xhaxhait të saj, Uaraka ibn Neufel: “Lajmëro se unë ia kam ofruar të gjithë pasurinë dhe shërbëtorët e mi Muhamedit që ai t’i shpenzojë si të dojë!” Kështu, djali i xhaxhait të saj Uaraka ibn Neufe qëndroi midis Zemzemit (Uji i bekuar në Mekë) dhe Mekamit dhe thërriti me zë të lartë: “O arabë! Hatixheja po ju fton juve që të jeni dëshmitarë se ajo po ia dhuron veten e saj, pasurinë e saj, shërbëtorët e saj dhe çdo gjë të që ajo zotëron, Muhamedit të birit të Abdullahut si shenjë nderimi dhe lavdërimit për të dhe për pozitën e tij...”

Pas kësaj Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*

dhe mbi familjen e tij!), familja e tij, të afërmit, djemtë e Hashimit në përgjithësi, u përballën me bllokadën e kurejshitëve. Këtu ishte pasuria e Hatixhesë (*Paqja qoftë mbi të!*) çelësi i qëndrueshmërisë dhe i rezistencës ndaj bllokadës. Ajo bleu ushqimet me çmim të dyfishtë, në mënyrë që njerëzit e rrethuar të ushqeheshin. E kështu tre vitet e bllokadës përfunduan me sukses dhe e shkatërroi planin që bënë kurejshitët kundës tyre. Në transmetime thuhet se Zonja Hatixhe (*Paqja qoftë mbi të!*) shpenzoi mbi 40.040 mijë dinarë.

Mësimi i gjashtë

TURPI DHE (el iffetu) PASTËRTIA

Turpi

Kur'ani fisnik ka treguar disa modele për gratë besimtare dhe punëmira duke treguar sjelljet dhe vetitë e tyre, ndër të cilat është edhe turpi. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kur arriti tek pusi i Medjenit, ndeshi rreth tij shumë njerëz që u jepnin ujë kafshëve. Përveç tyre, ai vuri re dy vasha që po mbanin kafshët e veta. Ai tha: ‘Si e keni hallin ju?’ Ato thanë: ‘Ne nuk u japim ujë, pa u larguar barinjët. Babai ynë është shumë plak.’ Kështu, Musai u dha ujë kafshëve të tyre e pastaj u kthye te një hije dhe tha: ‘Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtar!’ Më vonë, njëra nga ato dyja, erdhi me turp dhe i tha: ‘Babai im të fton për të të shpërblyer, se i dhe ujë (tufës sonë).’ Kur Musai shkoi tek ai dhe i tregoi çfarë kishte përjetuar, ai tha: ‘Mos u frikëso, sepse ke shpëtuar prej një populli të padrejtë!’”**⁷⁶

Ky ajet flet për historinë e Profetit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*) kur takoi dy vajzat e Profetit Shuajb (*Paqja qoftë mbi të!*).

⁷⁶ Surja “Kasas”, ajetet 23-25.



Ajeti paraqet qartë cilësitë e të këtyre dy punëmirave dhe turpin e tyre në dy pika:

Pika e parë: "...Ato thanë: 'Ne nuk u japim ujë, pa u larguar barinjtë...'" Ato refuzuan të hyjnë në mesin e njerëzve; preferuan të prisnin derisa vendi të boshatisej nga meshkujt. Kjo ka një lidhje të qartë me turpin dhe refuzimin e të qenurit në të njëjtin vend me meshkuj të panjohur.

Pika e dytë: "...Më vonë, njëra nga ato dyja, erdhi me turp..." Këtu flitet qartë për turpin me të cilin karakterizohej vajza e Profetit Shuajb (*Paqja qoftë mbi të!*).

Rëndësia e turpit

Transmetohet nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: "Turpi dhe besimi janë në një kategori (karnin). Nëse njëri prej tyre humbet, tjetri e ndjek atë nga pas."⁷⁷

Transmetohet nga Imam Xhafer Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: "Nuk ka besim, ai që nuk ka turp."⁷⁸

Këto transmetime na tregojnë për lidhjen e fortë të besimit me turpin. Lidhja arrin deri aty, saqë besimi nuk mund të përmbushet pa turpin. Kjo do të thotë se mungesa e turpit do të reflektohet në sjelljet e njeriut në jetën e tij, duke e çuar atë larg sjelljeve të besimtarit punëdrejtë. Jo

⁷⁷ "Uesailu Shia", vëll. 8, f. 517.

⁷⁸ "El Kafij", vëll. 2, f. 1061.

vetëm kaq, mungesa e turpit do të reflektojë edhe në Jetën Tjetër, ku mungesa e tij do të jetë humbje e madhe në atë Jetë.

Transmetohet nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: “Ai që nuk ka turp në jetën e tij, nuk do të hyjë në Xhenet.”⁷⁹

Turpi duhet të gjendet tek gjithë njerëzit në përgjithësi. Por, tek femrat kërkohet më shumë. Transmetohet nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: “Allahu e ka ndarë turpin në dhjetë pjesë, duke vendosur nëntë pjesë tek gratë dhe një tek meshkujt.”⁸⁰

Nga kush duhet të kesh turp?

1- Nga Allahu i Lartësuar: Dikush i tha Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Më këshillo mua.” Ai (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Ki turp nga Allahu ashtu siç ke turp ndaj një mashkulli punëmirë prej kombit tënd.”⁸¹

2- Nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) **dhe Imamët:** Transmetohet nga Imam Muhamed El Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Vërtet, veprat e njerëzve i paraqiten Profetit tuaj çdo të enjte në mbrëmje. Çdo kush nga ju të turpërohet që veprat e tij të këqija

⁷⁹ “Kenzul Ummal”, vëll. 3, f. 127.

⁸⁰ “Kenzul Ummal”, vëll. 3, f. 125.

⁸¹ “Biharul Anuar”, vëll. 68, f. 336.

t'i paraqiten Profetit."⁸²

Transmetohet nga Jakup ibn Shu'aib se ka thënë: E pyeta Ebu Abdilahin (*Paqja qoftë mbi të!*) për thënien e Allahut të Lartësuar: **"Thuaj: 'Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj...'"**⁸³ Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) u përgjigj: "Ata (besimtarët) janë Imamët (*Paqja qoftë mbi ta!*)"⁸⁴

3- Nga melekët: Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: *"Çdokush prej jush le të ndihet i turpëruar nga dy melekët që janë me të, ashtu sikurse turpërohet nga dy burra të drejtë prej komshinjve të tij që janë së bashku me të ditë dhe natë."*⁸⁵

4- Nga njerëzit: Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: *"Ai që nuk ka turp nga njerëzit, nuk ka turp as nga Allahu i Madhëruar."*⁸⁶

5- Nga vetja e tij: Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: *"Turpi më i mirë është ai që keni ndaj vetes."*⁸⁷

⁸² "Biharul Anuar", vëll. 33, f. 344.

⁸³ Surja "Teube", ajeti 105.

⁸⁴ "Mustadrek Sefinetil Bihar", vëll. 7, f. 165.

⁸⁵ "Kenzul Ummal", vëll. 3, f. 118.

⁸⁶ "Mizanul Hikme", vëll. 1, f. 718.

⁸⁷ "Mizanul Hikme", vëll. 1, f. 719.

Për çfarë duhet të kemi turp?

Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: “Turpi është feja.”⁸⁸

Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Turpi i mban njerëzit larg veprave të këqija.”⁸⁹

Dhe: “Turpi është çelësi i çdo të mire.”⁹⁰

Përmbajta e këtyre tre transmetimeve tregon se njerëzit duhet të ndihen të turpëruar nëse bëjnë gjynahe. Të ndjehen të turpëruar nëse braktisin detyrat dhe bëjnë gjëra të ndaluara. Ai që ka turp nga Allahu i Madhëruar nuk mund t’i bëjë gjynah Atij. Ai që ka turp nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk mund të bëjë gjynahe, sepse ai gjynah do t’i paraqitet Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në të vërtetë, turpi është feja! Ai është i lidhur me të gjithë fenë! Sa më shumë të shtohet turpi aq më shumë shtohet besimi. Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Sa më i madh të jetë turpi, aq më e madhe është edhe dëlirësia (pastërtia).”⁹¹

Megjithë atë që përmendëm, janë disa çështje që duhet t’i përmendim si sinonime me turpin.

⁸⁸ “Mizanul Hikme”, vëll. 1, f. 717.

⁸⁹ “Ujunul Hikem uel Meuaidh”, f. 327.

⁹⁰ “Ujunul Hikem uel Meuaidh”, f. 21.

⁹¹ “Ujunul Hikem uel Meuaidh”, f. 327.

1- Turpi është në mbulim

Transmetohet nga Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ka thënë: “O njerëz! Allahu do nga robtë e Tij turpin dhe mbulimin. Cilido prej jush që lahet, le të lahet larg syve të njerëzve, sepse turpi është zbukurim në Islam.”⁹²

2- Turpi në shikim

Allahu i Madhëruar thotë: “**Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre** (nga e ndaluara), **ta ruajnë nderin e tyre**”⁹³

Transmetohet nga Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ai ka thënë: “Allahu ia ka ndaluar Xhenetin çdo njeriu të pahijeshëm, të pistë dhe që nuk kujdeset për ato që ka thënë dhe që janë thënë për të.”⁹⁴

Pastërtia (el iffetu)

Kuptimi i pastërtisë

Pastërtia është një karakteristikë psikologjike te njeriu. Ajo mund të vihet re nëpërmjet ndikimeve të saj te njeriu. Këto ndikime i përmendin disa transmetime.

Transmetohet nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Durimi ndaj epshit është pastërti.”⁹⁵

Dhe: “Dëlirësia është asketizëm.”⁹⁶

⁹² “Mustedrekul Uesail”, vëll. 1, f. 488.

⁹³ Surja "Nur", ajeti 31.

⁹⁴ “Biharul Anuar”, vëll. 76, f. 112.

⁹⁵ “Mustedrekul Uesail”, vëll. 11, f. 263.

⁹⁶ “Mizanul Hikme”, vëll. 3, f. 2006.

Dhe: *"Pastërtia mbron shpirtin dhe e pasturon atë nga gjërat e ultë."*⁹⁷

Të gjitha këto duhet të jenë impakt i pastërtisë që duhet ta shfaqë atë.

Nga se pastërtia?

Çështjet që lidhen me pastërtinë janë të shumta. Disa prej tyre janë:

1- Pastërtia (el iffetu) nga nevoja materiale

Allahu i Madhëruar thotë: **"(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato."**⁹⁸

Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: *"Dëlirësia është zbukurim i varfërisë."*⁹⁹

2- Dëlirësia në forcimin e mbulimit

Allahu i Madhëruar thotë: **"Gratë e vjetra, që nuk shpresojnë më të martohen, nuk është gjynah ta heqin mbulesën e jashtme, por jo duke i treguar stolitë e tyre. E, nëse përmbahen, është edhe më mirë për ato. Allahu i**

⁹⁷ "Ujunul Hikem uel Meuaidh", f. 21.

⁹⁸ Surja "Bekare", ajeti 273.

⁹⁹ "Nehxhul Belaga", urtësia 68.

dëgjon dhe i di të gjitha.”¹⁰⁰

3- Pastërtia nga dëshirat

Allahu i Lartësuar thotë, “Ata që nuk kanë mundësi për martesë, le të përmbajnë veten, derisa Allahu t’i begatojë me dhuntinë e Tij...”¹⁰¹

Sa më shumë të shtohet bukuria e femrës, aq më e madhe duhet të jetë dëlirësia. Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Zekati i bukurisë është nderi.”¹⁰²

Frytet e dëlirësisë (pastërtisë)

Transmetimet përmendin shumë fryte dhe mirësi që përban dëlirësia. Po përmendim disa prej tyre:

Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Ai që e ruan veten e tij nga të ndaluarat, i përsosen cilësitë e mira.”¹⁰³

4- Dëlirësia ndaj të ngrënit të haramit

Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Nëse Allahu ia do të mirën një njeriu, ia ruan barkun e tij dhe organin gjenital të tij.”¹⁰⁴

Transmetohet nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Ndërsa veshja e devotshmërisë është braktisja e të

¹⁰⁰ Surja “Nur”, ajeti 60.

¹⁰¹ Surja “Nur”, ajeti 33.

¹⁰² “Mustedrekul Uesail”, vëll. 7, f. 46.

¹⁰³ “Ujunul hikem uel Meuaidh”, f. 464.

¹⁰⁴ “Mizanul Hikme”, vëll. 1, f. 842.

ndaluarave, qofshin me fjalë apo me vepra. Atij që është i dëlirë, nuk i duken pjesët e turpshme edhe sikur të jetë i zhveshur. Të shthururit i duken pjesët e turpshme edhe sikur të jetë i veshur me rroba. Allahu i Madhëruar thotë: "...por, petku i devotshmërisë është më i miri..."¹⁰⁵¹⁰⁶

Transmetohet nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: "Njeriu i dëlirë (*kade en jekune*) është si melek prej melekëve."¹⁰⁷

Ky transmetim tregon se pastërtia e dëlirësia janë shkak i lënies së gjynaheve dhe i afrimit tek Allahu i Madhëruar. Sjelljet e të pastërtit të gjitha janë bindje dhe përluje ndaj Allahut. Njeriu i pastër dhe i dëlirë duket sikur është melek prej melekëve. Këtë e tregon edhe Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: "Fruti i pastërtisë e dëlirësisë është mbrojtja."¹⁰⁸

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "I lumtur është ai që vishet me dëlirësi (*pastërti*)."¹⁰⁹

Gjërat që janë në kundërshtim me turpin dhe pastërtinë

1- Ngjashmëria me meshkujt

Më përpara përmendëm se ka disa çështje që i përputhen meshkujve dhe disa çështje që i përputhen

¹⁰⁵ Sure "A'raf", ajeti 26.

¹⁰⁶ "Biharul Anuar", vëll. 68, f. 272.

¹⁰⁷ "Nehxhul Belaga", urtësia 466.

¹⁰⁸ "Ujunul hikem uel Meuaidh", f. 208.

¹⁰⁹ "Mesuatul Ehadith Ehlil Bejt", i shejkh Fadi Nexhefij, vëll. 7, f.aqe 215.



femrave. Islami thekson që çdonjëri t'i përmbahet asaj që i përshtatet secilit prej tyre.

Mashkulli të mos kryejë atë që është në përshtatje me femrën dhe as femra të mos kryejë atë që është në përshtatje me mashkullin dhe nuk është në përshtatje me turpin dhe dëlirësinë. Kjo për faktin se diçka që është në përshtatje me njërin mund ta dëmtojë tjetrin.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e vë theksin shumë tek kjo pjesë. Ai e mallkon atë femër që largohet nga ajo që i përshtatet asaj dhe ngjason me meshkujt. Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *"Allahu e mallkoftë atë femër që ngjasohet me mashkullin dhe Allahu e mallkoftë atë burrë që ngjasohet me femrën!"*¹¹⁰

Transmetimet nga Imam El Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: *"Gruaja nuk lejohet të ngjasohet me mashkullin, sepse i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e ka mallkuar atë femër që ngjasohet me mashkullin dhe Allahu e mallkon atë burrë që ngjasohet me femrën."*¹¹¹

Ngjashmëria ka shumë forma dhe ai përfshin çdo gjë që është në kundërshtim me natyrën e femrës dhe që përshtatet me natyrën e mashkullit. Shembulli më i qartë në këtë çështje është te ngjashmëria në veshje ku femra

¹¹⁰ "El Kafij" i Sheikh El Kulejni, vëll. 5, f. 552.

¹¹¹ "Biharul Anuar", vëll. 14, f. 163.

vesh rrobat e mashkullit dhe mashkulli vesh rrobat e femrës.

2- Imitimi i Perëndimit

Sigurisht, humbja në përgjithësi dhe humbja e identitetit në veçanti, është prej sëmundjeve më të rrezikshme me të cilën mund të përballlet njeriu. Ajo është një sëmundje që shkatërron strukturën, personalitetin dhe privatësinë. Në fakt, është një shkatërrim i të gjithë vlerave të larta në shoqëri dhe shkatërrim i bazave mbi të cilat njeriu ndërton shoqërinë e tij. Shoqëria pa stadarde të caktuara dhe pa baza të pastra, është shumë e prapambetur dhe e pazhvilluar që mbijeton në supet e shoqërive të tjera.

Nuk është e natyrshme që njeriu të humbasë identitetin e tij. Po sikur ky identitet i humbur të jetë Islami?! Po nëse këto vlera janë vlera hyjnore dhe janë udhëzimi më i drejtë, pas së cilit s'ka udhëzim tjetër?! Si mund ta braktisë njeriu udhëzimin e Allahut, ndërkohë që Allahu thotë: **"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit"**¹¹² e të kapet pas zakoneve dhe shoqërive, për të cilat është konstatuar dështimi i tyre dhe kanë hyrë në qorrrokak e në mjerime për shkak të degradimit moral?!

Pikërisht, rreziku më i madh është humbja e identitetit islam dhe imitimi i të tjerëve edhe në gjënë më të parëndësishme, qoftë në formë, apo në përmbajtje. Transmetohet nga i Dërguari i Zotit (*Paqja dhe bekimet e*

¹¹² Surja "Bekare", ajeti 2.

Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ka thënë: "Ndryshoni thinjat dhe mos imitoni çifutët dhe të krishterët!"¹¹³

Gjithashtu është transmetuar nga Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ka thënë: "Prijini thonjtë dhe mos u ngjasoni me çifutët!"¹¹⁴

Dhe: "Fshijeni oborrin tuaj dhe mos ngjasoni me çifutët!"¹¹⁵

Pra, shihni se si Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e vë theksin në edukimin e shoqërisë për të mos imituar të tjerët dhe të mos ngjasohen me ata. Rreziku më i madh në këtë imitim është humbja e identitetit. E kanë pyetur prijësin e besimtarëve, Imam Ali ibn Abi Talib (Paqja qoftë mbi të!) për thënien e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): "Ndryshoni thinjat dhe mos imitoni çifutët dhe të krishterët!" Ai është përgjigjur: "...kur koha e fesë kishte ende një gamë shumë të ngushtë. Tani është koha që kjo gamë është zgjeruar, më pas çdonjëri është i lirë të zgjedhë të bëjë atë që ai do."¹¹⁶

Kjo nënkupton se problemi nuk shtrihet vetëm në ndryshimin thinjave (ngjyrës së flokëve) ose jo, por në imitimin e Jehudinëve. Nëse imitimi veprohet njëherë, largohu prej tij edhe nëse zë vend në gjëra për të cilat nuk ka imitim për veten e tyre.

¹¹³ "Uesailu shia el islamje", i Hur el Amilij, vëll. 1, f. 40.

¹¹⁴ "Mustedrekul Uesail", el Mirza el Nuri, vëll. 1, f. 414.

¹¹⁵ "Mekarimul Akhlak", i Sheikh el Tabrasi, f. 127.

¹¹⁶ "Nehxhul Belaga", fjalimi i Imam Ali ibn Ebi Talib (Paqja qoftë mbi të!), vëll. 4, f. 5.

Hirësia e tij, Imam Khamenei thotë: *“Sulmi më i madh kulturor është se ata (sulmuesit) përgjatë gjithë viteve e kanë ushqyer trurin dhe besimin se ne jemi të paaftë dhe duhet të ndjekin Perëndimin dhe Europën. Ky është pushtim kulturor. Ata nuk na lejojnë që të besojmë në aftësitë tona.”*

Në këtë pikë, ne duhet të bëjmë diferencën midis përfitimit nga dija dhe imitimi. Dija është gjahu i besimtarit dhe ai duhet ta gjurmojë kudo qoftë. Transmetohet nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: *“Dija është e humbura e besimtarit.”*¹¹⁷

Përvetësimi i dijes nuk do të thotë se është imitim. Imam Ali Khaminei thotë: *“Europianët kanë shumë veprime të gabuara dhe sjellje të shëmtuara. Pse ne duhet t'i mësojmë prej atyre këto veprime? Ne jemi myslimanë dhe të tillë duhet të mbetemi. Ata mund të kenë më shumë dije se ne, e kjo nuk është diçka e keqe. Atëherë le të shkojmë e të mësojmë dijen e tyre. Por, pse duhet të mësojmë traditat, kulturën, sjelljet dhe etikën sociale të tyre? Sa logjikë e gabuar është kjo! Pse duhet t'i imitojmë ata në veshjet e tyre, në kulturën e tyre, në sjelljet e tyre, në të folurin tyre...? Kjo është një dobësi psikike dhe ndjenje nënçmuese. Pse duhet ta ndiejmë veten të ulët?! Ne jemi krenarë për gjuhën tonë! Jemi krenarë për kulturën tonë! Jemi krenarë për vendin tonë, qytetin tonë dhe historinë tonë! Pse duhet t'i imitojmë ata?”*

¹¹⁷ “Biharul Anuar”, vëll. 1, f. 168.

Përmbledhja e mësimit

Turpi duhet të gjendet tek gjithë njerëzit në përgjithësi. Por, tek femrat kërkohet më shumë. Një besimtar duhet të ketë turp nga:

- 1- Allahu i Madhëruar .
- 2- Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*) dhe Imamët (*Paqja qoftë mbi ta!*).
- 3- Melekët që regjistrojnë veprat e mira dhe të këqija.
- 4- Njerëzit.
- 5- Vetja e tyre.

Përmbajta e këtyre tre transmetimeve tregon se njerëzit duhet të ndjehen të turpëruar nëse bëjnë gjynahe; të ndihen të turpëruar nëse braktisin detyrat dhe bëjnë gjëra të ndaluara. Ai që ka turp nga Allahu i Madhëruar, nuk mund t'i bëjë gjynah Atij. Ai që ka turp nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk mund të bëjë gjynahe, sepse ai gjynah do t'i paraqitet Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Pastërtia është një karakteristikë psikologjike te njeriu. Ajo mund të vihet re nëpërmjet ndikimeve të saj te njeriu. Këto ndikime përmenden në disa transmetime. Nga kundërshtitë e pastërtisë janë imitimi i meshkujve dhe imitimi i vendeve perëndimore.

Pyetje rreth mësimit

- 1- Nga çfarë duhet të turpërohen njerëzit?
- 2- Sa ndikon turpi në shoqëri?
- 3- Çfarë është pastërtia? Cilat janë çështjet që lidhen me të?
- 4- Cilat janë ndikimet e dëlirësisë?
- 5- Kush janë të kundërtat e pastërtisë?

Tregim

Qëndrimet e Sejide Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*)

Sigurisht, trashëgimia retorike që ka lënë Sejide Zejneb (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe qëndrimet e saj, të cilat historia i ka bërë të pavdekshme, e bëjnë këtë zonjë të madhe që të skalitet në zemrat e të gjithë njerëzve që duan të përfitojnë nga qëndrimet e vërteta dhe të moralshme. Ne do të përmendim disa nga fjalimet e saj, të cilat ajo ua ka drejtuar njerëzve të Kufes (qytet i Irakut) dhe ka lënë një ndikim mjaft të madh në zemrat e tyre.

Beshir ibn Khazijm el Esedi ka transmetuar: “Ditën që pashë Zejneb bintu Ali (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk pashë frikë. Allahu ia dërgoi asaj fjalët si të dilyn nga gjuha e prijësit të besimtarëve, Imam Ali ibn Abi Talib (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo u bëri me shenjë njerëzve që të mbanin qetësi. Mori frymë dhe

këmbanat pushuan së rëni. Më pas, ajo (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Lavdërimet i takojnë Allahut. Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi gjyshin tim Muhamedin dhe mbi familjen e tij të pastër!

O banorë të Kufes! O njerëz të mashtrimit dhe tradhtisë! A po qani?! Ju jeni si një grua që zhbën fillin pas të cilës ajo ka vrapuar për të qëndruar e fortë, duke bërë betimin një mjet përshkrimi përmes vetes suaj. Ju nuk karakterizoheni nga asnjë, por nga mburrakëti, duke u njollosur nga e keqja, neveria, lajkatimi, tradhtia e armiqëve tuaj: Ju jeni si një kafshë e ngordhur që është shtënë në varr.

E keqja është ajo që shpirti ka ofruar për ju: Zemërimi i Allahut do bie mbi ju dhe ju do të përjetoni torturat. A po qani dhe derdhni lot? Për Allahun!

Qani shumë dhe qeshni pak! Ju nuk do të jeni asnjëherë në gjendje të lani çnderimi dhe turpin që keni bërë. Si mund t'i lani vrasjet e pasardhësve të profetësisë, burimit të mesazhit, udhëzuesit të të rinjve të Xhenetit, strehimi i hutimit tuaj, ngushëlluesve të krizës tuaj, dritën e dëshirave tuaja, kreut të normave tuaja fetare?!

Me të vërtetë! E keqja është barra që ju po mbani! Largojeni nga ju! Fatkeqsi për ju! Përpjekjet e juaja janë të pashpresa. Duart ju kanë rënë poshtë. Marrëveshjet kanë humbur. Ju jeni pikëlluar nga zemërimi i Allahut. Dhe jeni plagosur nga turpi dhe çnderimi!

O njerëz të Kufas! A jeni të informuar se cilin nga djemtë e Profetit të Allahut keni vrarë? Cilën vajzë të tij zbuluat? Cilin gjak derdhët? Cilën gjë të shenjtë të tij dhunuat? Veprimet e juaja ishin me dinakëri, poshtërues, të llahtarshëm, të dhunshme,

aq sa të fëlliqura aq të bujshme sa e gjithë toka dhe qielli.

Pyes: po sikur qielli të qante gjak?! Dhe se torturat në të ardhmen do të bëhen më të mëdha, dhe ju nuk do të ndihmoheni. Mos jini të qetë sepse juve do t'iu jepet një vonesë! Nxitimi nuk do ta largojë atë Allahun e Lartësuar. Dhe nuk ka frikë se hakmarrja do të bjerë në sy. Allahu juaj po pret për ju."

Mësimi shtatë

MARTESA

(pjesa e parë)

Rëndësia e krijimit të familjes

Transmetohet nga Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *“Nuk është ndërtuar në Islam ndërtesë më e pëlqyeshme për Allahun e Lartësuar sesa martesa.”*¹¹⁸

Ka shumë transmetime të cilat nxisin për martesë, me anë të së cilës formohet familja që jeton brenda një kornize ligjore dhe sociale, që garanton përkujdesjen, sigurinë dhe përsosurinë e familjes.

Familja është një shoqëri e vogël. Islami i kushton rëndësi asaj dhe nxit krijimin e famijes. Para se të flasë për detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të familjes, Islami i udhëzon ata që marrëdhëniet mes tyre të bazohen te sjellja e mirë.

- Cilat janë qëllimet e kësaj ndërtese?
- Çfarë atmosfere duhet ta mbulojë këtë ndërtesë?
- Kush janë të drejtat dhe detyra?

¹¹⁸ “Men la jehdharuhul Fakih”, vëll. 3, f. 383.

Prej qëllimeve të familjes

Ka shumë tekste islame që flasin për qëllimet e ndërtimit të familjes. Prej tyre përmendim:

1- Pastërtia dhe dëlirësia

Martesa është përgjigje ndaj instiktit të natyrshëm, të cilin Allahu i Lartësuar e ka vendosur te njeriu. Përmes martesës bëhet shtimi dhe ruajtja e gjenezës si dhe ngopet epshi seksual. Me anë të martesës, njeriu mbrohet nga rrëshqitja në mëkate e gjynahe. Martesa, mbi të gjitha ruan pastërtinë dhe nderin. Transmetohet nga Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: “Kushdo që dëshiron ta takojë Allahun të pastër e të pastruar, le të martohet”¹¹⁹

Kjo ftesë, në fillim, u drejtohet të rinjve e të rejave, sepse njeriu është i dobët përballë kërkesës së epshit dhe këmbënguljes së tij nëse nuk e përmbush këtë kërkesë në mënyrë legjitime, të saktë e të drejtë fetarisht.

Transmetohet nga Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: “Cilido i ri që martohet në moshë të re, e ka mposhtur djallin e tij, i cili bërtet e thotë: ‘Sa keq! Sa keq!’. Ai i ka mbrojtur dy të tretat e fesë së tij prej meje. Duhet që njerëzit të jenë të devotshëm në lidhje me të tretën e mbetur.”¹²⁰

¹¹⁹ “Mizanul Hikme”, vëll. 2, f. 1178.

¹²⁰ “Biharul Anuar”, vëll. 100, f. 221.

2- Fortifikimi i moralit

Braktisja e martesës shkakton shumë probleme psikologjike në brendi të njerëzve, të cilat, si rezultat prodhojnë shumë probleme komplekse dhe probleme të tjera shpirtërore e psikike që shfaqen në formën e veseve.

Nga këtu, martesë është shkatërruesë e çrregullimeve të tilla dhe shkaktare e moraleve të mira.

Transmetohet nga Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *"Martojini shërbëtorët tuaj, sepse Allahu do t'ja përmirësojë atyre moralin, do t'ja shtojë furnizimin dhe do t'ja ngrejë atyre personalitetin."*¹²¹

Kjo shkakton qetësi shpirtërore, për të cilën flet edhe Kur'ani i Shenjtë, ku thotë: **"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë."**¹²²

¹²¹ "Mizanul Hikme", vëll. 2, f. 1179.

¹²² Surja "Rum", ajeti 21.

3- Plotësimi midis bashkëshortes dhe bashkëshortit dhe përmbushja e nevojave të njëri-tjetrit

Sigurisht, në personalitetin e mashkullit dhe të femrës ka boshllëqe. Kështu që gjithsecili prej tyre ka nevojë për tjetrin në mbushjen e atyre boshllëqeve. Këtë e tregon edhe Kur'ani i Shenjtë: **“Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato. Allahu e di mirë se ju e keni mashtruar veten (duke shkuar me gratë para se të zbriste lejimi), por Allahu e ka pranuar pendimin tuaj dhe jua ka falur gabimin.”**¹²³

4- Mbushja e kohës me përulje ndaj Allahut

Martesa është përgjegjësi e drejtpërdrejtë për sigurimin e nevojave të familjes pas ndërtimit të saj dhe për mbrojtjen e familjes. Për këtë ka misione dhe veprime të përditshme. Kjo bën që njeriu të ketë një plan-program të përditshëm që e ruan familjen dhe shoqërinë nga shkatërrimet dhe degradimet.

5- Shtimi i gjenezës besimtare dhe vazhdimësia e jetës

Transmetohet nga Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *“Çfarë i pengon besimtarët të martohen? Mbase sepse Allahu do t'u dhurojë një fëmijë që ta mbushë tokën me 'Nuk ka zot tjetër përveç Allahut.'”*¹²⁴

Bazuar në këto qëllime, gjejmë tekste fetare që i

¹²³ Surja “Bekare”, ajeti 187.

¹²⁴ “Uesailu shia”, vëll. 12, f. 14.

udhëzojnë bashkëshortët dhe bashkëshortet që të krijojnë një atmosferë sa më të këndshme në familje, e cila të ndihmojë në arritjen e këtyre qëllimeve. Çfarë është ajo atmosferë që duhet të sigurohet në familje me qëllim që të realizohen qëllimet hyjnore?

Atmosfera në marrëdhëniet familjare

Gruaja duhet ta dijë se marrëdhënia me bashkëshortin e saj ka prioritet fetar. Ajo marrëdhënie qëndron mbi të gjitha gjërat, për aq kohë sa është brenda standardeve fetare. Aq e rëndësishme që është kjo marrëdhënie, derisa ka arritur që ajo të jetë pikënisje për xhihadin e gruas. Në një transmetim të Profetit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Xhihadi i gruas është bashkëshortësia e mirë.”¹²⁵ Që do të thotë se ajo duhet të ketë marrëdhënie të mira me bashkëshortin saj. Për këto marrëdhënie, Sheriati përmend shumë detaje. Prej tyre janë:

1- Dashuria

Allahu i Madhëruar thotë: “...duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë...”¹²⁶ Dashuria është një prirje shpirtërore, e cila përbën bazën e mirëkuptimit dhe të harmonisë së përbashkët.

2- Mëshira

Kjo është një tjetër çështje e përmendur në ajetin e

¹²⁵ “*Biharul Anuar*”, vëll.imi 100, f. 245.

¹²⁶ Surja "Rum", ajeti 21

lartpërmendur. Pas dashurisë vjen roli i mëshirës, e cila nënkupton butësinë dhe dhembshurinë. Allahu i Madhëruar nuk është mjaftuar vetëm me mëshirën, por vendosi edhe butësinë dhe dhembshurinë në marrëdhëniet midis bashkëshortit dhe bashkëshortes që shfaqen në veprat e secilit prej tyre.

Në një hadith thuhet: *“Cilado grua që i jep bashkëshortit të saj qoftë edhe një gllënjë ujë, kjo do të jetë më e mirë për të, sesa një adhurim në gjithë vitin në të cilin ajo agjëron gjithë ditën dhe qëndron zgjuar gjithë natën (duke u lutur dhe falur).”*¹²⁷

3- Jeta e mirë

Nëse dashuria dhe mëshira mbizotërojnë në zemrat e bashkëshortit dhe të bashkëshortes, ndikimet e tyre do të shfaqen në jetën e përditshme dhe shoqërimin midis tyre në formën e **“...Jetoni e silluni mirë me to!”**¹²⁸ Ai që dashuron dhe mëshiron, kurrë nuk bën keq. **“...dhe mos u bini në qafë për t’i detyruar (të largohen)...”**¹²⁹

Ky shoqërim përbëhet nga lloje të ndryshme sjelljeje, të cilat tregohen me anën e rrëfimeve. Transmetohet nga Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *“Gruaja më e mirë mes jush është ajo që vjen lehtë, butë dhe e bindur. Ajo e cila nuk i mbyll sytë kur burri është i mërziur prej saj, derisa ai të jetë i kënaqur ndaj saj. Është ajo që e ruan bashkëshortin e saj kur ai nuk është i*

¹²⁷ “Uesailu shia”, vëll. 20, f. 177.

¹²⁸ Surja “Nisa”, ajeti 19.

¹²⁹ Surja “Talak”, ajeti 6.

pranishëm (duke ruajtur nderin dhe pasurinë e tij). Kjo është nga punëtoret e Allahut, dhe punonëtoret e Allahut nuk gabojnë.¹³⁰

Gjithashtu, transmetohet nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Një burrë shkoi tek Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i tha atij: “Unë kam një bashkëshorte që më uron mirëseardhjen kur hy në shtëpi, më shoqëron kur dal nga shtëpia, më pyet sa herë jam i shqetësuar: ‘Çfarë problemi ke?’ Nëse je i merakosur për furnizimin tënd, atëherë ai është nën sipërmarrjen e dikujt tjetër. Dhe nëse je i shqetësuar për Ahiretin tënd, atëherë le ta forcojë Allahu shqetësimin tënd. Profeti Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i tha burrit: “Paralajmëroje atë me Xhenet dhe thuaji asaj: ‘Ti je një prej punëtoreve të Allahut, për çdo ditë ti ke shpërblimin e shtatëdhjetë dëshmorëve.’¹³¹

4- Bashkëpunimi dhe mbushja e boshllëkut

Allahu i Madhëruar thotë: “...Ato janë petk për ju e ju jeni petk për ato...”¹³² Ky ajet tregon tre kuptime:

Së pari: Secili prej tyre është zbukurim për tjetrin, sepse petku është një zbukurim për atë që e vesh.

Së dyti: Ata mbrojnë njëri-tjetrin. Petku e mbron njeriun nga i ftohti në dimër dhe largon nxehtësinë e diellit në verë.

¹³⁰ “El Kafi”, vëllimi 5, f. 325.

¹³¹ “Mekarimul Akhlak”, i Et Tabrasij, f. 200.

¹³² Surja "Bekare", ajeti 187.

Së treti: Secili prej të dyve mbulojnë njëri-tjetrin. Petku mbulon trupin dhe pjesët e turpshme të tij. Detyra e gruas është që kur të shohë ndonjë të metë apo problem të bashkëshortit i saj, duhet ta mbulojë atë, ta ndihmojë për mbushjen e këtij boshllëku dhe ta zbukurojë atë në sytë e të tjerëve.

5- Qetësia dhe butësia

Durimi i pakët dhe zemërngushtësia mund t'i shkatërrojnë themelet e një familjeje deri në rrënjë. Grindjet e përditshme mes gruas dhe burrit mund të sjellin pasoja në të ardhmen, që do të jetë e vështirë të rregullohen.

Në këtë pikë shfaqet porosia e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për durim: *“Cilado grua që duron sjelljen e keqe të bashkëshortit të saj, Allahu do ta shpërblejë atë me shpërblimin e Asijes, së bijës së Muzahimit.”*¹³³

Gjithashtu transmetohet nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: *“Allahu i Lavdishëm dhe i Madhëruar e ka caktuar xhihadin si për meshkujt, ashtu edhe për femrat. Xhihadi i mashkullit është dhënia e pasurisë së tij dhe e gjakut të tij derisa të vritet për hir të Allahut. Xhihadi i gruas është që të durojë ndaj sjelljeve të këqija të bashkëshortit të saj dhe ndaj xhelozisë së tij.”*¹³⁴

¹³³ “Mekarimul Akhlak”, f. 214.

¹³⁴ “El Kafi”, vëll. 5, f. 9.

6- Marrja në konsideratë e mundësive të bashkëshortit

Le të mësojmë nga Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*), zonja e grave të të gjithë botëve kur i tha burrit të saj, Prijësit të besimatëreve (*Paqja qoftë mbi të!*): “O babai i Hasanit! Unë i turpërohem Allahut tim që të të ngarkoj për ato që nuk ke mundësi.”¹³⁵

Kjo është atmosfera e shëndetshme për të cilën na udhëzon Sheriati i shenjtë. Islami nuk është mjaftuar me vendosjen e kësaj mënyre të sjelljes, madje ka bërë ndarjen e punëve të shtëpisë. Çdokujt i ka caktuar rolin që i takon dhe që i përshtatet me natyrën e tyre. Ky rol përfaqëson sistemin drejtues në familje.

Sistemi i familjes

Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ndau punën midis Imam Aliut dhe zonjës Fatime (*Paqja qoftë mbi ta!*). Punët brenda shtëpisë ishin nën përgjegjësinë e zonjës Fatime (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe ato jashtë shtëpisë ishin nën përgjegjësinë e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajo (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Vetëm Allahu e di sa e lumtur jam që isha aty kur Profeti i Allahut më ngarkoi që të mbart ato që mbartin meshkujt në qafat e tyre.”¹³⁶

Zonja Fatime Zahraja (*Paqja qoftë mbi të!*) mbajti barrën e

¹³⁵ “Biharul Anuar”, vëll. 37, f. 103.

¹³⁶ “Biharul Anuar”, vëll. 43, f. 81.

punëve brenda shtëpisë. Ajo ka thënë: *“O Profet i Allahut! Duart e mia flluskojnë nga mulliri. Një herë bluaj, e herë tjetër bëj brum.”*¹³⁷

Familja e Imam Aliut dhe e zonjës Fatime (*Paqja qoftë mbi ta!*) është model në sistemin e famijes për besimtarët në përgjithësi. Këtu kemi disa transmetime që tregojnë për punën e gruas brenda në shtëpi. Profeti i ndritur (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Cilado grua që lëviz diçka nga shtëpia e bashkëshortit të saj dhe e vendos në një vend tjetër dhe me këtë ka qëllim rregullimin, atë e shikon Allahu dhe atë që e shikon Allahu, nuk e dënon.”*¹³⁸

Siç e përmendëm, familja është një shoqëri e vogël e bazuar në dashuri dhe mëshirë e mbështjellë nga qetësia dhe Paqja. Gjithsesi, kjo nuk e mohon nevojën e prezencës së një autoriteti, që është kreu i familjes. Burri është zgjedhur nga Allahu i Lartësuar për ta drejtuar këtë shoqëri të vogël (familjen).

Allahu i Madhëruar thotë: **“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.”**¹³⁹

Këtë, gjithashtu, e përforcojnë edhe transmetimet. Transmetohet nga Profeti i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *“Një burrë nuk ka fituar pas Islamit, diçka më të mirë se sa një*

¹³⁷ “Dhekhairul Ukba”, f. 50.

¹³⁸ ‘Uesailu shia’, vëll. 21, f. 451.

¹³⁹ Surja “Nisa”, ajeti 34.

bashkëshorte myslimane që e kënaq atë kur ai e shikon, i bindet atij kur ai e urdhëron, e kur nuk është i pranishëm ajo ia mbron atij nderin e tij dhe pasurinë e tij."¹⁴⁰

Transmetohet nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: *"Gruaja nuk ka ndërmjetësues më të mirë te Zoti, sesa kënaqësia e burrit të saj."*¹⁴¹

Kështu pra, familja e dy të pamëkatshmëve, Imam Aliut dhe Fatime Zahrasë (*Paqja qoftë mbi ta!*) është modeli më i mirë.

Përmbledhja e mësimit

Familja është një shoqëri e vogël. Islami i kushton rëndësi asaj dhe nxit krijimin e famijes. Para se të flasë për detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të familjes, Islami i udhëzon ata që marrëdhëniet mes tyre të bazohen te sjellja e mirë.

Ka shumë tekste islame që flasin për qëllimet e ndërtimit të familjes. Prej tyre përmendim:

- 1- Pastërtia dhe dëlirësia
- 2- Fortifikimi i moralit
- 3- Plotësimi midis bashkëshortes dhe bashkëshortit dhe përmbushja e nevojave të njëri-tjetrit
- 4- Mbushja e kohës me përulje ndaj Allahut
- 5- Shtimi i gjenezës besimtare dhe vazhdimësia e jetës

¹⁴⁰ "El Kafi", vëll. 5, f. 327.

¹⁴¹ "Usailu shia", vëll. 12, f. 222.

Gruaja duhet ta dijë se marrëdhënia me bashkëshortin e saj ka prioritet fetar. Ajo marrëdhënie qëndron mbi të gjitha gjërat për aq kohë sa është brenda standardeve fetare. Aq e rëndësishme që është kjo marrëdhënie, derisa ka arritur që ajo të jetë pikënisje për xhihadin e gruas. Në një transmetim të Profetit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Xhihadi i gruas është bashkëshortësia e mirë.”¹⁴² Që do të thotë se ajo duhet të ketë marrëdhënie të mira me bashkëshortin saj. Për këto marrëdhënie, Sheriati përmend shumë detaje. Prej tyre janë:

- 1- Dashuria
- 2- Mëshira
- 3- Jetesia e mirë
- 4- Bashkëpunimi dhe mbushja e boshllëkut
- 5- Qetësia dhe butësia
- 6- Marrja në konsideratë e mundësive të bashkëshortit

Familja e Imam Aliut dhe e zonjës Fatime (*Paqja qoftë mbi ta!*) është model në sistemin e famijes për besimtarët në përgjithësi.

Siç e përmendëm, familja është një shoqëri e vogël e bazuar në dashuri dhe mëshirë e mbështjellë nga qetësia dhe Paqja. Gjithsesi, kjo nuk e mohon nevojën e prezencës së një autoriteti, që është kreu i familjes. Burri është zgjedhur nga Allahu i Lartësuar për të drejtuar këtë

¹⁴² “*Biharul Anuar*”, vëll. 100, f. 245.

shoqëri të vogël (familjen).

Allahu i Madhëruar thotë: **“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi to dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.”**¹⁴³

Pyetje rreth mësimit

- 1- Sa rëndësi i jep Islami martesës?
- 2- Cili është qëllimi i martesës dhe i krijimit të familjes?
- 3- A është përmbushja e nevojave të shoqërisë më primare se plotësimi i nevojave të bashkëshortes?
- 4- Përmend disa çështje të cilat gruaja duhet t’i ruajë në shtëpinë e bashkëshortit të saj.
- 5- Si i ndau Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) punët midis Imam Aliut dhe zonjës Fatime Zahra (*Paqja qoftë mbi ta!*)?

¹⁴³ Surja “Nisa”, ajeti 34.

Tregim

Zonja Fatime Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*), bashkëshorte

Jeta e zonjës Fatime Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) në shtëpinë e bashkëshortit të saj, Prijësit të besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) është një nga çështjet më të mrekullueshme dhe është modeli më i lartë që çdo grua duhet ta ndjekë. Shumë transmetime flasin për jetën e Zahrasë (*Paqja qoftë mbi të!*) në shtëpinë e bashkëshortit të saj. Prej atyre që tregohen në transmetime është se një ditë, Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) hyri në shtëpinë e vajzës të tij në kohën që ajo po bluante me mokër dhe mbi kokë kishte vendosur një mbulesë deveje. Ai (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qau dhe tha: “O Fatime, gëlltite hidhësinë e kësaj jete për mirësinë e Jetës Tjetër.”¹⁴⁴

Përsa i përket moralit të saj të përkryer, Prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “...Ajo kurrë nuk më ka zemëruar, as nuk më ka kundërshtuar. Shqetësimet dhe dhimbjet e mia zhdukeshin kur e shihja atë.”¹⁴⁵

Zahraja (*Paqja qoftë bi të!*) ishte bashkëshorte e begatë dhe e bindur me atë që i kishte caktuar Allahu. Ajo nuk i kërkonte asgjë Prijësit të besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*). Historia na përcjell se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), kur u zgjua një ditë, e pyeti Fatimenë: “O Fatime! A ke ndonjë gjë

¹⁴⁴ “Ed Durrul Menthur”, vëll. 6, f. 361.

¹⁴⁵ “Biharul Anuar”, vëll. 43, f. 130.

për të më dhënë për të ngrënë?" Ajo u përgjigj, "Jo. Betohem në atë që nderoi babanë tim me Profetësi! Nuk kam asgjë që të të ushqej. Që prej dy ditësh, nuk kemi patur ushqim. As unë e as dy djemtë e mi nuk kanë futur asgjë në bark." Ai (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "O Fatime! Pse nuk më ke thënë që t'ju siguroja diçka?" Ajo (Paqja qoftë mbi të!) iu përgjigj. "Më vjen turp nga Allahu që të të ngarkoj me diçka që nuk keni mundësi ta sillni."¹⁴⁶

Kur Fid'datu i shërbente Fatime Zahrasë, ajo (Fatimeja) nuk e shfrytëzonte atë për t'u çlodhur vetë. Përkundrazi, ajo punonte një ditë dhe Fid'datu ditën tjetër. Një transmetim thotë se Selman El Muhamedij, një ditë, e pa Fatimenë (Paqja qoftë mbi të!), e cila ishte ulur dhe po bluante elb. Ai vuri re se në shkopin e mokrës kishte gjak dhe Husejni (Paqja qoftë mbi të!) ishte në cep të shtëpisë i uritur. Ai i tha asaj: "O vajza e Profetit! Duart e tua kanë flluska. Ja ku është Fid'datu (shërbëtorja e saj)." Ajo (Paqja qoftë mbi të!) i tha atij: "Profeti i Allahut më ka porositur që t'i ndaj punët midis meje dhe asaj dhe dje ishte rradha e saj."¹⁴⁷

Kjo është zonja Fatime Zahra (Paqja qoftë mbi të!) në shtëpinë modeste të burrit të saj. Ajo e lartësoi veten e saj derisa Allahu e bëri model për të gjitha gratë e botës dhe zonjë të tyre.

¹⁴⁶ "Ihkakul Hak" i Et Testerij, vëll. 25, f. 352.

¹⁴⁷ "Biharul Anuar", vëll. 43, f. 78.

Mësimi tetë

MARTESA (pjesa e dytë) Vazhdimësia e familjes

Transmetohet nga Imam Xhaferr Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Allahu i Madhëruar dhe i Lartësuar e pëlqen atë shtëpi ku ka martesë dhe e urren atë shtëpi ku ka divorc. Nuk ka gjë më të zemëruar se sa divorci.”¹⁴⁸

Divorci është shkatërrimtar për një ndërtesë, të cilën Allahu i Lartësuar e pëlqen dhe i nxit njerëzit drejt saj, e ajo është martesa. Edhe pse martesa është e pëlqyeshme te Allahu i Lartësuar, edhe pse është një nga shkaqet e plotësimit të fesë dhe një mburojë kundër gjynaheve, Allahu i Madhëruar nuk i detyron njerëzit për t’u martuar. Kjo sepse detyrimi mund të sjellë shumë pasoja negative, që e bëjnë njeriun të hezitojë shumë përpara se të hyjë në kafazin e martesës, pasi nuk do të jetë në gjendje të dalë prej tij.

Ndoshta këto çështje e të tjera të ngjashme me to, tregojnë se divorci nuk është i ndaluar fetarisht dhe porta e tij është e hapur. Mirëpo, në të njëjtën kohë, Allahu i

¹⁴⁸ “El Kafi’, vëll. 6, f. 54.

Madhëruar i udhëzon njerëzit që të largohen nga divorci.

Transmetohet nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Xhibraili (*Paqja qoftë mbi të!*) më ka porositur mua aq shumë për gruan, sa që mendova se kurrë nuk duhet divorcuar vetëm në rastin kur bën një punë të shëmtuar të dukshme.”¹⁴⁹

Allahu i Madhëruar e përforcon faktin se divorci është diçka e urryer deri në atë masë, sa që e ka bërë prej çështjeve të lejuara më të zemëruara të Tij. Në një transmetim të ardhur nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), gjithashtu, edhe në shumë transmetime të cilat nuk flasin vetëm për qenien e divorcit të urryer, por e tejkalon këtë duke deklaruar edhe urrejtjen e atij që zgjedh atë.

Transmetohet nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Asgjë midis këtyre çështjeve, të cilat Zoti i ka lejuar është më e urryer tek Ai sesa divorci. Allahu e urren personin që divorcon shumë.”¹⁵⁰

Alternativa e zgjedhjes së divorcit, edhe pse fetarisht nuk është i ndaluar, ai nuk duhet marrë me seriozitet dhe duhet larguar prej tij sa më shumë të jetë e mundur. Madje, nuk duhet sjellë në mendje diçka e tillë, me qëllim që divorci të mos bëhet rrugëzgjdhja më e lehtë për t’u larguar nga çdo problem me të cilin mund të përballen bashkëshortët.

¹⁴⁹ “Men la jedheruhul Fakijh”, vëll. 3, pj. e tretë, f. 440.

¹⁵⁰ “El Kafi”, vëll. 6, f. 54.

Prej shkaqeve të divorcit

1- Moszbatimi i Sheriatit të shenjtë

Allahu i Madhëruar i ka vendosur ligjet në mënyrë që të rregullojë lidhjen martesore, ta bëjë atë në formën më të mirë që të sigurojë një jetë bashkëshortore të lumtur e të sukseshme. Kur njeriu i tejkalon kufijtë e fesë dhe i shkel ato, jeta bashkëshortore kanoset me shkatërrim.

Nga këtu është e nevojshme që gruaja të njihet me të drejtat e saj martesore dhe me etikën e një lidhjeje me bashkëshortin e saj, në mënyrë që të kryejë një stad të pacenueshëm, që e mbron ndërtesën e familjes nga shkatërrimi. Të gjitha këto shkaqe do t'i ilustrojmë me shembuj në mënyrë që të parandalojmë divorcin.

2- Gabimet

Vlerësimi i gabuar që buron nga mosnjohja e partnerit, e karakteristikave të tij, çfarë ai pëlqen dhe çfarë urren. Paaftësia për t'u harmonizuar, pavarësisht njohjes së prirjeve dhe karakteristikave të partnerit, mund të shkaktojë tension dhe rënie në gabime gjë që përbën rrezik për jetën bashkëshortore. Por, nëse njihet mirë partneri, mund të ndihmojë të kuptohen sjelljet dhe arrihet harmonia.

Cila është rrugëzgjdhja?

1- Kujdesja për të drejtat dhe rregullat e mirësjelljes

Gjenden të drejta dhe rregulla mirësjelljeje që duhen marrë në konsideratë dhe të zbatohen. Braktisja e këtyre të drejtave dhe moszbatimi i këtyre rregullave do ta lëre plotësisht hapur derën përpara keqkuptimeve dhe do ta vendosin familjes përballë rrezikut. Por, cilat janë këto të drejta dhe rregulla të mirësjelljes?

Të drejtat dhe etika në marrëdhënien me bashkëshortin

Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: “E drejta më e madhe e gruas, midis gjithë njerëzve, është bashkëshorti...”¹⁵¹

Dhe: “Gruaja nuk e kryen të drejtën e Allahut të Madhëruar derisa të kryejë të drejtën e burrit të saj.”¹⁵²

Dhe: “Xhihadi i gruas për hir të Allahut është e mirësjellja me bashkëshortin e saj.”¹⁵³

Të drejtat përmbledhen si vijon:

E para: Përmbushja e nevojave të bashkëshortit

Gruaja duhet të përmbushë nevojat e bashkëshortit të saj në lidhje me disa çështje private në marrëdhënien midis tyre. Nëse refuzon, Allahu zemërohet me të deri në

¹⁵¹ “Mizanu Hikme”, vëll. 2, f. 184.

¹⁵² “Mustedrekul Uesail”, vëllimi 14, f. 257.

¹⁵³ “El Kafi”, vëll. 5, f. 9.

momentin që të kënaqë bashkëshortin e saj. Transmetohet se një grua e pyeti Profetin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të drejtën e burrit tek gruaja. Ai (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu përgjigj asaj: “Ti përgjigjet atij për nevojën e vet edhe sikur të jetë në prag të lindjes....”¹⁵⁴

E dyta: Zbukurimi dhe dashuria për bashkëshortin

Qëllimi me zbukurimin është që gruaja të braktisë ato që e neverisin atë dhe t’i shfaqë atij hijeshi dhe bukuri. Në librin *Tahrirul Uasile*, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë se mosbindja e gruas është moslargimi i të neveritshmeve që janë në kundërshtim me kënaqësinë, madje edhe mospastrimi e moszbukurimi.¹⁵⁵

E treta: Mbrojtja e pasurisë së bashkëshortit

Gruaja duhet të ndjejë përgjegjësi për pasurinë e burrit të saj. Për shembull: Gruaja nuk duhet t’i harxhojë paratë në mënyrë të papërgjegjshme dhe pa lejen e bashkëshortit. Ka shumë transmetime që tregojnë për këtë çështje.

Transmetohet nga Imam Sadiku (*Paqja e Allahut qoftë mbi të*) se ka thënë: “...Nuk duhet të japë asgjë pa lejen e tij. Nëse vepron, ajo do të ndëshkohet ndërsa ai do të shpërblehet.”¹⁵⁶

¹⁵⁴ “*El Kafi*”, vëll. 5, f. 508.

¹⁵⁵ “*Tahrirul Ueasile*”, vëll. 2, f. 305.

¹⁵⁶ “*Uesailu shia*”, vëll. 20, f. 312.

E katërta: Moszemërimi dhe moslëndimi i bashkëshortit Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: “Mjerë ajo grua që e zemëron burrin e saj. E lumtur është ajo grua, kur bashkëshorti i saj është i kënaqur me të.”¹⁵⁷

Dhe: “Ai që ka një grua që i bën keq atij, Allahu nuk do t’ia pranojë asaj namazin dhe asgjë nga veprat e saj të mira, edhe nëse ajo agjëron gjatë gjithë jetës saj, deri sa ta kënaqë atë.”¹⁵⁸

Dhe: “Gruaja më e mirë midis grave të ymetit tim, është ajo grua që, kur vëren se burri i saj është i nevrikosur, ia kushton veten e vet për kërkesat e tij dhe i thotë: “Sytë e mi nuk do të flenë, deri sa të jesh i kënaqur me mua.”¹⁵⁹

E pesta: Dalja nga shtëpia e bashkëshortes veçse me lejen e tij

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk ka asnjë shpenzim për atë grua që del nga shtëpia e bashkëshortit të saj pa lejen e burrit, derisa ajo të kthehet sërish në shtëpi.”¹⁶⁰

Imam Khomeini (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) thotë se prej mosbindjes së bashkëshortes ndaj bashkëshortit të vet është dalja e saj nga shtëpia pa lejen e bashkëshortit të saj.”¹⁶¹

¹⁵⁷ “Biharul Anuar”, vëll. 73, f. 363.

¹⁵⁸ “Biharul Anuar”, vëll. 73, f. 103.

¹⁵⁹ “El Kafi”, vëll. 5, f. 514.

¹⁶⁰ “Tarirul Uesile”, vëll. 2, f. 305.

¹⁶¹ “Tarirul Uesile”, vëll. 2, f. 305.

2- Zgjidhja pas problemit

Nëse midis gruas dhe burrit fillojnë problemet, fillimisht ata duhet ta zgjidhin problemin brenda shtëpisë së tyre pa dalë jashtë saj. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse gruaja druan nga burri i saj se do të sillet keq ose nuk do ta përfillë, atëherë nuk ka gjynah për ata, nëse pajtohen ndërmjet tyre. Pajtimi është më i mirë. Njerëzit janë të pirur nga koprracia. Por në qoftë se ju silleni mirë dhe ruheni prej të këqijave, Allahu e di mirë çfarë veproni.”**

162

Nëse burri dhe gruaja nuk janë në gjendje që të zgjidhin problemet e tyre dhe të arrijnë në një mirëkuptim të ndërsjelltë dhe të vazhdojnë jetën e tyre martesore në mënyrën e duhur, këtu vjen roli i faktorëve të jashtëm e të pëlqyeshmë që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të pazgjidhura. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse i druheni ndarjes midis burrit e gruas, atëherë caktoni një ndërmjetës nga ana e burrit dhe një nga ana e gruas. Në qoftë se ata dëshirojnë paqësim, Allahu sjell marrëveshje midis tyre. Allahu, me të vërtetë, është i Gjithëditur dhe i di të gjitha qëllimet.”**¹⁶³

Ky ajet nuk specifikon një person të caktuar siç është babai, xhaxhai, apo çdo njeri tjetër. Ndoshta qëllimi është që të mbajë hapur portën përballë zgjidhjes më të urtë dhe më të aftë që të njihet natyra e problemit dhe të vendoset

¹⁶² Surja "Nisa", ajeti 128.

¹⁶³ Surja "Nisa", ajeti 35.

një zgjidhje për të.

Allahu i Madhëruar dëshiron që familja të jetë një faktor pozitiv që të ndihmojë në ndreqjen e jetës bashkëshortore dhe jo një faktor negativ që mund të shtojë më shumë komplikimin e problemit. Imam Khomeini (*Allahu qoftë i kënaqur me të*), në lidhje me këtë, ka thënë: “Kur mosmarrëveshjet midis burrit dhe gruas arrijnë deri në atë pikë që mund t’i çojë drejt grindjeve dhe ndarjeve e deri te gjykatësi, duhet të dërgojnë përfaqësues nga ana e tij dhe përfaqësues nga ana e saj në mënyrë që të largojnë mosmarrëveshjet, ose të shohin atë më të përshtatshmen, qoftë në bashkim ose ndarje. Dy përfaqësuesit duhet të analizojnë situatën dhe shkaqet e mosmarrëveshjeve midis burrit dhe gruas dhe duhet të përpiqen t’i pajtojnë ata...”¹⁶⁴

Divorci në dorë të burrit

Të qenit e divorcit në dorë (kopetencë, e drejtë) të burrit, nuk i jep atij të drejtë ta shtypë e ta sundojë gruan e tij dhe të abuzojë me të. Kjo e drejtë është një amanet në qafën e tij, për të cilin ai do të japë llogari para Allahut në Ditën e Gjykimit.

Transmetohet nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Profeti u informua se Ebu Ejjubi dëshironte të ndahej nga e shoqja. Profeti i Allahu (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Divorcimi i Ummu Ejjubit është gjynah.”¹⁶⁵

¹⁶⁴ “Tahrirul Uesile”, vëll. 2, f. 306.

¹⁶⁵ “El Kafi”, vëll. 6, f. 55.

Mbajtja me të mirë ose lejimi të ikë me të mirë

Burri duhet të zgjedhë që ta ruajë jetën bashkëshortore. Këtë duhet ta bëjë brenda një atmosfere të rregullt e të shëndetëshme. Ai duhet ta mbajë mirë gruan dhe ta trajtojë sa më mirë. Mirëpo, nëse problemi arrin në një rrugë të bllokuar dhe vendoset divorci, atëherë ai duhet ta ndajë atë me dashamirësi. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ndarja mund të bëhet dy herë. Më pas, gruaja ose të mbahet me të mirë, ose të lejohet të ikë me të mirë. Burrave nuk u lejohet të marrin gjë nga ajo që iu kanë dhënë atyre, vetëm nëse të dyja palët frikësohen se nuk do t’i zbatojnë kufijtë e Allahut. Atëherë nuk është gjynah për asnjërin, nëse gruaja i jep diçka burrit (për t’u ndarë nga ai). Këta janë kufijtë e Allahut, andaj mos i shkelni ata! Ata që shkelin kufijtë e Allahut, pikërisht ata janë të padrejtët.”**¹⁶⁶

Burrit nuk i lejohet që ta mbajë gruan në mënyrë që ta dëmtojë atë dhe as nuk duhet të sillet ashpër ndaj saj që ajo të heqë dorë nga prika (mehri) ose të hakmerret ndaj saj. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kur t’i ndani gratë dhe atyre t’u afrohet fundi i periudhës së pritjes, ose mbajini me të mirë, ose lërinin të ikin me të mirë! Dhe mos i mbani ato me qëllim lëndimi, se në këtë mënyrë i bëni padrejtësi vetes!”**¹⁶⁷.

¹⁶⁶ Surja "Bekare", ajeti 229.

¹⁶⁷ Surja "Bekare", ajeti 231.

Përmbledhja e mësimet

Divorci është shkatërrimtar për një ndërtesë, të cilën Allahu i Lartësuar e pëlqen dhe i nxit njerëzit drejt saj, e ajo është martesë.

Transmetohet nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Xhibraili (Paqja qoftë mbi të!) më ka porositur mua aq shumë për gruan, sa që mendova se kurrë nuk duhet divorcuar, vetëm në rastin kur bën një punë të shëmtuar të dukshme...*”¹⁶⁸

Alternativa e zgjedhjes së divorcit, edhe pse fetarisht nuk është i ndaluar, ai nuk duhet marrë me seriozitet dhe duhet larguar prej tij sa më shumë të jetë e mundur. Madje, nuk duhet sjellë në mendje diçka e tillë, me qëllim që divorci të mos bëhet rrugëzgjdhja më e lehtë për t’u larguar nga çdo problem me të cilin mund të përballen bashkëshortët.

Prej shkaqeve të divorcit

1- Moszbatimi i Sheriatit të shenjtë

2- Gabimet

Të drejtat dhe etika në marrëdhënien me bashkëshortin

E para: Përmbushja e nevojave të bashkëshortit

E dyta: Zbukurimi dhe dashuria për bashkëshortin

E treta: Mbrojtja e pasurisë së bashkëshortit

¹⁶⁸ “Men la jedheruhul Fakijh”, vëll. 3, pj. III, f. 440.

E katërta: Moszemërimi dhe moslëndimi i bashkëshortit

E pesta: Dalja nga shtëpia veçse me lejen e tij

Si të zgjidhen problemet?

Nëse midis gruas dhe burrit fillojnë problemet, fillimisht ata duhet ta zgjidhin problemin brenda shtëpisë së tyre pa dalë jashtë saj.

Të qënit e divorcit në dorë (kopetencë, e drejtë) të burrit, nuk i jep atij të drejtë ta shtypë e ta sundojë gruan e tij dhe të abuzojë me të. Kjo e drejtë është një amanet në qafën e tij, për të cilin ai do të japë llogari para Allahut në Ditën e Gjykimit.

Burri duhet të zgjedhë që ta ruajë jetën bashkëshortore. Këtë duhet ta bëjë brenda një atmosfere të rregullt e të shëndetëshme. Ai duhet ta mbajë mirë gruan dhe ta trajtojë sa më mirë. Mirëpo, nëse problemi arrin në një rrugë të bllokuar dhe vendoset divorci, atëherë ai duhet ta ndajë atë me dashamirësi.

Pyetje rreth mësimit

- 1- Sqaro pikëpamjen e Islamit për divorcin.
- 2- Cilat janë shkaqet e divorcit?
- 3- Cilat janë të drejtat e burrit ndaj gruas së tij?
- 4- Cilat janë rrugët që duhet të ndiqen për të ndrequr problemet në jetën bashkëshortore?
- 5- A ka kuptimin e sundimit të gruas të qënit e divorcit e drejtë (kopetencë) e burrit?

Tregim

Asia, e bija e Muzahimit

Zonja Asia, e bija e Muzahimit është gruaja e Faraonit, që jetoi në kohën e Profetit Musa (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*).

Kjo grua jetonte një jetë materiale me plot kuptimin e saj, e cila shijonte jetën luksoze dhe kishte shërbëtorë, bizhuteri, zbukurime dhe veshjet më të mira, sepse ishte gruaja e Faraonit, sunduesit të Egjiptit, i cili e dashuronte shumë Asian dhe ishte i gatshëm të përmbushte çdo dëshirë që ajo kishte.

Pavarësisht të gjitha këtyre mirësive materiale, Asia u largua nga gjithçka dhe u drejtua kah i Vërteti kur dëgjoi thirrjen e Tij nga gjuha e Profetit Musa (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), i cili u rrit në prehrin dhe pallatin e saj. Ajo besonte tek ai dhe në thirrjen e tij, kështu Asia (*Paqja qoftë mbi të!*) ishte nga të parat që besoi në fenë në të cilën ftonte Profeti Musa (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*).

Shenjat e besimit tek Asia (*Paqja qoftë mbi të!*) e zemëruan Faraonin, i cili kishte deklaruar veten e tij zot! Faraoni ishte shumë i zemëruar sepse ai person që i besoi Musait nuk ishte një i huaj për të apo një person çfarëdo. Ajo ishte gruaja e tij, e cila kishte jetuar me të në pallatin e tij. Ai u përpoq me të gjitha mjetet që ta fshihte besimin e saj nga njerëzit, në mënyrë që froni i tij të mos shkatërrohej.

Sidoqoftë, të gjitha përpjekjet e tij dështuan për atë që ajo besoi, duke hequr dorë nga gjithçka, përveç besimit të saj, që ishte i fortë si mali i palëkundur. Për këtë, Faraoni mori hak ndaj saj dhe ndaj fesë e saj. Ai urdhëroi kryqëzimin e saj, në mënyrë që ky të ishte një mësim për të gjithë njerëzit.

Gjithsesi, ajo e duroi kryqëzimin e saj me besimin e fortë që kishte dhe u martirizua për besimin e vërtetë. Për këtë, Allahu i Madhëruar e lavdëron atë në Librin e Tij: **“Allahu ka dhënë si shembull për besimtarët gruan e Faraonit, kur ajo tha: ‘O Zoti im! Ndërtomë një banesë tek Ti, në Xhenet; më shpëto nga Faraoni dhe veprat e tij dhe më shpëto nga populli i padrejtë!’”**¹⁶⁹

Ajo ishte një shembull për të gjithë ata që besuan, burra dhe gra. Prej saj besimtarët mësojnë durimin dhe vendosmërinë për fenë e vërtetë deri në frymën e fundit.

¹⁶⁹ Surja "Tahrim", ajeti 11.

Mësimi i nëntë

ROLI I GRUAS SI NËNË

Çfarë është nëna?

“Nëna” është një fjalë e jashtëzakonshme që lë një ndikim shumë të madh në shpirtin e njerëzve, nxit pasionin, zgjon butësinë, ngrohtësinë dhe ëmbëlsinë. Cili është realiteti që depoziton kjo fjalë në shpirtin e njeriut?

Kur i referohemi Sheriatit të shenjtë, gjejmë shumë tekste që flasin për nënat dhe për ndjenjën e dhembshurisë së thellë ndaj nënave. Kjo dashuri, e cila e lidh fëmijën me nënën e tij, në një mënyrë, e ndihmon atë të zbatojë detyrat e saj. Ka transmetime që flasin për nënën.

1- Xheneti është nën këmbët e nënës

Në një hadith të njohur, Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Xheneti është nën këmbët e nënës.”¹⁷⁰

Fraza “nën këmbët” tregon për shërbimin dhe modestinë. Shërbimi për nënën dhe modestia ndaj saj, janë portë e hapur drejt Xhenetit të përgjeshëm.

¹⁷⁰ “*Mexhmaul Bejjan*”, vëll. 8, f. 11.

2- Këshillimet për mirësjellje ndaj saj

Transmetohet nga Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se kur u pyet për të drejtat e nënës, ai u përgjigj: *"E largët, e largët. Sikur ai t'i shërbejë asaj aq sa është numri i kokrrizave të rërës, sa numri i pikave të shiut, në këtë jetë, ai nuk do të mund t'i shlyejë të gjitha ato që ajo ka bërë për të që nga momenti që e kam mbajtur në barkun e saj."*¹⁷¹

Ky transmetim e të tjerë si ky, përforcojnë të drejtën e nënës në këtë formë madhështore. Në të njëjtën kohë, transmetimet na thonë se shërbimi i nënës nuk është një favor për fëmijën, por ky shërbim për të është meritim.

Përse kjo pozitë? Si e meritoi nëna gjithë këtë?

Cili është shkaku i pozitës së nënës?

Ajeti fisnik e tregon këtë pozitë në të cilën Allahu e vendosi nënën dhe arsyen se pse ajo e meriton këtë pozitë. Allahu i Lartësuar thotë: **"Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: 'O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!'"**¹⁷²

Fëmijët lindin të dobët, kështu që foshnjës i nevojitet dikush që të jetë i sjellshëm me të dhe t'i afrohet atij pa kërkuar asgjë. Ai ka nevojë të ushqehet, të vishet, të jetë i mbrojtur nga të ftohtit dhe të nxehtit. Gjithashtu, ai ka

¹⁷¹ "Musterekul Uesail", vëll. 15, f. 182.

¹⁷² Surja "Isra" ajeti 24.

nevojë për dikë që t'i mbajë dorën, t'i mësojë atij interesat e tij dhe ta drejtojë atë në rrugën e arritjes së tyre. Ai ka nevojë për këto. Në të njëjtën kohë, ai nuk është në gjendje të japë asgjë nga ana e tij, përveçse një buzëqeshje të vogël, e cila gudulis zemrën e nënës dhe shpresën që mbush zemrën e saj për të ardhmen e lulëzuar të fëmijës së saj.

Në librin *"Mesazhi i të drejtave"*, Imam Zejnul Abidijn (Paqja qoftë mbi të!) e shpjegon këtë më anë të thënies së tij: *"Mbi ty ka të drejtë nëna jote dhe dije mirë se ajo të ka mbajtur aty ku nuk të mban askush, ajo të ka ushqyer me frytin e zemrës së saj, të ka ushqyer me atë me të cilin asnjë nuk mund ta ushqejë një tjetër; ajo të ka mbrojtur me veshin e me syrin e saj, me dorën e me këmbën e saj, me flokët, me lëkurën e me të gjitha gjymtyrët e saj dhe për këtë ajo është ndier e gëzuar, e qeshur; ajo ka vazhduar të të shërbejë, duke përballuar shumë vështirësi, dhimbje, rëndesa e shqetësime, derisa erdhi caktimi dhe ajo të nxori në tokë. Ajo kishte kënaqësinë të të ngopte ty kur kishe uri; ajo të vishte, të zhvishte e të njomte gojën kur kishe etje; ajo të bënte hije, ajo sakrifikohej për ty, ajo të bënte mirë ty me vuajtjen e saj; ajo të kënaqte me gjumë, me butësinë e saj; barku i saj qe për ty vendi ku ndenje dhe prehri i saj të mbështillte ty nga të gjitha anët, gjiri i saj të dha të pish, shpirti i saj ishte për ty mbrojtje; ajo duronte vapën e të ftohtët për të të ruajtur ty. Për të gjitha këto falënderojë atë, por nuk do të kesh fuqi ta falënderosh pa ndihmën e Allahut dhe pa mbarësinë e Tij!"*

Atë që ofron nëna për fëmijën e saj askush nuk e ofron. Shtëpia e tij ishte mitra e saj, ushqimi i tij ishte gjaku i saj. Pra, askush tjetër nuk mund ta ofrojë këtë. Imam Zejnul

Abidiyn (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për të gjitha këto falënderoje atë, por nuk do të kesh fuqi ta falënderosh pa ndihmën e Allahut dhe pa mbarësinë e Tij!” Çfarëdo që t’i ofrojë fëmija, nëna mbetet ajo që ofron më shumë.

Si e mban ajo këtë përgjegjësi?

Mbajtja e përgjegjësisë nga nëna kalon në disa faza, siç treguan fjalët e Imam Zejnul Abidiyn (*Paqja qoftë mbi të!*), fazë pas faze.

1- Shtatzania

Allahu i Madhëruar thotë: “Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: ‘Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.’”¹⁷³

Edhe pas përmallimit dhe durimit të nënës në mbartjen e fëmijës së saj gjatë periudhës së shtatzanisë, megjithë dobësinë që ajo përballet: “**...duke duruar mundim pas mundimi...**”, përsëri ajo është e lumtur dhe e gëzuar, është një lloj xhihadi. Nëse nëna vdes gjatë shtatzanisë, ajo konsiderohet si martire dhe ajo do të tubohet në një pozitë me dëshmorët, siç përftohet nga disa transmetime. Transmetohet nga ebi Basir, nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë*

¹⁷³ Surja "Lukman", ajeti 14.

mbi të!)), i cili për një hadith të gjatë kudsij rreth historisë së Ademit dhe Havasë, Allahu ka thënë: “O Hava! Cilado grua që vdes në kohën e lindjes së saj, Unë do ta tuboj me martirët. O Hava! Unë do ta shpërblej me shpërblimin e dëshmorit çdo grua që vdes nga dhimbjet e lindjes. Nëse ajo e kryen lindjen dhe e sjell në jetë fëmijën e saj, Unë do t’i fal të gjitha gjynahet, edhe nëse janë sa shkuma e detit, rëra e tokës dhe gjethet e pemëve. Nëse ajo vdes, do të bëhet martire dhe melekët do të jenë të pranishëm në kohën e daljes së shpirtit të saj dhe do ta përgëzojnë me Xhenet...”¹⁷⁴

Kjo është përgjegjësia e parë e nënës.

2- Ushqyerja me gjë

Allahu i Madhëruar thotë: **“Nënat le t’u japin gjë fëmijëve të tyre dy vjet, për ata që duan t’ia plotësojnë dhënien e gjirit. Babai i fëmijës ka për detyrë, sipas mundësisë së tij, që t’i sigurojë si duhet ushqim dhe veshmbathje. ...”¹⁷⁵**

Gjdhënia është një nga të drejtat e fëmijës që nuk duhet neglizhuar. Ajo ndikon në formimin mendor dhe fiziologjik të njeriut. Ajeti i mësipërm përmendi kohëzgjatjen e gjdhënies që është dy vite të plota sipas vitit hënor.

Në një transmetim sqarohet shpërblimi i gjdhënies. Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Kur një grua është shtatzanë, ajo është si agjëruesi, namazfalësi dhe muxhahidi (sakrifikuesi)*

¹⁷⁴ “Mustedrekul Uesail”, vëll. 50, f. 214.

¹⁷⁵ Surja "Bekare", ajeti 233.

*me veten e tij dhe me pasurinë e tij për hir të Zotit. Kur ajo lind fëmijën e saj, ka një shpërblim që askush nuk e di sa i madh është. Kur ajo e ushqen me gji, për çdo thithje, do të ketë shpërblimin e një të liruari nga bijtë e Ismailit. Kur e përfundon gjidhënien, një melek fisnik e godet në anë dhe i thotë. "Fillo puno, ty të janë falur gjynahet."*¹⁷⁶

3- Udhëzim dhe mbrojtje

Nëna është personi më i afërt me fëmijën. Ajo është e vetmja që ka ndikim dhe që është në gjendje ta udhëzojë e ta drejtojë fëmijën.

Të gjitha këto janë të përmendura në transmetimin e ardhur nga Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur një njeri u ankua tek ai për moralin e keq të nënës së tij. Ai (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha burrit: "Ajo nuk kishte një moral të keq kur të mbajti ty për nëntë muaj, kur të ushqeje me gji për dy vjet, kur qëndroi zgjuar gjithë natën dhe kur qëndroi e etur gjithë ditën vetëm për ty..."¹⁷⁷ Nga këtu arrijmë të kuptojmë se nëna është edukatori i vërtetë dhe është shkolla e parë që fëmija merr mësim. Atëherë si qenka përmbushur edukimi?

Qëllimet e edukimit

Edukimi është për t'i hapur dyert e së ardhmes fëmijës. Kjo arrihet duke e udhëzuar atë kah e mira duke i treguar

¹⁷⁶ "Uesailu shia", vëll. 50, f. 175.

¹⁷⁷ "Sherh Risaletul Hukuk", f. 548.

rrugëtimin e saktë drejt Jetës Tjetër. Allahu i Madhëruar thotë: **“O ju, që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...”**¹⁷⁸

Kjo arrihet nëpërmjet dy çështjeve:

E para: Mësimi

Transmetohet nga Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *“Nëse mësuesi i thotë një fëmije ‘Me emrin e Zotit’, Allahu i garanton atij (mësuesit), djalit dhe prindërve të tij mbrojtjen nga zjarri.”*¹⁷⁹

E dyta: Devotshmëria

Është ajo devotshmëri që përmendet në Kur’anin e shenjtë: **“O njerëz! Adhuronit Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat)”**¹⁸⁰

Islami i kushton një rëndësi të veçantë devotshmërisë, sepse ajo është mbrojtësja shpirtërore, e cila e ndihmon njeriun të përballet me sprovat dhe vështirësitë e kësaj jete. Ajo, gjithashtu, është diga e blinduar, e cila rrëzon të gjitha mashtrimet e shejtanit, të gjitha joshjet e kësaj jete dhe të gjitha stolitë e egos, që urdhërojnë për keq.

¹⁷⁸ Surja "Tahrim", ajeti 6.

¹⁷⁹ "Mustedrekul Uesail", vëll. 15, f. 166.

¹⁸⁰ Surja "Bekare", ajeti 21.

Metodat e edukimit

Ka disa metoda të ndryshme për edukimin, të cilat ndryshojnë sipas kapacitetit dhe moshës së fëmijës dhe nga një tematikë në tjetrën. Këtu përmendim tri prej atyre metodave:

1- Metoda e udhëzimit indirekt

Mbase kjo metodë është e para, e cila duhet të ndiqet me fëmijën, sepse ai e ka të pamundur që të marrë mesazhet e udhëzimit dhe t'i zbatojë ato. Si pasojë nëna duhet që ta drejtojë fëmijën e saj drejt rrugës së drejtë dhe ta mbajë atë lag të keqes. Këtë duhet ta bëjë duke e punësuar fëmijën me mjete të përshtatshme në mënyrë që të mos drejtohet kah të këqijat. Të arrijë të krijojë një barrierë te fëmija për ta mbrjotur nga të këqijat dhe t'i krijojë atij një model që duhet ndjekur.

Është e domosdoshme që nëna të jetë e vetëdijshme se ajo është modeli i parë i fëmijës së saj dhe se ajo duhet ta udhëzojë atë përmes veprave të saj para çdo gjëje tjetër. Kjo është metoda që nëna duhet të ndjekë. Kjo metodë është e dobishme dhe duhet të jetë e vazhdueshme në çdo moshë.

Transmetohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Lëreni fëmijën të luajë shtatë vitet e para, edukojeni për shtatë vite të tjera dhe lëreni që t’ju shoqërojë për shtatë vite të tjera.”*¹⁸¹ Ta lësh atë të luajë për shtatë vjet nuk do të thotë neglizhencë e plotë për të, por është në përshtatje me

¹⁸¹ “El Kafi”, vëll. f. 46.

udhëzimin indirekt, qoftë edhe përmes lojës.

2- Metoda direkte e të mësuarit

Në realitet, kjo është hyrja në fazën e dallimit të përfitimit të dijeve, në të cilën njeriu - në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij - mëson të bëjë dallimin midis të mirës dhe të keqes, midis të drejtës dhe shkatërrimit.

3- Udhëzimi drejt shkaqeve dhe pasojave

Fëmijët duhet të njihen me ndikimet e veprave të tyre, qofshin këto të mira apo të këqija.

Këto metoda nëna duhet t'i përvetësojë dhe t'i zbatojë me qëllim që të rrisë e të edukojë fëmijë punëmirë, të dobishëm dhe t'i lutet Allahut të Madhëruar: **"Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!"**¹⁸²

Cilësi të domosdoshme

Në mënyrë që nëna të ketë sukses në misioni e saj të edukimit, është e domosdoshme që ajo t'i përmbahet disa cilësive themelore, të cilat përmbliidhen në këto pika:

1- Dashuri dhe dhembshuri

Sigurisht, që dashuria dhe dhembshuria e nënës për fëmijën e saj është në natyrën e saj dhe nuk është urdhër apo detyrë artificiale. Lidhja e nënës me fëmijën është

¹⁸² Surja "Ali Imran", ajeti 38.

çështje shpirtërore dhe nuk ka diskutim. Kjo duket qartë në historinë e nënës së Musait (*Paqja e Allahut qoftë mbi të!*), kur Allahu i Madhëruar i thotë asaj: **“Kështu, Ne e frymëzuam nënën e Musait: ‘Jepi gjë atij dhe, kur të trembesh për sigurinë e tij, hidhe në lumë, pa pasur frikë dhe as dëshpërim! Me siguri që Ne do të ta kthejmë ty atë dhe do ta bëjmë të dërguar.’ Ndërkohë, zemra e nënës së Musait u bë si të ishte e zbrazët. Edhe pak dhe çdo gjë do të zbulohet, sikur të mos ia kishim forcuar Ne zemrën, që të bëhej besimtare e vërtetë. Kështu, Ne e kthyem atë te nëna e vet, që ajo të gëzohej e të mos pikëllohej dhe që ta dinte se premtimi i Allahut është i vërtetë; por, shumica e njerëzve nuk e dinë.”**¹⁸³

Këtë dashuri dhe dhembshuri që gjendet në zemrën e nënës, ajo duhet t’ia shfaqë fëmijës. Transmetohet nga Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: *“Puthni shumë fëmijët tuaj, sepse ju për çdo puthje do të fitoni një shkallë të Xhenetit dhe mes çdo shkalle janë pesëqind vjet.”*¹⁸⁴

2- Butësi dhe durim

Duhet që nëna të jetë e butë dhe durimtare, me qëllim që të kryejë misionin e saj edukativ ndaj fëmijëve të vet. Sigurisht, durimi i paktë mund të shkaktojë shumë komplikacione psikologjike dhe edukative.

¹⁸³ Surja "Kasas", ajetet 7 - 13.

¹⁸⁴ “*Biharul Anuar*”, vëll. 20, f. 92.

Nëna duhet të jetë në dijeni për veçoritë e fëmijës së saj dhe duhet të dijë veprat e tij, veçanërisht ato që e inatosin atë.

Nga këtu, ajo duhet t'i kuptojë sa më mirë këto çështje, me qëllim që të mos ndikojnë negativisht në nervat e saj. Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: "Mos i godisni fëmijët tuaj për shkak të të qarave, sepse e qara e tyre gjatë katër muajve të parë është dëshmi se 'Nuk ka Zot përveç Allahut'; në katër muajt e tjerë, janë salavat për Profetin dhe familjen tij; në katër muajt pasardhës, janë lutje për prindërit e tij."¹⁸⁵

3- Barazi

Nëna duhet të mbajë të njëjtën distancë me fëmijët e saj. Ajo nuk duhet të bëjë dallim midis tyre në mënyrë që të mos ndikojë negativisht tek ata. Transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ka thënë: "Cilido që ka një vajzë dhe nuk e poshtëron, nuk e nënvleftëson (jubdihaa) dhe nuk e favorizon djalin para saj, Allahu do ta fusë atë në Xhenet."¹⁸⁶

Gjithashtu, transmetohet nga i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai pa një burrë që kishte dy djem. Ai e puthi njërin dhe tjetrin jo. Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha atij: "Pse nuk bën barazi mes tyre?!"¹⁸⁷

¹⁸⁵ "Biharul Anuar", vëll. 15, f. 381.

¹⁸⁶ "Mustedrekul Uesail", vëll. 15, f. 118.

¹⁸⁷ "Men la jehdharuhu El Fakih", vëll. 3, f. 483.

Përmbajtja e mësimit

Kur i referohemi Sheriatit të shenjtë, gjejmë shumë tekste që flasin për nënat dhe për ndjenjën e dhembshurisë së thellë ndaj nënave.

Atë që ofron nëna për fëmijën e saj, askush nuk e ofron. Shtëpia e tij ishte mitra e saj, ushqimi i tij, ishte gjaku i saj... e kështu me radhë. Pra, askush tjetër nuk mund ta ofrojë këtë? Imam Zejnul Abidiyn (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *"Për të gjitha këto falënderoje atë, por nuk do të kesh fuqi ta falënderosh pa ndihmën e Allahut dhe pa mbarësinë e Tij."* Çfarëdo që t'i ofrojë fëmija, nëna mbetet ajo që ofron më shumë.

Mbajtja e përgjegjësisë nga nëna kalon në disa faza

1- Shtatzënia

2- Gjdhënia

3- Udhëzimi dhe mbrojtja

Edukimi duhet të mbështet në dy çështje. E para është mësimi dhe e dyta, besimi.

Metodat e edukimit

1- Metoda e udhëzimit indirekt

2- Metoda direkte e të mësuarit

3- Udhëzimi drejt shkaqeve dhe pasojave

Karakteristikat, me të cilat një nënë e edukuar duhet të jetë e pajisur, janë: të tregojë dashuri dhe dhembshuri, butësi dhe durim, të bëjë barazi ndaj të gjithë fëmijëve.

Pyetje rreth mësimit

- 1- Flit për pikëpamjen e Islamit ndaj nënës.
- 2- Pse Islami i jep shumë rëndësi mëmësisë?
- 3- Cilat janë përgjegjësitë më të cilat është ngarkuar femra?
- 4- Ku duhet bazuar edukimi i fëmijëve?
- 5- Përmend disa metoda të sakta të edukimit.

Tregim

Fatima bintu El Nasir

Prejardhja e saj është prej prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebi Talibit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Ajo është nëna e dy sejidave të nderuar, që ishin dijetarë të mëdhenj dhe fisnikë, Muhamed Er Redhij, grumbulluesi i librit “Nehxhul Belaga” dhe Ali El Murteda. Ata kanë qenë prej dijetarëve të njohur në të shkuarën.

Kjo grua e nderuar bënte një jetë luksoze. Por gjithësi, kjo nuk e pengoi atë që të ishte e devotshme në mesin e grave të kohës së saj. E si të mos ishte e tillë, ndërkohë që ishte vajza e En Nasir, që njihej si Abdulhak (shërbëtor i së vërtetës)?

Ibn Ebil Hadid përcjell një histori mbresëlënëse: “*Më ka thënë Fakhar ibn Muid El Aleui El Musauij (Allahu e*

mëshiroftë!) se Juristi, Imam El Mufid, Abdullah Muhamed ibn El Nu'man kishte parë një ëndërr sikur Fatimeja, e bija e Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) së bashku me Hasanin dhe Hysejnin (Paqja qoftë mbi ta!) hyri në xhaminë në Kerkh dhe ia dorëzoi atij ata të dy duke i thënë: 'Mësoju atyre jurisprudencën!' Ai u zgjua nga ëndrra e tij i habitur."

Kur lindi dita, në mëngjes hyri në xhami Fatimeja, e bija e En Nasir me shërbyeset e saj dhe përdore mbante dy djemtë e saj të vegjël, Muhamed Er Redhij dhe Ali El Murteda. Ai u ngrit, shkoi drejt saj dhe e përshëndeti atë. Pastaj, ajo i tha atij: 'O shejkh, kam sjellë dy djemtë e mi, që ti t'u mësosh jurisprudencën (fikhun).' Nga kjo, Ebu Abdullahu qau dhe u tregoi ëndrrën që kishte parë. Ai u mësoi atyre jurisprudencën. Allahu u dha atyre nga mirësia e Tij dhe u hapi atyre të dyve portat e dijes dhe të meritave, të cilat ishin të njohura në të gjithë botën dhe të tilla do të mbeten."

Kjo nënë e dashur (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i dha lamtumirën kësaj jete kalimtare, pasi u sigurua për bijtë e saj dhe ishte shumë e kënaqur me ta.

Ajo vdiq në muajin Dhil Hixheh, të vitit 385 të hixhrit. Mosha e Sherijf El Murteda ishte 30 vjeç dhe vëllai i tij, Sherijf Er Redhij ishte 26 vjeç. Sherijf Er Redhij shkroi edhe një elegji të përbërë nga 86 vargje me rimë.

Mësimi i dhjetë

PUNA E GRUAS DHE XHIHADI

Puna e gruas

Punët e njerëzve përgjithësisht mund të ndahen në tri grupe:

Grupi i parë: Punët individuale. Këto lidhen me veçoritë individuale të njerëzve, si p.sh.: adhurimet e ndryshme që njerëzit i kryejnë për të arritur në gradën e përsosurisë, kujdesja ndaj disa gjërave materiale që kanë lidhje më aparencën, me pasuritë që zotërojnë etj.

Grupi i dytë: Punët me dimension familjar. Këto ndahen në dy pjesë. Punët që lidhen më qëllimin e plotësimit të nevojave materiale për familjen si: ushqimi, veshmbathja etj. Punët që lidhen me nevojat shpirtërore të familjes si: edukimi, udhëzimi etj.

Grupi i tretë: Punët e përgjithshme që kanë dimensionin social. Nga këtu njeriu nis rolin e tij pozitiv në reformimin e shoqërisë, përmirësimin e kushteve të jetës dhe të rrethanave të saj.

Cili është qëllimi me punën e gruas për të cilën po flasim këtu në këto tre grupe?

Përsa i përket grupit të parë, i cili përfshin kujdesjen për veçoritë individuale, nuk ka dyshim që femra ka të drejtë t'i kryejë këto. Madje, është e pëlqyeshme që ajo të kujdeset për pamjen e saj dhe të zbukurohet për ta përmirësuar paraqitjen para burrit të vet. Kërkohet, gjithashtu, që ajo të kujdeset për pasuritë e veta që zotëron dhe t'i shmanget shpenzimit të tepërt dhe shpërdorimit.

Përveç këtyre është edhe adhurimi, i cili lidhet me qëllimin e ekzistencës së njeriut: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”**¹⁸⁸

Përsa i përket grupit të tretë, s'ka dyshim se gruaja ka një rol në shoqëri dhe ajo duhet ta kryejë: **“Besimtarët dhe besimtarët janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat...”**¹⁸⁹

Ky rol, mund të zgjerohet dhe të arrijë në nivel ymeti ose mund të ngushtohet në një rrethinë të caktuar, në përputhje me kapacitetin e gruas dhe aftësitë e saj drejtuese në jetën e saj, sipas kushteve të shoqërisë.

Mbetet grupi i tretë prej tre grupeve. S'ka dyshim që femra ka një rol të madh në përmbushjen e nevojave shpirtërore në edukimin dhe udhëzimin e fëmijëve të saj. Fjala këtu është për punë jashtë shtëpisë për të siguruar kafshatën e jetesës. Cilat janë qëndrimet lidhur me këtë lloj pune?

¹⁸⁸ Surja “Dhurijat”, ajeti 56.

¹⁸⁹ Surja “Teube”, ajeti 71.

Puna e vërtetë e femrës

Islami nuk i ka ngarkuar femrës përgjegjësinë e sigurimit të jetesës së familjes, por këtë përgjegjësi ia ka ngarkuar mashkullit. Kur Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ndau punët e familjes mes vajzës së tij, Fatimesë (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe dhëndrit të tij, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ai e ngarkoi vajzën me punët e shtëpisë, ndërsa atë me punët jashtë saj.

Kjo metodologji përbën një situatë të shëndetshme për një familje të lumtur, ku të gjithë anëtarët e saj i kryejnë detyrat e veta që lidhen me personalitetin dhe natyrën e tyre për të mbushur boshllëqet dhe për të siguruar nevojat materiale dhe shpirtërore, si jashtë, ashtu edhe brenda shtëpisë.

Pavarësisht kësaj, Islami nuk ia ka ndaluar femrës punën jashtë shtëpisë, për sa kohë është në bazë të rregullave fetare dhe brenda kornizave të Sheriatit. Në disa raste këto punë bëhen të pëlqyeshme. Prej këtyre rasteve përmendim:

1- Prania e nevojës materiale

Kërkimi i hallallit (të lejuarës) konsiderohet adhurim, siç ka ardhur nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili ka thënë: “Adhurimi është i përbërë nga shtatëdhjetë pjesë, e më e mira prej tyre është të

*përpiqesh për atë që është fetarisht e lejuar (hallall)."*¹⁹⁰

Nëse femra është nevojtare për veten e saj apo për ata ata që ka në ngarkim, s'ka dyshim se puna, në këtë rast, është më e mirë sesa të jetë e varur nga lëmosha e njerëzve apo të goditet nga varfëria.

2- Prania e kohës së lirë

Islami është kundër boshllëkut dhe dembelizmit. Në një transmetim të ardhur nga Imam Musa El Kadhim (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: "*Allahu i Madhëruar i urren robtë që flenë shumë dhe nuk bëjnë asgjë.*"¹⁹¹

Në rast se gruaja ka shumë kohë të lirë dhe nëse nuk e punëson veten, ajo arrin të jetë prej atyre që flejnë dhe nuk bëjnë asgjë, atëherë është e pëlqyeshme për të që ajo të punojë.

3- Rëndësia e veçantë për punën

Ka mundësi që puna që kryen gruaja të jetë shumë e rëndësishme në aspektin fetar, siç është puna në institucionet, në të cilat përhapet feja tek njerëzit, apo puna që çon në ndreqjen e shoqërisë, apo specializimi në mjekësi për femrat etj. Gruaja mund të punojë në këto punë të rëndësishme, në mënyrë që t'i shërbejnë fesë dhe shoqërisë, edhe pse ajo mund edhe të fitojë para, siç është rroga mujore në këmbim të punës që ajo bën. Në këtë

¹⁹⁰ "*Uesailu shia*", vëll. 12, f. 11.

¹⁹¹ "*Uesailu shia*", vëll. 12, f. 36.

mënyrë, ajo do të jetojë me ndershmëri dhe fisnikëri. Këto punë, edhe pse sigurojnë jetesën, kanë për qëllim shërbimin ndaj fesë dhe shoqërisë, prandaj janë të pëlqyeshme.

Zbatimi i rregullave të Sheriatit

Puna e femrës duhet të jetë brenda një mjedisi të shëndetshëm që bazohet në rregullat e fesë. Prej këtyre rregullave, janë dy çështje:

1- Shmangia e qëndrimit së bashku me meshkujt (el ekhtillatu) me aq sa të mundet. Ajo, gjithashtu, duhet të mbajë shami, duhet të kujdeset për rregullat e fesë në sjelljen e saj. Imami Khomeini ka thënë: *“Gratë të punojnë, por me shami. Për punën e tyre në zyrat qeveritare nuk ka asnjë kundërshtim, por ajo duhet të zbatojë hixhabin dhe rregullat fetare.”*¹⁹²

2- Në qoftë se puna kërkon që ajo të jetë jashtë shtëpisë, ajo duhet të marrë leje nga burri i saj nëse është e martuar, siç është edhe mendimi i Imam Khomeinit.

Xhiahadi ushtarak

Roli i gruas në xhihad

A mund të marrë pjesë gruaja në punët ushtarake? Apo këto punë janë të posaçme vetëm për meshkujt? Nëse këto

¹⁹² Nga një fjalim përpara një grupi dijetarësh dhe nxënësish të dijes fetare në Kum, më 6 mars 1979.

punë i lejohen asaj, kjo leje a është vetëm për disa punë të caktuara? Me qëllim që çështja të jetë e qartë, do të përmendim:

Çfarë nënkuptohet me punë ushtarake?

Puna në ushtri kërkon përpjekje dhe sakrificë të madhe. Këtë e bëjnë ata që punojnë në rrugën e xhihadit dhe përpiqen për hir të Zotit. Xhihadi nuk është i kufizuar vetëm me atë që merr pushkën dhe qëllon kundër armikut, por ai përfshin të gjithë punëtorët që i sigurojnë ushtarëve armë, ata që i furnizojnë ata me ushqim dhe rroba, skuadra e ambulancës që kuron të plagosurit, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të rikthehen në fushëbetejë, për të përmbushur një sërë misionesh, për të marrë armën dhe të godasë armikun, etj.

S'ka dyshim që gruaja mund të marrë pjesë në këto misione të rëndësishme për mbarëvajtjen e xhihadit. Gratë mund të marrin pjesë në sigurimin e ushqimit, të veshmbathjes, në mjekimin e plagëve, etj.

Në historinë e Profetit përmendet roli i gruas në luftë duke furnizuar ushtarët me ushqim dhe medikamente për plagët. Imami Khomeini ka thënë: *“Në fillimi të Islamit, gratë shkonin në luftra dhe shumica e tyre punonin gjatë gjithë kohës për t'i ndihmuar të plagosurit dhe për t'ua mjekuar plagët.”*¹⁹³

¹⁹³ Nga një fjalim për pendimin, më 8 nëntor 1980.

Roli i saj në mbrojtje

Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: ‘Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëlloj (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrat e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.”**¹⁹⁴

Është detyra e të gjithë myslimanëve, meshkuj apo femra ta mbrojnë Islamin dhe myslimanët, në vendet e tyre. Ata duhet të marrin pjesë në mbrojtje me të gjitha mundësitë.

Nëse lufta për Zotin, për ta mbrojtur Islamin, bëhet detyrë edhe për gruan, ajo duhet të jetë gati për ta marrë këtë rol.

Përmbledhja e mësimit

Islami nuk ia ka ngarkuar femrës përgjegjësinë e sigurimit të jetesës së familjes, por këtë përgjegjësi ia ka ngarkuar mashkullit.

Pavarësisht kësaj, Islami nuk ia ka ndaluar femrës punën jashtë shtëpisë, për sa kohë është në bazë të rregullave fetare dhe brenda kornizave të Sheriatit. Në disa raste, këto

¹⁹⁴ Surja, "Ali Imran", ajeti 195.

punë bëhen të pëlqyeshme. Prej këtyre rasteve, përmendim:

1- Nevoja materiale

2- Koha e lirë

3- Rëndësia e veçantë për punën

Puna e femrës duhet të jetë brenda një mjedisi të shëndetshëm që bazohet në rregullat e fesë. Këtu dallohen dy çështje:

1- Shmangia e qëndrimit së bashku me meshkujt (el ekhtillatu) me aq sa të jetë e mundur.

2- Leja e bashkëshortit, nëse është e martuar.

Është detyra e të gjithë myslimanëve, meshkuj apo femra ta mbrojnë Islamin dhe myslimanët, në vendet e tyre. Ata duhet të marrin pjesë në mbrojtje me të gjitha mundësitë.

Nëse lufta për Zotin, për ta mbrojtur Islamin, bëhet detyrë edhe për gruan, ajo duhet të jetë gati për ta marrë këtë rol.

Pyetje rreth mësimi

1- Kur është e pëlqyeshme puna për gruan jashtë shtëpisë?

2- Cilat janë ato çështje, për të cilat, gruaja duhet të kujdeset në kohën kur punon jashtë shtëpisë?

3- A i lejohet gruas të marrë pjesë në punë ushtarake?

4- Kur është detyrë xihadi për gruan?

Tregim

Ummu Selemeh, muvalijetu dhe muxhahideh

Ummu Selemeh (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) është gruaja fisnike e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajo paraqet portretin e vërtetë të besimit të palëkundur dhe të besimit të fortë. Ajo u brumos me dashurinë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe me dashurinë për familjen e tij. Profeti i Zotit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) faddale Ummu Selemeh nga të gjitha gratë e tij të tjera, me përjashtim të Hatixhesë (*Paqja qoftë mbi të!*).

Jeta e kësaj zonje të nderuar u dallua nga dashuria dhe mbështetja e saj për Ehli Bejtin (*Paqja qoftë mbi të!*), pavarësisht rrymave politike, të cilat e zbritën nga pozita në të cilën Allahu i ka vendosur. Ajo u dallua me vilajetin e Ehli Bejtit. Pasi vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ajo e kaloi gjithë pjesën tjetër të jetës së saj në thirrjen e njerëzve dhe në informimin e tyre rreth të drejtave të tyre, duke iu referuar asaj që ajo kishte dëgjuar nga Profeti i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sa i përket të drejtës dhe favorit të tyre. Familja e Profetit (*Paqja qoftë mbi ta!*) e respektonin, e nderonin dhe e vlerësonin shumë atë. Ummu Selemeh, gruaja që mbante me vete një besim që nga fillimi i thirrjes islame, gjithmonë aspironte drejt kënaqësisë së Allahut.

Një ditë, ajo i tha Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Pse nuk ne nuk luftojmë për hir të Allahut, që të arrijnë martirizimin, siç bëjnë burrat? Atëherë Allahu i

Lartësuar zbriti ajetin fisnik: **“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët: meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar e po ashtu, edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar. Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij. Vërtet, Allahu është i Ditur për çdo gjë.”**¹⁹⁵

Ajo (*Allahu qoftë i kënaqur!*) e mbrojti Fatime Zahranë (*Paqja qoftë mbi të!*). Për shkak të kësaj mbrojtjeje, po atë vit, ajo u privua nga dhënia e lëvruar (nga Shtëpia e parave të myslimanëve).

Ajo (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) mbrojti Prijësin e besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe qëndrimin e tij të drejtë në luftën e devesë (el jamel). Ajo mblodhi gratë e muhaxhirëve (emigrantëve) dhe të ensarëve (përkrashtuesit) dhe i informoi ato për zemërimin e saj ndaj të gjithë atyre që kishin luftuar kundër prijësit të besimtarëve, Imam Ali ibn Ebu Talibit (*Paqja qoftë mbi të!*).

Përveç gjithë kësaj, historia e saj është e mbushur me shumë qëndrime, të cilat dëshmojnë se ajo ishte nga gratë që luftuan për hir të Zotit dhe nga gratë që ngritën krye për të ngritur flamurin e Islamit me gjithë fuqinë e saj.

¹⁹⁵ Surja “Nisa”, ajeti 32.

Përmbajtja

Hyrje.....	5
Vlerësimi i femrës sipas Islamit.....	7
Mësimi i parë	
VLERA E GRUAS.....	7
Gruaja në sytë e shoqërisë.....	18
1- A është femra një krijesë dytësore?.....	18
2- Gjynahu i parë.....	20
Gruaja në pikëpamjen e Islamit.....	22
1- Nderimi i gruas si qenie njerëzore.....	22
Pikat e dobëta të përbashkëta.....	23
Nuk ka ndryshim mes gjinive.....	23
Pikëpamja e Kur'anit për femrën.....	26
Fokusimi në një model të ndritshëm.....	28
1- Gruaja e Faraonit.....	28
2- Hazreti Merjemja, e bija e Imranit.....	29
Përmbledhja e mësimi.....	30
Pyetje reth mësimi.....	31
Tregim - Fatimeja, vajza e Esedit.....	31
Mësimi i dytë	
TË DREJTAT E GRUAS.....	34
Dallimi mes burrit dhe gruas.....	34
Format e ndryshimit.....	34
Aspekti fiziologjik (trupor).....	35

Aspekti psikologjik	36
Aspekti i ndryshimit emocional.....	37
Si t' i studiojmë të drejtat?.....	37
Përshtatshmëri e jo barazi.....	38
Pikëpamja e përgjithshme ndaj dispozitave.....	38
Poligamia.....	39
Autoriteti i meshkujve mbi femrat.....	40
Trashëgimia.....	41
Përmbledhje e mësimit.....	43
Pyetjet e mësimit.....	45
Tregim - Ummu Kulthum.....	45

Mësimi tretë

TË MËSUARIT E FEMRËS.....	48
Rëndësia e dijes.....	48
Domosdoshmëria e dijes për njeriun.....	49
Nxënia (përfitim) i njohjes.....	50
Kushti paraprak për punë.....	51
3- Udhëzimi i shoqërisë.....	51
4- Zgjidhja e çdo problemi.....	51
Dija nuk është e veçantë vetëm për meshkujt.....	52
Mjediset e të mësuarit.....	52
Prioritetet e të mësuarit.....	53
Njohuritë themelore (besimi, jurisprudenca dhe morali).....	53
2- Metodot e të vepruarit në familje.....	53
3- Shërbimet që ndihmojnë në realizimin e klimës së vërtetë islame.....	53
4- Nevojat e shoqërisë.....	53
Përmbledhja e mësimit.....	55

Pyetje plotësuese.....	57
Tregim - Martirja Emine Sadr (Bintul Huda).....	57
Mësimi i katërt	
MBULIMI.....	60
Hyrje.....	60
Mbulimi në rrugëtimin njerëzor.....	61
Cili është kuptimi i mbulimit?.....	62
Çfarë kërkohet nga mbulimi?.....	63
Argumenetet e mbulimit.....	63
Çfarë duhet të mbulojë gruaja?	64
Dy koncepte mbi mbulimin e femrës.....	66
Përmbledhje.....	68
Dy koncepte mbi mbulimin e femrës.....	68
Pyetje rreth mëimit.....	70
Tregim - Imam Khomeini dhe mbulimi.....	70
Mësimi i pestë	
QËNDRIMI I MESHKUJVE DHE I FEMRAVE NË TË NJËJTIN VEND (El Ikhtilat).....	73
Hyrje.....	73
Cili është kuptimi i qëndrimit të meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend (el ikhtilat)?.....	74
Pakësimi i qëndrimit të meshkujve dhe femrave në të njëjtin vend.....	75
Vetmia e ndaluar	76
Standardet e lejueshmërisë së qëndrimit të femrave dhe meshkujve në të njëjtin vend.....	77
1- Zbukurimi:.....	77
2- Parfumimi:.....	77

3- Prekja dhe dhënia e dorës:.....	78
4- Të folurit në mënyrë joshëse:.....	79
5- Përqëndrimi në shikim:.....	79
6- Shakaja dhe e qeshura e shumtë:.....	80
Përmbledhja e mësimit.....	81
Pyetje rreth mësimit.....	83
Tregim - Përpjekjet e Hatixhesë (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>) për ruajtjen e Mesazhit.....	83
Mësimi i gjashtë	
TURPI DHE (el iffetu) PASTËRTIA.....	86
Turpi.....	86
Rëndësia e turpit.....	87
Nga kush duhet të kesh turp?.....	88
Për çfarë duhet të kemi turp?.....	90
1- Turpi është në mbulim.....	91
2- Turpi në shikim.....	91
Pastërtia (el iffetu).....	91
Kuptimi i pastërtisë.....	91
Nga se pastërtia?.....	92
1- Pastërtia (el iffetu) nga nevoja materiale.....	92
2- Dëlrësia në forcimin e mbulimit.....	92
3- Pastërtia nga dëshirat.....	93
Frytet e dëlrësisë (pastërtisë).....	93
4- Dëlrësia ndaj të ngrënit të haramit.....	93
Gjërat që janë në kundërshtim me turpin dhe pastërtinë.....	94
1- Ngjashmëria me meshkujt.....	94
2- Imitimi i Perëndimit.....	96
Përmbledhja e mësimit.....	99

Pyetje rreth mësimit.....	100
Tregim - Qëndrimet e Sejide Zejneb (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>)....	100
Mësimi shtatë	
MARTESA (pjesa e parë).....	103
Rëndësia e krijimit të familjes.....	103
Prej qëllimeve të familjes.....	104
1- Pastërtia dhe dëlirësia.....	104
2- Fortifikimi i moralit.....	105
3- Plotësimi midis bashkëshortes dhe bashkëshortit dhe përmbushja e nevojave të njëri-tjetrit.....	106
4- Mbushja e kohës me përulje ndaj Allahut.....	106
5- Shtimi i gjenezës besimtare dhe vazhdimësia e jetës...	106
Atmosfera në marrëdhëniet familjare.....	107
1- Dashuria.....	107
2- Mëshira.....	107
3- Jetesa e mirë.....	108
4- Bashkëpunimi dhe mbushja e boshllëkut.....	109
5- Qetësia dhe butësia.....	110
6- Marrja në konsideratë e mundësive të bashkëshortit..	111
Sistemi i familjes.....	111
Përmbledhja e mësimit.....	113
Pyetje rreth mësimit.....	115
Tregim - Zonja Fatime Zahra (<i>Paqja qoftë mbi të!</i>), bashkëshorte..	116
Mësimi tetë	
MARTESA (pjesa e dytë).....	118
Vazhdimësia e familjes.....	118
Prej shkaqeve të divorcit.....	120
1- Moszbatimi i Sheriatit të shenjtë.....	120

2- Gabimet.....	120
Cila është rrugëzgjidhja?.....	121
1- Kujdesja për të drejtat dhe rregullat e mirësjelljes.....	121
Të drejtat dhe etika në marrëdhënien me bashkëshortin.....	121
2- Zgjidhja pas problemit.....	124
Divorci në dorë të burrit.....	125
Mbajtja me të mirë ose lejimi të ikë me të mirë.....	126
Përmbledhja e mësimit	127
Prej shkaqeve të divorcit.....	127
1- Moszbatimi i Sheriatit të shenjtë.....	127
2- Gabimet.....	127
Si të zgjidhen problemet?.....	128
Pyetje rreth mësimit.....	128
Tregim - Asia, e bija e Muzahimit.....	129
Mësimi i nëntë	
ROLI I GRUAS SI NËNË.....	131
Çfarë është nëna?.....	131
1- Xheneti është nën këmbët e nënës.....	131
2- Këshillimet për mirësjellje ndaj saj.....	132
Cili është shkaku i pozitës së nënës?.....	132
Si e mban ajo këtë përgjegjësi?.....	134
1- Shtatzania.....	134
2- Ushqyerja me gji.....	135
3- Udhëzim dhe mbrojtje.....	136
Qëllimet e edukimit.....	136
Metodat e edukimit.....	138
1- Metoda e udhëzimit indirekt.....	138
2- Metoda direkte e të mësuarit.....	139

3- Udhëzimi drejt shkaqeve dhe pasojave.....	139
Cilësi të domosdoshme.....	139
1- Dashuri dhe dhembshuri.....	139
2- Butësi dhe durim.....	140
3- Barazi	141
Përmbajtja e mësimi.....	142
Mbajtja e përgjegjësisë nga nëna kalon në disa faza.....	142
Metodat e edukimit.....	142
Pyetje rreth mësimi.....	143
Tregim - Fatima bintu El Nasir.....	143
Mësimi i dhjetë	
PUNA E GRUAS DHE XHIHADI.....	145
Puna e gruas.....	145
Puna e vërtetë e femrës.....	147
1- Prania e nevojës materiale.....	147
2- Prania e kohës së lirë.....	148
3- Rëndësia e veçantë për punën.....	148
Zbatimi i rregullave të Sheriatit.....	149
Xhihadi ushtarak.....	149
Roli i gruas në xhihad.....	149
Çfarë nënkuptohet me punë ushtarake?.....	150
Roli i saj në mbrojtje.....	151
Përmbledhja e mësimi.....	151
Pyetje rreth mësimi.....	152
Tregim - Ummu Selemeh, muvalijetu dhe muxhahideh.....	153

نام کتاب: مکانة المرأة و دورها

ترجمه بهزبان آلبانی: سونیلا کاظمی

زیر نظر: وُلُتْ مُرْیَا (شیخ عباس)

ویرایش: لیسدا رامای

مقابله: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریہ فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

تیرانا: 2016